

Mbi romanin “Daulja prej letre” të Besnik Mustafajt dhe mbi jehonën e një çmendurie kolektive

PSIKOPATOLOGJIA E DYSHIMIT

Një çmenduri që e gjen zanafillën në procese komplekse sociologjike bashkëkohore dhe që, megjithatë, pas një vështrimi nga afër, nuk ndryshon shumë nga ajo që tregon Mustafaj, veçanërisht nëse merren parasysh implikimet e saj alegorike të pamohueshme. Është edhe për këtë arsye që zhytja në faqet e romanit të tij nuk duhet konsideruar thjesht një ushtrim i këndshëm leximi.

Nga Fabio M. Rocchi

In memoriam i dekadës
së ikjes në amshim

MENTOR QUKU: SI E NJOHA UNË

nga Begzad Baliu

(fq. 12)

SHËNIME MBI LIBRAT

“Marcia” e Dom Ndoc Nikajt shtyn kufijtë
ARDHJA E ROMANIT
TË PARË SHQIP DUKE
TEJKALUAR KOMPLEKSIN
E EDIPIT

nga Visar Zhiti

(fq. 8)

Drita kishte fillue me zbardh e dilli me shndrit... Kështu nis romani i parë shqip, kjo është fjalia e parë e tij, e shkruar në shekullin XIX, kur Shqipëria ishte ende nën Perandorinë Otomane dhe gjuha shqipe kishte qenë e ndaluar në atë perandori dhe shkronjat e saj ishin mallkuar...

‘PENGU’ I DETAJEVE

nga Vangjush Saro

(fq. 13)

“Vetëvraska mbi trëndafil” i Thanas Dinos, “Neraida”
TIPARET E NEOREALIZMIT
MODERN TË NJË ROMANI


nga Vladimir Muça

(fq. 15)

FOTOGRAFI NAUN
VRUHO DHE KISHA E
“SHËN MËRISË SË
UJËRAVE”

nga Qerim Vrioni

(fq. 14)



RIVËSHTRIM: VEPRA DRAMATIKE E QOSJES DHE TË VËRTETAT UNIVERSALE TË JETËS

nga Feride Papeleka

Teatri i ditëve tona duhet t'i ketë në repertorin e vet dramën e Qosjes, të cilat përbëjnë risi në dramaturgjinë shqipe me mesazhin bashkëkohor e me ndërthurjen e strukturës së teatrit antik me teatrin modern.

(fq. 10)

KADARENË E MBROJTI
ADHURIMI I MILIONA
LEXUESVE TË TIJ

Nga Bujar Skëndo

(fq. 6)

JOAN DIDION
Përse shkruaj

Përktheu nga anglishtja Granit Zela



(fq. 22)

BIBLIOTEKË

Nuri Plaku

*Të lexosh një pemë,
bëhesh i bukur*

(fq. 16)

Ndue Dedaj

Burri me veshë

(fq. 17)

Çeslav Milosh

Vetëm kjo

(fq. 18)

Përktheu: Odhise Çerkezi

James Joyce

Epifani

(fq. 20)

Përktheu: Qerim Raqi

Alfred Çapaliku

Qiej mermeri

(fq. 21)

Esmeralda Shpata

Kuartet tregimesh

(fq. 23)

Arben Meksi

Karikatura e së shtunës

(fq. 24)

Pelegrinazh i një grupi shkrimtarësh në Varrin e dijetarit

HAFIZ ALIKORÇA – NJË
METAFORË

nga Xhevair Lleshi

(fq. 18)

Së shpejti nga Onufri

MIKO KAWAKAMI

“Gjithë dashnorët e natës”

(fq. 7)

Një strukturë në formë spiraleje: nëntë korridore nëpër një labirint humoristik

I shkruar në vitin 1996, *Daullja prej letre* është një roman koral në të cilin marrin jetë, në përditshmërinë e Shqipërisë së kohës së regjimit, dhjetëra personazhe nga shtresa sociale të ndryshme. Shumë prej këtyre kanë sjellje aq të vërteta sa duket se e grisin faqen e librit dhe dalin në botën reale. Mustafaj, në fakt, arrin të riprodhojë dinamika psikologjike absolutisht të besueshme, duke i paraqitur lexuesit individualitete konfuze të treguara në tredimensionalitetin e tyre, në ankthin e kufijve të tyre. Nuk kemi të bëjmë me skica, por me personazhe me mish e kocka, *round*, për të përdorur përkufizimin e njohur të Forster-it. Krijesat e Besnik Mustafaj nuk përkufizohen nga përshkrime tipike të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe as nuk mund të admirohen për veçoritë që kanë të bëjnë me sferën trupore. Është detaji – një tik, një turp, një e metë, një njollë në të kaluarën e tyre, një obsesion – që na lejon të vëzhgojmë identitetin e tyre të papërsëritshëm. Secili prej këtyre identiteteve, kryesore dhe dytësore, nuk ngre pikëpyetje mbi çështje të mëdha ekzistenciale dhe as nuk duket se është i vetëdijshëm për pozicionin e tij brenda një hierarchie shoqërore të ngurtë si ajo e Shqipërisë së asaj kohe. Deliri kolektiv që prodhohet është i natyrës materiale dhe synon organizimin e kundërlëvizjeve të nevojshme për t'i shpëtuar mekanizmit të kontrollit shoqëror, për të cilin do të flas më vonë. Të gjithë e dinë se po vëzhgohen, madje spiunohen, dhe, bazuar në këtë siguri, çdokush vë në lëvizje një sërë kundërmasash që mund ta shpëtojnë. Por, nëse mendoni se keni përpara një fabul të përqendruar te shtypja komuniste, një histori që thekson mizoritë e burgosjeve ose persekutimeve në vijim të denoncimeve të zyrtarëve të zellshëm, do të zhgënjeheni shumë shpejt. Ky nuk është një roman që mund apo duhet t'i atribuohet kategorisë së rrëfimit posttraumatik, pra post-1991: për të qenë i tillë i mungon idealizmi heroik i protagonistëve, qasja dogmatike ndaj karakterizimeve fizike si dhe mungesa e asaj klime klaustrofobike që përshkon vazhdimisht mbipërcaktimin e mjedisëve. Ritheksimi i datës kur është shkruar (siç thamë, 1996) na lejon t'i atribuojmë shkrimtarisë së Besnik Mustafaj një hapësirë të mëtejshme origjinaliteti. Që në atë kohë, në fakt, shkrimtari kishte zgjedhur rrugën dhe shifrën e tij stilistike, duke marrë një qëndrim krejtësisht origjinal në lidhje me letërsinë bashkëkohore të vendit të tij.

Habitati natyror në të cilin Mustafaj sillet për të vendosur historitë e tij – i konfirmuar edhe në librat e tjerë (*Një sagë e vogël*, për shembull, i përkthyer në gjuhën italiane nën titullin *Piccola saga carceraria*) – në njëfarë mënyre kujton premisën themelore të një mjeshtri të shekullit të njëzetë si Saramago. Ashtu si te shkrimtari i madh alegorik portugez, te Mustafaj është qendror predikimi për faktin e vogël, në dukje të parëndësishëm, por që në arkitekturën e përgjithshme të montazhit shndërrohet në majën e një ajsbergu falë të cilit lulëzon gradualisht hetimi njohës. Ky investigim kryhet në thellësi, duke synuar rindërtimin e një teme që është prekur shumë pak herë në Shqipëri: atë të dinamikës ndërpersonale të komunitetit në kohën e Enver Hoxhës. Kaustik, i urtë, jo i prirë të sulmojë plotësisht personazhet e tij, por as t'i justifikojë, Mustafaj i fut në skenën e faqes duke u dhënë shumë pak rrethana lehtësuese. Ajo që i intereson është përqendrimi në një lloj antropologjik

Mbi *Daullja prej letre* të Besnik Mustafaj dhe mbi jehonën e një çmendurie kolektive

PSIKOPATOLOGJIA E DYSHIMIT

nga Fabio M. Rocchi

Është në program, nga shtëpia botuese "Onufri", një botim i ri i romanit *Daullja prej letre* të Besnik Mustafaj. Romani do të shoqërohet nga parathënia e mëposhtme, të cilën po e sjellim në këtë numër të ExLibris. E njëjta parathënie, por në gjuhën italiane, do të shoqërojë edhe përkthimin italisht të romanit, i parashikuar të dalë në vitin 2025, nën kujdesin e Fabio dhe Kriselda Rocchi.

shumë specifik, ose më mirë te një e keqe, e cila, që prej një momenti specifik e më tej, ka megjulluar qartësinë e gjyimit të një kombi të tërë. Në nëntë tablotë që përbëjnë këtë afresk, elementi unifikues nga ana e rrëfimitarit konsiston në një predispozitë të dukshme për të portretizuar një njerëzim dritëshkurtër, të paaftë për akte guximtare dhe mbi të gjitha, të paaftë për t'u rebeluar e për të formuluar mendime alternative që ta distancojnë nga deliri kolektiv që mbizotëronte pasi presioni i shtetit mbi fatet e individëve bëhej gjithnjë e më i fortë. Ndoshta do të ishte e gabuar të lexohej i gjithë romani si një aktakuzë kundër popullit shqiptar të asaj kohe, fajtor se nuk kishte organizuar asnjë përpjekje për rebelim. Nga ana tjetër, është e vërtetë që autori rezulton veçanërisht i zoti në kapjen e gjesteve dhe përpjekjeve të vogla, pjesë e


një sërë aventurash të përditshme në dukje të parëndësishme, por ama të përjetuara me intensitetin që u rezervohet vetëm betejave të mëdha, të kryera për mbrojtjen e vlerave parësore, si p.sh., mbajtja e vendit të punës, shmangia e burgut apo ruajtja e privilegjit social e ekonomik. Në fakt, edhe kur nuk ndodh asgjë e jashtëzakonshme, protagonistët e *Daullja prej letre* ndiejnë se janë tërë kohës të kërcënuar nga një entitet i padukshëm, nga njëfarë komploti i hartuar për t'i dëmtuar e që ata kanë për detyrë ta shmangin. Gjenialiteti i Mustafaj qendron në portretizimin e një situatë në të cilën, në fakt, ky komplot nuk ekziston pothuajse kurrë dhe është veç fryt i projekteve të ankthshme të personave të prekur. Në këtë kontrast qëndron një nga zgjedhjet më të suksesshme narrative dhe nëse duam, stilistike, të kësaj lloji poetike.



Megjithatë, asnjë herë të vetme, duhet thënë qartë, tonet nuk modelohen për të rezultuar satirike. Nuk ka asnjë viktimitë të cilës i riprodhohen me qëllime denigruese të metat apo sjellja. Nga çdo histori Mustafaj më tepër kërkon dhe arrin aspektin paradoksal: një mendim absurd mbi një shaka që shkoj keq, për shembull, si në episodin e miqësisë që prishet mes tre të pandashmëve Ilir, Leka dhe Maks; një dëshirë e pamundur për të ngjitur shkallët shoqërore duke përfituar nga vdekja e së bijës, vdekje për të cilën i ati, Nikollë Loka, kompensohet për qëllime propagandistike nga Partia; një shaka e ngathët dhe e shkujdesur, si ajo e keqkuptuar në fjalët e Gjeneral Misrit Neki Palushi. Të gjitha të dhënat që orientojnë drejt matricës së dukshme humoristike që mban së bashku kolazhin e tregimeve të mbledhura nga rrëfimtari, i cili nuk ka për qëllim të sulmojë një objekt të caktuar polemik, por vetëm të rindërtojë e të analizojë nga anë të ndryshme një bllok të tërë social. Edhe kur në skenë del përgjegjësi kryesor i atij deliri kolektiv, Enver Hoxha, në cilësinë e një figure historike, nuk kemi asnjë përshkrim i cili çmitizon rolin e tij në mbështetje të tezës satirike apo sarkastike. Paraqitja e tij në kapitullin e parë është absolutisht realiste dhe pa detaje të pandershme; në mënyrë të ngjashme, shfaqja e fjalëve të tij, të marra nga ekstrakte letrash apo mesazhesh të ndryshme drejtuar kombit, është tërësisht në përputhje me një rindërtim të besueshëm të mjeteve retorike të asaj kohe. Mustafaj nuk synon të argëtohet duke i bërë lexuesit të qeshin ose të buzëqeshin: ai dëshiron të portretizojë një njerëzim pa personalitet të tepruar, të cilin e gjejmë vazhdimisht të përfshirë në një lojë force pa qëllim me sistemin, në një lloj sforcje që autori arrin të na përcjellë jo nëpërmjet shpjegimit, por përmes materialitetit të ngadaltë të gjesteve të vogla.

Stili i adoptuar në *Daullja prej letre* është i ancoruar në mënyrë solide ndaj një fjalie të gjerë plot prerje, me një lojë pjesësh të nënrenditura (sidomos ato shkakore, kohore dhe lejuese) që ndjekin njëra-tjetrën në njësi që mund të zënë edhe gjysmën e faqes. Kjo strukturë formale karakterizohet, në fakt, nga gjatësia e fjalive, përdorimi unik i shenjave të pikësimit dhe kërkimi i një ritmi të brendshëm meditues. Stërzgjatja e dukshme, e mbizotëruar nga emërtimi obsesiv i personazheve, nga frazeologjitë dhe nga çifte emrash e mbiemrash që përsërisin vetveten deri në tepricë, është një mjet që lejon riprodhimin e sintaksës pedantike dhe përsëritëse të burokracisë së regjimit.

Në shumë nga nëntë pjesët e mozaikut të konceptuar nga Mustafaj, rrëfimi



fillon në mënyrë të pazakontë: një episod aksidental i ndodhur në rrethana ende të paspecifikuara shënon pikënisjen për një histori që do të rikuperohet duke ecur mbrapsht dhe në të cilën shpeshherë *para* dhe *pas* alternohen në një lojë perspektive shumë interesante. Episodi i jep jetë një historie, e cila – siç kuptohet herët në tregim – luan kryesisht rolin e një preteksti. Epiqendra e kësaj vendosjeje kohore përkon me manifestimet e brendshme të një grupi kompakt dhe të shumtë personazhesh, thuhet gjithmonë të bashkuar nga ekzistenca tejet anonime. Bëhet fjalë për qenie që janë larg të qenit të përkryera edhe nga pikëpamja etike. Evolucion i historive të tyre shoqërohet me ndonjë kunj, por humorit të cilit i nënshtrohen i bashkëngjitet në më shumë se një situatë një dhembshuri therëse, një dhembshuri që vërteton edhe më tej tezën sipas së cilës pozicioni i tregimtarit nuk është gjykues.

Për sa i përket strukturës së *Daullja prej letre*, shumë herë i janë referuar imazhit të një sipërfaqeje xhami reflektuese e cila në një moment të caktuar thyhet dhe përçon, në vijim të copëtimit të saj, perspektiva dhe fragmente të shtrembëruara dhe distonike. Është pa dyshim një imazh që qëndron dhe që e gjen themelin në praninë e nëntë fragmenteve të cilat, secili në mënyrën e vet, hedhin dritë mbi aspekte të ndryshme të realitetit të asaj kohe. Megjithatë, do të doja të provoja të propozoja një interpretim alternativ, i cili i referohet një labirinti në formë spiraleje. Arsyeja pse bëj këtë krahasim ka të bëjë me atë sistem historik në dukje të palidhura njëra me tjetrën, i cili e merr me vete lexuesin duke u mbështjellë rreth një pike qendrore, e cila – edhe pse e vështirë të identifikohet – rezulton të jetë strumbullari i romanit. Formohen korridore koncentrike dhe disi labirintike, pa rrugëdalje, njësoj si fati i protagonistëve të cilët humbasin, ndonjëherë edhe pa kthim. A do ta arrestojnë Selimin? Po me gjeneral Neki Palushin çfarë ndodh? Pse Nikollë Lokën shkon e merr policia një pasdite? Rreth idesë së një fati që zbërthehet dhe përfundon duke u tretur në misterin e një fundi pa emër, struktura e kërkuar nga Mustafaj të lejon të ndiesh forcën e saj centrifugale hipnotike. Këto trajektore ekzistenciale, të cilat shpesh prekin njëra-tjetrën me një sërë referencash të shkurtra, falë të cilave shohim një personazh që më herët ishte shfaqur në një rol kryesor të shfaqet sërish në një rol dytësor, janë të shenjara nga dështimi; përpjekjet për t'u mbajtur fort pas një qendre ideale janë të dënuara të dështojnë në mënyrë sistematike.

Por, ekziston edhe një veçanti që bie në sy edhe më shumë se të gjitha të tjerat dhe që shkon përtej ekspertizës së përdorur për t'i dhënë formë strukturës së këtij romani. E kam fjalën për aftësinë për të gjetur dhe për të nxjerrë në pah absurdin. Në këtë drejtim krijesat e Mustafajt (Jakup Cena, H. P., Hekuran Romalini, Nikollë Loka, Neki Palushi, Leka, Maksi, Selimi, Din Qereçi) janë të gjitha të besueshme, sepse janë të shtyra nga një sërë mekanizmash rutinë, të cilët, edhe pse të çuditshëm, formojnë koherencën e tyre prej individësh me një vullnet vetjak. Ata nuk u binden si buratinë supozimeve ideologjike të atyre që i kanë krijuar, por, përkundrazi, janë të pajisur me dije e vetëdije maniakale – edhe pse të gabuara – në bazë të të cilave veprojnë e sillen. Fakti që psikologjia e tyre na shfaqet me një shtrembërim transversal të perceptimit të realitetit, siç do ta shohim, është një cilësi e mëtejshme koherence dhe vizioni që duhet t'i atribuohet këtij romani.



Imazhi i tamburit në letërsinë e shekullit të njëzetë

Simbologjia që evokon Mustafaj duke përfshirë daullen – edhe pse prej letre – në titullin e romanit të tij ka një histori të gjatë dhe i referohet – në mënyrë të tërthortë e besoj të pakërkuar nga autori – një tradite letrare europiane të cilën nuk mund të mos e përmendim. Rrotull këtij instrumenti me perkusion, me origjinë tribale dhe të lidhur me funksione rituale, është zhvilluar, përgjatë shekullit të njëzetë, një intertekstualitet i pasur që fillon me Bertolt Brecht-in e mbërrin deri te Günter Grass-i, duke përfshirë edhe Kadarenë të *Kështjella*. Ecim me radhë. Brecht-i, në vitin 1922, me *Trommeln in der Nacht* vë në skenë në veprën e tij teatrale daullen si personazh simbolik. Evolucion i dramës na e tregon fillimisht nën petkun e një embleme të revoltës, ndërsa në finale ajo shndërrohet në një lodër të padobishme për kohët që kanë mbërritur, aq e padobishme sa Andrea Klager-i e hedh në drejtim të hënës. Grass-i, te *Die Blechtrommel* (1959), e lidh daullen me personazhin kryesor të Oskar Matzerath-it, një adoleshent brilant e në të njëjtën kohë shumë problematik, i goditur nga sëmundje fizike dhe psikologjike, i cili ka zakonet t'i gjuajë fort daulles së tij prej teqejeje sa herë që dëshiron të prezanttojë historitë që do të tregojë. Me Kadarenë, te *Kështjella* (1970), roman i pagëzuar dy vjet më vonë nga autori me titullin *Daullet e shiut* kemi një shembull të një semantizimi të dyfishtë të daulles në hapësirën shqiptare. Pushtuesit turq kanë rrethuar qytetin e Krutës kur, në një moment, dëgjojnë zhurmën kërcënuese të një daulleje, një “daulle rrokarmëse”, e cila i trondit dhe i frikëson. Megjithatë, disa faqe më tutje, janë turqit ata që bëjnë të kumbojnë zhurmat e daulleve të bëra me lëkurën e armiqtve të vvarë, me qëllim që të terrorizojnë dhe të detyrojnë të rrethuarit të dorëzohen.

Siç shihet, lidhja midis revoltës dhe daulles është konstante dhe merr vlera të kritikës sociale veçanërisht në zonën gjermane dhe veçanërisht tek ata autorë që merren me analizën e tensioneve që çojnë në ardhjen e nazizmit (Brecht) dhe,

më pas, me përballjen e dhembshme me fantazmat e asaj stine aq kriminale (Grass). Për ta përmbledhur, si Brecht-i ashtu edhe Grass-i e shndërrojnë daullen në një simbol të çmitizuar, jo më i përshtatshëm në një ambientim bashkëkohor. Klager-i e heq qafe dhe preferon një shtrat, një evokim i qartë i individualizmit borgjez; Matzerath-i, nga ana tjetër, është një rrëfimtari anormal tregimesh, duke filluar që nga pamja, i deformuar dhe paranojak. Materiali pa vlerë me të cilin është ndërtuar daullja e tij është një sinjal i qartë tekstual për një zhvlerësim të mëtejshëm të aktit të thirrjes e bashkimit të popullit. Masa, si subjekt kolektiv i evokuar nga Marks, pas ndërgjegjësimit të saj historik, nuk ekziston më.

Mustafaj, megjithatë, qëndron larg nga të gjitha këto – përfshirë nuancat ambivalente të tingujve të daulles së Kadaresë – duke mos vazhduar, në shtigjet e hapura nga Brecht-i dhe Grass-i, serinë e dukurive që lidhen me praninë e këtij instrumenti. Ekziston, gjithsesi, një pikë kontakti. Edhe për Mustafajn daullja “thërret” një reflektim ideologjik, të lidhur me një dimension politik. Veçantia e interpretimit të metaforës së “daulles prej letre” është krejtësisht origjinale dhe meriton një shpjegim që ndoshta arrin t'i lehtësojë lexuesit kuptimin e logjikës që qëndron pas ndërtimit të saj. Frazja, në dukje pa kuptim të mëvetësishëm, citohet për herë të parë në tekst duke iu referuar fjalëve të shqiptuara nga vetë Enver Hoxha: “Ne nuk do të prodhojmë daulle prej letre.” Kur personazhi i “udhëheqësit të madh” zbulon në faqet e para të romanit e përballë Jakup Cenës së çorientuar praninë negative të spektrit të një daulleje prej letre, ai dëshiron të thotë – duke përdorur një shprehje të fryrë dhe të paqartë – se qeveria e tij nuk do të bjerë në grackën tipike perëndimore sipas së cilës shpiken premtime të cilat më pas nuk mbahen. E thënë në terma më pak figurativë, Shqipëria nuk do të mjaftohet vetëm në proklamimin e krijimit të një shteti të ri të bazuar në luftën partizane kundër pushtimit nazifashist; ajo do ta realizojë vërtet atë shtet duke u nisur pikërisht nga onomastika revolucionare sipas së cilës do

të riemërtohen sheshet dhe rrugët, detyrë kjo që i besohet zyrtarit kokëtrashë Jakup.

Pra, në këtë demonstrim të parë, metafora e daulles së letrës aludon një propagandë pa asnjë objektiv konkret dhe një retorikë joproductive që jo vetëm nuk pasqyrohet në realitetin e fakteve, por rezulton edhe e dëmshme, sepse minon themelet e ndërtimit të kombit të sapolindur. Në secilën nga nëntë pjesët e bëra bashkë nga Mustafaj kjo metaforë do të rikthehet, e transformuar dhe në rrethana gjithmonë të ndryshme, për të përsëritur me anë të imazhit të daulles që nuk bie – që nuk i reziston goditjes së parë të gjuajtur, që rrezikon të shqyhet sepse është e paqëndrueshme dhe shumë e brishtë – një kërcënim të paqartë që vjen nga një retorikë e ngjashme me atë në fuqi në shtetet e korrumpuara perëndimore. Natyra e vazhdueshme dhe abstrakte e kësaj metafore e bën ngarkesën e saj figurative shumë të afërt me atë që përdoret në ndërtimin e alegorisë, ku një sërë imazhesh, të propozuara në progresion dhe të pashpjegueshme në pamje të parë, i referohen një shpjegimi më kompleks, shpesh larg nga referencialiteti i drejtpërdrejtë i formës në të cilën ajo shfaqet. Prandaj, në këtë kuadro, daullja bëhet një alegoremë, një element që mbart një kuptim tjetër, të fshehur. Por, nuk duhet anashkaluar se kjo alegoremë është e një natyre të dyfishtë. Shumë shpejt kthehet kundër atyre që e kanë shqiptuar, në cilësinë e një figure emblematike të një stine të tërë, atë të socializmit real të frymëzimit sovjetik i karakterizuar nga defekte dhe çmenduri të organizuara në shkallë burokratike. E gjithë paradigma e cila në retorikën e saj bombastike do të donte të lartësonte me mjeshtëri sovranitetin e një republike me bazë popullore, bëhet një daulle letre, një simulakër bosh, i zhveshur nga çdo logjikë, një makinë propagandistike që rreh kot në sipërfaqen e rreme të daulleve të saj dhe të cilën askush nuk e kupton, askush nuk beson plotësisht në atë që bën, të gjithë ndihen të detyruar të konformohen vetëm nga frika se mos zbulohen dhe raportohen. Nuk është aspak rastësi që Mustafaj ia beson Hoxhës shfaqjen e parë

të alegoremës, e trajtuar kjo me shumë mjeshteri në vijim, përgjatë përvijimit të një strukture në të cilën ndërthurja e fateve nuk lë vend për formimin e mendimeve të kundërta. Është pikërisht falë kësaj zgjidhjeje të përpunuar narrative që, në një moment të caktuar, zhurma në dukje e dobët e prodhuar nga daullja e letrës bëhet një ulërimë shurdhuese.

Jehona e një çmendurie kolektive

Në labirintin e historive që Mustafaj ka ndërtuar me shumë kujdes spikat edhe një konstante tjetër – përveç *fil rouge* të daulles prej letre për të cilën sapo folëm; spikat edhe për faktin se ripërsëritet përmes disa gjetjeve strategjike që kontribuojnë në përcaktimin e normës formale të tekstit. Kjo konstante është e lidhur me temën e kontrollit shoqëror. Në secilin nga nëntë tregimet që përbëjnë romanin shfaqet obsesioni për atë çka mendojnë të tjerët. Ky obsesion çon në një korrigjim të qëllimshëm dhe të vazhdueshëm të sjelljes, i zbatuar me paramendim nga personazhi i cili në atë moment, gjatë kapitullit kushtuar atij, merr përsipër të na drejtojë e të na orientojë përgjatë historisë së rrëfyer. Qoftë kur baza e dialogut është ligjërata e zhdrejtë, apo regjia e menaxhuar në vetën e tretë, gjërat nuk ndryshojnë. Lexuesi hyn në kokën e personazhit dhe dalëngadalë – falë magjisë së leximit – sintonizohet me të, duke penetruar në mekanizmat që formulojnë mendimet e tij. Marrëdhënia gati dramatike e individit me komunitetin – ndoshta tema më urgjente e hetimit antropologjik të kryer nga Mustafaj – amplifikohet nga *milieu* social që romani rindërton: një *milieu* trasversal në të cilin gjejnë vend të gjitha shtresat shoqërore (sipas censusit, sipas lindjes, sipas statusit hierarkik); një *milieu* ku kontrolli sistematik me anë të të cilit regjimi arrin të paralizojë jetën e gjithkujt përhapet pa asnjë mundësi shpëtimi.


Mustafaj i duhet njohur merita që në rindërtimin e historive nuk lejon të mbizotërojë aspekti historik, i adoptuar shpeshherë nga autorë të njohur për histori të ambientuara në të njëjtin hark kronologjik të historisë shqiptare. Dinamikat ndërpersonale vihen në dukje nëpërmjet detajeve të vogla të papitura, detaje që përbëjnë pasurinë e këtyre tregimeve. Nëse rrëfimi – shpeshherë dëshmuar – i eksperiencave të burgosjes ka qenë mbizotërues dhe ka shenjuar narrativën kujtimore që – me të drejtë – ka lulëzuar në Shqipëri pas vitit 1991, zgjedhjet e përdorura nga Mustafaj dallohen për rafinesë e origjinalitet. Hetimi spostohet drejt faktit specifik, të dekontestualizuar nga Historia e madhe, i cili tenton të riprodhojë në mënyrë të besueshme dinamikën psikologjike të personazhit. Mendjeshkurtësia e një funksionari, i paafte të kryejë detyrën e tij, madje i paafte edhe vetëm ta kuptojë atë (Jakup Cena); shkathtësia e drujtur e një mësuesi të një shkolle filllore i cili, në vijim të një fjalie që shqipton pa u menduar, fillon e trajtohet si një figurë autoritare e shërbimit të sigurimit kombëtar (H. P.); guximi i palogjikshëm i një cigani i cili pretendon t'i vërë të birit emrin e diktatorit kinez Mao Ce Dun (Hekuran Romalini). E mund të vazhdojmë ende. Rrjedha e marrëdhënieve shoqërore, të drogua nga shqetësimi se dikush po i kontrollon vazhdimisht, degradon në mënyrë gjithmonë e më të theksuar, derisa shndërrohet në një mani persekutimi, një ndjenjë që sedimentohet në spiralet rreth të cilave mbështillen dhe gërshetohen historitë e ndryshme. Ndaj, mund të thuhet

se romani rikrijon atë psikopatologji të veçantë degjenerative që ngërthen jo aq shumë etikën e personazheve sa mendimet e tyre. Pjesët në të cilat – shumë shpesh përmes menaxhimit të këndvështrimeve nga ana e narratorit – ne i dëgjojmë të reflektojnë dhe të hipotezojnë mbi një kërcënim të mundshëm në dëm të tyre janë shumë herë më të dendura se pjesët e tekstit kushtuar veprimeve të tyre. Prandaj, nga pikëpamja e sjelljes, aftësia e tyre konjitive komprometohet, njësoj si aftësia e natyrshme për t'u lënë hapësirë emocioneve

Së shpejti nga Onufri

BESNIK MUSTAJ

“Një sagë e vogël”



Një sagë e vogël në shtypin botëror

“Ajo çka përbën origjinalitetin e romanit *Një sagë e vogël* është se Besnik Mustafaj nuk përpiqet të tregojë vuajtjet e të burgosurve, por të tregojë si traumatizohet një popull nga vite të tëra izolimi dhe dhune policore; të tregojë se si burgu, si sëmundje ngjitëse, shkatërron të gjithë, edhe ata që nuk kanë qenë aty brenda”.

Nicole Zand, *Le monde*

“Më shumë se një roman, *Një sagë e vogël* është një përrallë e hidhur, me raste të përsëritura burlesku. Burgu, një institucion i paturpshëm i pushtetit totalitar, është konstantja e pakthyeshme në historinë e një vendi që mund të quhej Shqipëri, por shumë mirë mund të quhej edhe Serbi, Maqedoni ose Kosovë. Lehtë dhe me një distancë ironike, Besnik Mustafaj përkryen lojën alegorike”.

Petra Kappert, *Frankfurter Allgemeine Zeitung*

“Ky roman është për këdo që do të kuptojë se si totalitarizmi futet thellë në mendjet e njerëzve, për t'i ndryshuar ata me qëllimin për t'i shkatërruar përfundimisht. Me një temë identike me këtë është marrë edhe Martin Amis, në romanin *House of Meetings* (*Shtëpia e takimeve*), por me rezultate të diskutueshme. Këtu është mirë të sjellim ndër mend autorë klasikë si Aleksandër Sollzenicin dhe nuk rrezikojmë ekzagjerimin. *Arkipelagu Gulag* është shumë i gjerë përkundëjt *Sagës së vogël* familjare, por edhe Rusia është e shtrirë në një territor më të gjerë se Shqipëria”.

Alessandro Gnocchi, *Il giornale*

Ndryshe nga shkrimtarët e burgosur politikë, që letrarizuan vuajtjet e tyre, Besnik Mustafaj nuk sjell përvojën e një individi ose të një brezi, por përvojën kombëtare që përfshin tre breza të Shqipërisë, duke vështruar burgun prej dy anëve (të burgosurit dhe gardianët) për të dalë te thelbi: sistemi është një diktaturë me emra të ndryshëm.

Muhamed Mufaku, *Al Araby*

sipas një mekanizmi tipik njerëzor, bazuar në reagimet ndaj asaj që perceptohet në lidhje me të tjerët. Ky komprometim i një prej dinamikave ndërpersonale bazë, i trajtuar në lartësi të ndryshme të hierarkisë sociale, është dëshmia më e drejtpërdrejtë e skizofrenisë kolektive e cila përbënte – jo vetëm në Shqipëri – ambientin më të përshtatshëm për përhapjen dhe ruajtjen e totalitarizmit evropian. Nisur nga një ideologji dominuese e imponuar me forcë, përqendrimi i pushtetit në duart e një oligarkie të vogël garantohej (në Shqipëri për gati pesë dekada) nga rrafshimi i detyruar i mendimit. I vetmi mekanizëm mbrojtës, jo ndaj autoriteteve, por mes personave të thjeshtë, bëhet ai i gënjeshtër, i ngritur si mburojë e vetëpërfaqësimit të gjithsecilit. Personazhi tipik i vënë në skenë nga Mustafaj vëzhgon situatën, nxjerr konkluzione (shumicën e rasteve të pasakta) dhe vendos të veprojë duke pasur ndër mend një qëllim të fshehtë, duke simuluar një depistazh që ndoshta mund ta shpëtojë. Do të përmend vetëm një moment, ekzemplar dhe thellësisht tregues të kësaj tendence: gjatë një periudhe pushimesh, mësuesi H. P. e gjen veten duke ndarë një dhomë me një koleg të mosuar, Mersinin misterioz dhe të heshtur. Të dy, të shtrirë në shtrat në mbrëmje, mendojnë se mund të spiunohen nga tjetri për motive të errëta politike. Dhe, për këtë arsye ata shtirin interes për një bisedë groteske, çdoherë e njëjtë, ku lavdërohet ushqimi, klima, dielli, Partia. Ndoshta nuk mund të përshkruhej më mirë se kaq ajo psikozë masive gjigante që filloi me ardhjen e epokës së kontrollit.

Të vepruarit duke pasur ndër mend një qëllim të fshehtë thamë, duke simuluar dhe duke zbatuar manovra që synojnë të largojnë vëmendjen nga qëllimet reale të strehuara në fshehtësi të personazhit. Gjykimi vlerësor ndoshta nuk është një nga gjërat e para që duhet të shqetësojë lexuesin profesionist kur i qaset një roman. Por, një gjë mund të thuhet me bindje dhe objektivitet: shumë nga literatura që ka ngelur, duke i rezistuar provës së kohës, ka arritur të përshkruajë, me një vështrim të vetëm dhe me saktësi ekstreme, një stinë të caktuar të historisë njerëzore, duke rezultuar aktuale edhe shumë kohë pas gjenezës së saj. Kanë kaluar gati tridhjetë vjet nga botimi i parë i *Daullja prej letre*; është, siç u përmend, një roman i shekullit të kaluar. Në dritën e këtyre shënimeve e pas një leximi të tillë, pushtohemi nga disa reflektime të habitshme, reflektime të cilat po t'i hedhim një vështrim gjendjes sonë aktuale antropologjike të *homines videntes* marrin një karakter fort parashikues. Një tipar karakterizues i kësaj shoqërie hiperreale, likuide, teknologjike dhe artificiale është simulimi. I përcaktuar si *du spectacle* nga Debord-i në një ese të famshme të fundit të viteve gjashtëdhjetë (1967), konformimi virtual i kohëve tona priret drejt një emanimi të një individualiteti të superstrukturuar, joautentik, dedikuar tërësisht mistifikimit të realitetit të dëshiruar nën perspektiva të rraskapitura nga dimensionin virtual i përvojës. Përsëri, nën maska e dukje të ndryshme, një çmenduri e ndryshme kolektive ka pushtuar njerëzit. Një çmenduri që e gjen zanafillën në procese komplekse sociologjike bashkëkohore dhe që, megjithatë, pas një vështrimi nga afër, nuk ndryshon shumë nga ajo që tregon Mustafaj, veçanërisht nëse merren parasysh implikimet e saj alegorike të pamohueshme. Është edhe për këtë arsye që zhytja në faqet e romanit të tij nuk duhet konsideruar thjesht një ushtrim i këndshëm leximi.

1

Ndërkohë, edhe pas disa ngjarjeve që shënonin kufi të ri në sistem, garat edhe në letërsi vazhdonin. Ndahej çmimi KADARE dhe në bëshëm gati për të udhëtuar drejt Kavajës, për të njohur pak më tepër jetën e **Hafiz Ali Korçës**, shkrimtarit, përkthyesit, islamistit, intelektualit dhe pedagogut të njohur dhe të panjohur shqiptar që erdhi në jetë tridhjetë vitet e fundit të shek. XIX (1873) në qytetin e Korçës dhe i mbylli sytë në mes të shek. XX (1956), në qytetin e Kavajës që e ka vajin e jetës gati për ata që atdheu kërkoi t'i mbulojë me pluhurin e harresës. Dhe ne do të mësonim plot të reja nga ajo jetë e harruar, që na e bëri të mundur deputeti humanist Flamur Hoxha dhe Shtëpia Botuese «Klubi i Poezisë» e cila drejtohet prej poetit të njohur Rexhep Shahu. Ne do ta shihnim me sytë tanë se vetë Kavaja do ta vinte buzën në gaz, duke pranuar me hare shumë shkrimtarë, artistë dhe intelektualë nga gjithë vendi...

Mirëpo shiu, furtuna e datës 27 qershor, bllokoi trafikun dhe ua prishi humorin shkrimtarëve që do të ishin të pranishëm në Kavajë. Një bllok total, që s'është dhe aq i rrallë në këtë Shqipërinë tonë, përndryshe do të habisnim edhe Hafiz Ali Korça. Ndërkaq edhe Prof. Dr. Ramiz Zekaj bëhej gati për të ligjruar... Por shiu, shiu i egër vjeshtor i këtij 27 qershori që diti bukur mirë të bllokonte trafikun dhe dëshirat.

E dini mirë, besoj, që Kavaja, ku kaloi dhjetë vitet e fundit Hafiz Ali Korça, është qyteti më me nerv në Shqipëri. Ndoshta shprehja "më me nerv" është jo aq e plotë... Se, në atë çast, që ai shpërthen, hapi rrugën, ndihet më i gjallëruar, merr pjesë në pritje organizuar në qiell të hapur, madje hahet e pihet kudo. Të duket sikur je në një vitrinë librash të ftohtë, mes një rrëmuje ngjyrash me dritë, që dalin nga duart e të ardhurve në këmbë, që kërcasin me një zhurmë të butë, që e merr era; ku shakatë ndjekin njëra-tjetrën, zhurma e gotave që takohen ose thyhen krijojnë ca nota krisjeje dhe një hare nervoze. I tillë m'u duk edhe sot dhe kjo më pëlqeu.

Ata, pjesëmarrësit në këtë takim, shkrimtarë të moshave të ndryshme, ardhur edhe nga diaspora, po bënin një pushim serioz dhe ku tjetër përveçse në kafene. Në lëndinë, tha dikush, shumë shpejt do të jetë një turmë tjetër si ne, duke qëndruar në këmbë mes gjithë njerëzve që përshëndesnin, duke u munduar të imitonin zërat që dënesin:

- Tani u prish futbollit, zotninj, edhe ai humbet po i kthen në festa, në fasadë... Tash ejani e lagni i fije gurmazin... Ka i pikë raki....

- Boll, miku im, futbollit do fuqi, gjunjë, del kallaji shpejt.

Takimit tonë i dukej vetja vërtet zbatimës, ndaj po kënaqej pa masë, edhe pse futbollit s'kishte vend mes nesh. Befas pat shkreput një ide se përse njerëzit dukeshin të mërziutur për vdekje, ngaqë s'po argëtoheshin me asgjë; ata do kishin dashur ndonjë grindje, fjala vjen të mbaheshin ca fjalime në një rrugicë dhe të hidhnin aty-këtu romuze, të cilave u trembeshin shumë. Nervi i qytetit me to fillon. Shiko Shkodrën, a nuk tallet me të gjithë, duke tredhur edhe gastrolet? Atëherë kushdo ka etje dhe kjo i detyron të pinë ca pika verë. Është nxehtë.

- Hafiz Ali Korça prehet në varrezë!... - vazhdonte një nga pjesëmarrësit, me sa duket, ardhur nga pushimet verore.

"Klubi i Poezisë" e ndërpreu duke klithur menjëherë.

- Eh! Ja edhe ky na duhet! Ka shprehur dëshirën t'i bëhet barrë Kavajës!

Në të vërtetë, ai shëtit me duart prapa shpinës, me një kapelë të cilën dielli ia kishte ndryshkur dhe me xhakëtën verore të gjerë, me tegela të shndritshëm, ende i egër, që e shpërdan mjerimin e vet tek të tjerët, madje edhe tek të pasurit, me forcën e një njeriu që është i gatshëm për të rrëmbyer fatin, ngado që të dalë.

- Oh! Ç'elegancë! - tha Rexhep Shahu, kur një nga ne i zgjati dorën për ta takuar.

Rexhepi fliste me një zë që të këpuste shpirtin. Pastaj u ndal, duke mërmëritur, se, tek e fundit, ishte i lumtur që na takonte, sepse kjo shenjë është jo vetëm ngushëllim, por edhe

Pelegrinazh i një grupi shkrimtarësh në Varrin e dijetarit, poetit, përkthyesit, studiuesit, islamistit, intelektualit dhe pedagogut Hafiz Ali Korçës, në Kavajë...

HAFIZ ALI KORÇA – NJË METAFORË

nga Xhevair Lleshi

ilaç për zemrën e tij, vetëm për të bërë këtë takim peng për shkrimtarin, intelektualin, përkthyesin e njohur, klerikun me zemër të madhe, burrin që s'iu drodh qerpiku, njeriun e mirë, Hafiz Ali Korça...

Pak e nga pak, lëndina po mbushej me njerëz. Aty ku zbrazej nervi i qytetit.


2

Ai i hidhte secilit nga një buzëqeshje, nga një shaka. Grupet e dashamirëve ndilleshin, afroheshin, e gjithë fjala e shpërndarë, majtas e djathtas, bëri të grumbullohej një turmë jo e vogël rrotull nesh, plot zhurmë dhe hare, kurse ajo që thuhej për *bolshevizmin* e Hafiz Ali Korçës mbretëronte përmbi fjalët e thëna që zgjateshin në drejtimin tonë dhe që përhapeshin e hidheshin përpjetë, në ajër, me një fytyrë prej dëbore, te larë me dielli dhe shiu i fortë.

Në kulmin e gjetjes sonë artistike, një hare e vërtetë, si për t'ua plasur shpirtin atyre që s'e përtpynin dot triumfin e qëllimit të këtij pelegrinazhi shkrimtarësh, dikush ngriti gotën me ujë të mbushur plot, për të uruar në atë pozën e dikurshme përherë fitimtare. Si kish mundur, me çfarë intuie i kishte gjetur shkaqet e vërteta të *bolshevizmës*, përhapjes së saj, frymës që ngjallte, përmbysjes mendje-krisur, farës që mbillte dhe të korrat e tmerrshme, sikur ta dinte se ato do të binin mbi kokën e tij si rrufetë e perëndive pagane.

Mirëpo të gjithë e ndjenë se me siguri Rexhep Shahu e kishte bërë gati për ribotim, pajisur me shënime të veçanta, këtë broshurkë, e barabatur me një jetë në vuajtje dhe përplot kërcënimesh. Dhe kur e rilexon origjinalin e sheh qartë se çfarë shije ka gjuha, teksa e prek të folmen, fjalët e rralla, sintaksën e bukur dhe fondin e lartë të fjalëve, duke ngelur i habitur kur ulesh menjëherë pranë argumenteve të zgjuara tërë aktualiteti zemër-dhënës, pasi e kupton se ke ardhur të komunikosh diçka serioze. Hafiz Ali Korça e bën qesharake bolshevizmën me mërinë e saj kundrejt gjithçkaje. Ne ia kuptojmë atij se e gjitha kjo duket një budallallëk me brirë. Siç edhe jeta e nxori.

- Qenka e lezetshme e gjitha kjo... Ah! Bolshevizma! E si, historia e saj të ngre nervat...



Kështu që do të qeshim ca.

Ai nuk u ndal, as u frikësua se mos kishte folur më shumë se ç'duhet. Ndërsa bolshevizma, nga ana e saj thoshte me zë të lartë se patjetër që nuk do shkonte të shpëronte këdo që halli që e kish zënë. Por Hafiz Ali Korça ngulte këmbë, duke u hakmarrë, me një seriozitet, teksa përpiquej të bindte njerëzinë, të vërtetat e padiskutueshme të këtij përbindëshi që kërkonte as më shumë e as më pak ta gllabëronte atë.

Ne, sigurisht, e dimë se ç'ndodhi me jetën e Hafiz Ali Korçës. Kishte hyrë, pas njëzet vjetësh prej publikimit të "Bolshevizmës", vetë ajo si një përbindësh që do të gllabëronte gjithçka, duke shkatërruar së pari njeriun, i cili në ato gjurmë vijon edhe sot e kësaj dite. Ndoshta, po të jetonte tani do ta rishkronte sërish *Bolshevizmën* e tij dhe ndoshta e kishte radhën që të heshtte. Ndërkaq, nuk ishte e nevojshme që të mendonte me zë të lartë. Më në fund, gjendje e ditëve tona lë përshtypjen se po hyn tek mendimet e popullit, që ta heqë qafe atë (popullin) dhe, meqë ai i këshillonte nënshtrim ndaj autoritarizmit, për shembull, në formën e një vizite të shkurtër në fushën e tenderëve, përpara të gjithëve, do t'iu përgjigje se do ta shikonte këtë variant, do ta mendonte njëherë. Dhe arrin në përfundimin se e djeshmja vijon në forma e rrugë të tjera. Është e njëjta gjë...

3

Nëpër këtë kohë unë u enda në jetën e tij, shkruan Prof. Dr. Ramiz Zekaj, një studiues me emër, drejtor i IETT (Institutit të Edukimit, Trashëgimisë dhe Turizmit) dhe i Kolegjit Universitar Kanadez të Teknologjisë, duke i lënë pa përmendur disa nga ofiqet e tjera. Hafiz Ali Korça pak qëndroi në shtëpi se ishte i larguar. Stamboll. Student. Atje zuri brumët e një malli të ngrysur, e udhëve vetmitare në kalldrëmet e plasurit, i vinte veshin kallëzimeve, si shqiptoheshin, ç'lezet u kish akcila fjalë, se edhe **fjala kishte shpirt** dhe shpirti i saj duhej kuptuar, po me vuajtje e durim, veç ngaherë me dëshirë e punë që të pajtohej kallëpi i shpirtit me fjalën e rrugës, sokakut. Dhe lexoi pa fund. U bë njësh me leximet e tij, me klasikët aq të njohur arabë, persë e turq: Ibn Ruzhdiu - sociolog, Ibn Sina - filozof e mjek, Ibn Rumi poet e filozof, Omer Khajami poet e mjek, Sheh Sadiu - poet. Këtë bëri dhe fare s'u ndje gjer në mbyllje të qepallës. Kështu shkollimi universitar i Hafiz Aliut në Stamboll ishte me rëndësi historike, për arsye se qysh student ai u aktivizua në Lëvizjen Kombëtare. Mirëpo në një ditë të vitit 1946 u klasifikua: "Hafiz Ali Korça, klerik reaksionar, gjatë gjithë jetës luftoi kundër ideve përparimtare..." Kaq do të mjaftonte për t'u bërë armik i popullit! Mirëpo jeta dhe vepra e tij shkëlqen si dielli. Sikur asgjë të mos kish shkruar, asgjë të mos kish bërë - do të mjaftonin *Shtat'* Ëndrat për Shqipërinë! Ai i shikon e u thotë ta përsëritin atë fjalë që shquptuan, me një zë të ëmbël e miklues. Flasin e flasin të gjitha veprat e tij për të dhe ende s'e kuptojnë si ai djallë aq i pashëm e i urtë, u vë veshin çdo fjale për fenë dhe Shqipërinë, sesi i shkëlqejnë sytë e flet fjalën e kulluar në Shqipëri. Se ai s'kërkonte atë që të tjerët pandehnin, jo si peng i mbetur hidhur prej motmotit, po luste fjalën e tyre, atë rrëfimin popullor, thurur me penj të artë. Fjalëve u jepte një guaskë që e mbante në pëllëmbë të dorës dhe kur ato mbaronin ai mbyllte kapakët e asaj guaske vezulluese e shkonte, ikte më tej nëpër Shqipërinë e vuajtur. Po s'që si të tjerët, jo, qe ndryshe, kudo vilte fjalën, atë që vlente aq shumë. Se populli zemrën e paskësh pasur

te fjala. Ai kish ndërthurur shtëpitë me fjalë dhe të gjitha ato me sokakët ku dilnin nënat veshur me të zeza. Dhe këtë e tha fort. S'kish si të mos e thoshte. E pse të mos e thoshte kur ia kaloi gjithkujt. Se ai e pati atë, Shqipërinë, kryefjalë! Asaj do t'i qeshte me gaz e s'do të pushonte së qeshuri, se s'do t'i besohej të harronte se qe më e madhja gjë që zotëronin, se aty ke brenda jetën e tjetrit treguar nga një tjetër, se aty ke sokakët dhe baltën në ndajnatë ndanë maleve, liqeneve, deteve, lumenjve, se aty bënte këmbë nga goja e mëmave, e çupkave të bardha borë, të plota, me naze e zjarr të ndezur, krejt të pa vëna dorë, si ato kukullat e mbyllura në kuti. Në kuti mbyllur edhe Shqipëria! Art i pa situar, krunde plot, guricë e barishte, po ama miell, miell nga ai lloj që bëhen ato bukët me zemër brenda e që me siguri i jepeshin gjithkujt...

4

Atë nuk e lanë as të përkthente thanë me zë të lartë, se "le të ruante besimin e tij fetar dhe urdhri i pashpallur për të mos shkruar e botuar libra origjinale"! Proza e tij shkëlqente në sënduk, shkruan më tej Prof. Dr. Ramiz Zekaj në fjalën e tij për Hafiz Ali Korça, ai ishte i vetëdijshëm se prej librave që kishte botuar para çlirimit po ushqehet një aradhe e tërë shkrimtarësh. Heshtja për këtë nga vetja, pak zhurmë andej e këtej, si për t'iu thënë njerëzve se kush qe i vërteti se aty ishte pikërisht ai. Filloi të vihej në jetë akti i fundit i tragjedisë. I vdiqën njëri pas tjetrit dy djemtë në moshë ende të papjekur. Gjysma reale e sëndukut u mbyll me kyç dhe kyçi humbi diku. A do të hapej ndonjë ditë? Ndoshta do të hapej dhe me kujdes, shumë gjëra ndoshta nuk janë thënë mirë, kanë nevojë për... Unë e di si po iki pa i parë vetë... po jam i sëmure... dhe... Këtë të fundit nuk ia tha. Po veç miqve me një gjysmë zëri. Ai ishte vërtet shumë i sëmure, më tepër prej heshtjes e harrimit. I përkorë dhe skrupuloz si për vete dhe në përkthim; e shumë e shumë të tjerë për të siguruar bukën e gojës në një vetmi e izolim prej murgu. Nuk duhej as të shfaqej. Në një kohë kur asgjë s'po ecte në familjen e tij, po vetëm pengesa e kufizime pafund, ai e kuptoi me intuitën e shkrimtarit të hollë, që ia kish paraparë *Shtat'* Ëndrat *Shqipërisë* se qenia e tij ende e gjallë, ishte pengesë e pakapërcyeshme për më tej. Merreni me mend çfarë tragjedi; një njeri kaq i ditur, një shkrimtar si ai, një poet i hollë, një shpirt i ndjeshëm dhe i vuajtur njeriu, i detyruar të jetojë në harrim dhe i pëshpëritur të ikte e të humbte në harrim të harrimit, pra, i përfolur kaq shumë për ekzistencën e tij fizike, merrte sinjale e mbushej me parandjenja se në këmbim të familjes, të një dritëze për ta, duhej të sakrifikohej përfundimisht. A mund të besohet? Kurrresi. Po sigurisht që besohet. Ky antagonizëm i përcudshëm ishte vetë koha. Dhe që ai sënduk me veprat e Hafiz Ali Korçës të mos hupte rrugëve të harresës IETT që drejtoj e bleu dhe e ruan në arkivin e tij këtë amanet... Amanet ndaj Atdheut. Them se kjo është gjë e bukur.

Hafiz Ali Korça është shkrimtari, patrioti, përkthyesi që më vjen më pranë, e ndjej më shumë, them me bindje të plotë se ai më tepër se kudo ndjehet dhe shijohet plot e përplot kudo e në të gjitha moshat. Nuk di si ta shpjegoj, ndoshta kjo ndodh nga malli, se ai është shkrimtari i përjetshëm që di të përshkruajë mrekullisht Shqipërinë e përjetshme, për të cilën ne nganjëherë na zë frika se mos e harrojmë.

*

Shiu e kishim lënë në Tiranë, por edhe atje do të kish vendosur qetësinë dielli. Tanimë kishte ardhur momenti i Çmimit *Hafiz Ali Korça*, i cili bënte që njerëzit të kridheshin në një lloj mënyre tek e vërteta intelektuale, në mënyrë që turma të mos lëkundej ashtu si e trullosur, me dëshirën që minutat e mbetura të zhdukeshin sa më parë. Këtë Çmim e propozon IETT (Institutit i Edukimit, Trashëgimisë dhe Turizmit) dhe Kolegji Universitar Kanadez i Teknologjisë, në bashkëpunim me AIITC (Institutit Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam) Tiranë, si dhe me entet kulturore shtetërore e private të interesuara për jetën dhe veprën e këtij njeriu të madh për kombin tonë...

Është e njohur armiqësia e shtetit, veçanërisht, atij totalitar, ndaj shkrimtarëve gjenialë. Thjesht, sepse këta me artin e tyre, janë kundër padrejtësive shoqërore, kundër shtypjes dhe shtypësve. Është misioni i tyre hyjnor e tokësor të jenë në anën e lirisë dhe të drejtësisë. Dhe në këtë mision janë të pandalshëm. Të paepur. Pavarësisht atmosferës mbytëse që u rri përballë. Prandaj sunduesit, pasi provojnë, pa sukses, t'i frikësojnë, t'i akuzojnë, t'i shtypin, më në fund, dorëzohen dhe... i internojnë, siç ndodhi me Eskilin, Virgjilin, Danten. Ose i burgosin, si Servantesin. Zakonisht nuk i vrasin. Jo nga keqardhja, por sepse ndihet të pafuqishëm, tremben e tmerrohen prej gjenive... Por, jo rrallë, ka ndodhur që duke i lënë të gjallë, i trajtojnë si të vdekur.

Në armiqësi me tiranët, shkrimtarët gjenialë e gjejnë harmoninë brenda botës se tyre shpirtërore dhe, veçanërisht, te lexuesit, te admiruesit e artit të tyre... Pothuajse të gjithë shkrimtarët gjenialë adhurohen marrëzisht prej bashkëkohësve të tyre.

1.

Kadare "shkruan për të huajt", pëshpëritej ligësisht nga militantët e partisë e zyrtarë të shtetit pas botimit të çdo veprë të tij. Kjo pëshpërimë tinzare nisi të përhapej menjëherë që prej botimit të "Gjenerali i Ushtrisë së Vdekur" dhe "Përbindëshi". "Shkruan për të huajt" kaloi nga bisedat okulte në faqet e shtypit. E madje, edhe nëpër konferenca ku merrte trajta më kërcënuese, më shtypëse, të tipit, mund të lexohesh e të pëlqehesh jashtë vendit, por "është populli dhe Partia që të ngre në Olimp. Dhe po të mos u bindesh atyre, janë ata që të rrëzojnë në humnerë". Sapo ishte botuar "Pallati i ëndërrave" dhe diktatura, e goditur mu në zemër, reagoi egërsisht kundër romanit dhe Kadaresë. Synohej ndrydhja, gjymtimi i tij, atmosfera mbytëse ndaj shkrimtarit gjenial. Jo vetëm pas këtij romani, por pas çdo veprë që shkruante e botonte, shkrimtari gjenial ishte një i pandehur. Veçse, një i pandehur triumfues, i pamposhtur, prometeian. Pa dyshim, shkrimtari gjenial i pasfidueshëm nën perandorinë komuniste.

Kjo ofensivë e errët kërkonte, me çdo kusht, nxitjen e urrejtjes së njerëzve ndaj shkrimtarit me famë botërore, ftohjen e marrëdhëniesve të veçanta, gati hyjnore, të Kadaresë me lexuesit e tij. Synohej ndarja e shkrimtarit gjenial prej lexuesve të tij, të cilët ia çmonin aq tepër çdo libër, që e adhuronin artin e tij të madh, që lumturoheshin prej tij. Dëshmi e kësaj lidhjeje të brendëshme, shpirtërore, të vetvetishme midis Kadaresë dhe lexuesve të tij ishin tridhjetë mijë kopjet e çdo libri të tij, që pas shpërndarjes nëpër librari, mbaronin brenda disa orësh në tërë vendin. Edhe pse, pothuajse dihej, që libri i sapobotuar e i sapoblerë do të kishte fatin e librit paraardhës e, madje, edhe të atij pasardhës. Do kritikohet rëndë nga kritika zyrtare dhe zyrtarët

KADARENË E MBROJTI ADHURIMI I MILIONA LEXUESVE TË TIJ

Nga Bujar Skëndo

kritikë të diktaturës, do denigrohej apo edhe do ndalohej. Kurse autori i tyre, do kalonte nëpër kalvarin e goditjeve fyese dhe kritikave plagosëse. I kujtonin portën e burgut e, madje, edhe portën e ferrit. Por diktatura nuk e dinte që shkrimtari gjenial ishte i caktuar, i zgjedhur për të hyrë në një portë tjetër të epërme, në portën e shekujve. Në portën e lavdisë së përhershme.

Për habinë e diktaturës, sa më shumë kritikohet, aq më i guximshëm bëhej arti i Kadaresë. Sa më tepër ia ndalonin romanet e botuara apo në proces botimi, sa më tepër ia dënonin me harresë, aq më e egër bëhej vepra tjetër që, ndërkohë, po shkruhej. Diktatura përpiquej t'a frikësonte, t'a gjunjëzonte apo edhe më tmerr, t'a ndryshonte. Kurse shkrimtari gjenial, në vetminë e tij, në tavolinën e punës, rresht pas rreshti, paragraf pas paragrafi, kreshpërohej, rrebelohej. Në vend të penës, dukej sikur shkruante me rrufe. E godet diktaturën gjithandej, në kokë, në mendimet e mbrapshta, në idetë e helmatisura...Ndërkaq, monumenti i tij prej fryme, prej shpirti e prej adhurimi, lartësohej mbi të gjithë monumentet.

Ky ishte reagimi i lexuesve të tij në kohë diktature.

Në mënyrë të papritur dhe, ndoshta, në të njëjtën kohë me pëshpërimën "shkruan për të huajt", kishte lindur një gurgullimë magjike, një enigmë. Një pëshpërimë tjetër, më gjigande, më e paanë, krejtësisht e kundërt me ligësinë e asaj të parës. Një valë e pafund, një frymë e gjallë njerëzore, e vetvetishme, e dliirë u shpërnda në gjithë vendin. Tamam si një legjendë, si një magji. Lajmërohej me zjarrmi e ngazëllim se kishte ardhur shkrimtari gjenial, shkrimtari kombëtar, Ismail Kadare. Tërë kjo përjetohej si një flakë përndritëse, si një pishtar që transmetonte mesazhin e madh. Ndodhte për herë të parë në letërsinë shqipe nën diktaturën komuniste dhe ishte e natyrshme të ishte turbulluese, dehëse, gëzimplotë që në çastin e parë. Vetë Kadare e ka ndier i pari atë pëshpërimë, atë admirim të madh njerëzor dhe me siguri është bërë me flatra.

Siç ndodh shpesh me shkrimtarët gjenialë, përplasjet me diktaturën, denigrimi, kurthet e shpifjet, urrejtja



e regjimit ndaj Kadaresë, në vend t'a dëmtonin personalitetin e tij, ndodhi krejt e kundërta: Ia shtuan famën, ia lartësuan emrin dhe lavdinë. Ia rritën admirimin. Mund të thuhet pa drojë, se jeta Kadaresë nën diktaturë, përplasjet e tij epike me të, rezistenca e tij e madhërishtme, tronditjet shpirtërore, kundërveprimi i tij ndaj diktaturës, është një tjetër kryevepër e tij. Krahas kryeveprave të tij artistike.

Romanet e Kadaresë u bënë romane-kult: "Gjenerali...", "Dimri i Vetmisë së Madhe", "Viti i mbrapshtë", "Kronikë në gur", "Koncerti", "Kamarja e turpit", "Muzgu i perëndive të stepës", "Pallati i ëndërrave"... Megjithë plagët që merrte vazhdimisht prej diktaturës ai dhe çdo roman i tij! Në ato plagë kishte diçka të ngjashme me plagët e rënda fizike e shpirtërore që merrnin miliona lexuesit e tij prej të njëjtës diktature. Prandaj ndodhi që pëshpërima dhe admirimi, me kalimin e kohës, në vend të veniteshin nga frika dhe presioni, siç shpresonte diktatura, bëheshin më shpirtërore, më të fuqishme, gati-gati, hyjnore. Fisnike dhe krejtësisht e kundërt me pëshpërimën e ligësisë,



“shkruan për të huajt”!

Admirimi i pakufishëm i lexuesve të tij ishte një parzmore, një pelerinë mbrojtëse për shkrimtarin e madh nga sulmet, intrigat, kritikën, internimi e kërcënimet me burg. Apo- tinëzish- edhe nga ndonjë vdekje aksidentale.

2.

Ndërsa lexonin e admironin romanet e shkrimtarit të tyre gjenial, miliona lexuesit e Kadaresë kishin zbuluar diçka të qenësishme. Kishin kuptuar kush ishte në anën e tyre: Pushteti që pretendonte të ishte i popullit, por që në fakt nuk ishte, apo shkrimtari gjenial dhe veprat e tij që ishin kundër diktaturës dhe pro lirive të mohuara të qytetarëve? Vepra e Kadaresë tërësisht e zymtë, plot frikëra e tmerre, ankthe e vdekje, dukej se ishte në harmoni me zymtësinë e jetës së lexuesve të tij, me shpirtin dhe pamjen e ngrysur të tyre. Pikërisht për këtë arsye ajo i mrekullonte edhe më tepër lexuesit. Me artin e thellë dhe thellësinë e mendimit ajo po tërhoqte miliona “të marrosur” pas vetes. Adhuresit mahniten nga ato që nënkuptojnë prej veprave të shkrimtarit të tyre gjenial, diktatura tmerrohet nga ato që lexon.

... Silueta e “Përbindëshit” nuk shquhej më atje larg, në periferi të qytetit, në horizont. “Përbindëshi”, i frikshëm, përplot ankth, kishte hyrë brenda në qytet. Ishte kudo, më kërcënues se kurrë... Pritej që gjithkujt t'i ndodhte diçka e rëndë.

Në kohën e tyre më të vështirë, lexuesit Kadaresë duket se bënë një marrëveshje të heshtur, një kuvend shpirtëror: T'a mbronin shkrimtarin e tyre nga diktatura. Po si? Me ç'mjete? Duke e lexuar më me ëndje, parreshtur. Duke e adhuruar shkrimtarin gjenial si Perëndinë e shpirtit të tyre. Përherë e më tepër. Deri në glorifikim... U krijua kështu një polarizim shpirtëror, një front i heshtur, por i gjallë, i ndjeshëm: Në njërin anë diktatura me policinë sekrete dhe skifterët e zyrave të shtetit, me intrigat dhe represionin ndaj romaneve të Kadaresë dhe atij vetë. Në anën tjetër, miliona lexues e miliona kopje të romaneve të Kadaresë. Shkrimtari gjenial, në mes, por me fytyrë nga këta të fundit. Miliona admirues- një mbrojtje shpirtërore në formën e adhimit hyjnor të përhapur në të katër anët e Shqipërisë.

Pëshpërimës hyjnuese të bashkëkombasve të Kadaresë, iu bashkua edhe admirimi i miliona lexuesve jashtë vendit. Të dy palët lexonin adhuronin të njëjtën letërsi të madhe, moderrne. Lexuesit e huaj i adhuronin romanet e Kadaresë për të njëjtin motiv që lexuesit shqiptarë i admironin ato. Pikërisht për artin e madhërishtë të tyre dhe frymën goditëse ndaj diktaturës komuniste. Vetë shkrimtari gjenial nuk i ndante lexuesit e tij në të huaj e vendas. Të dy palët ishin, thjesht, lexuesit e tij. Adhuresit e tij.

3.

Kadare po u jepte shqiptarëve një letërsi që nuk e kishin pasur kurrë. Dhe kjo ishte drithëruuese, emocionuese, mallëngjyese për miliona lexuesit e tij të çmuar. Me veprat e tij, të papara në letërsinë shqipe, me artin e tij gjenial, Kadare ishte tepër i çmuar për lexuesit e tij. Dhe për fat, ai nuk po lodhej aspak së shkruari dhe së godituri artistikisht diktaturën. Në të njëjtën kohë, nuk po rreshtëte së mbrojturi lirinë dhe të drejtat njerëzore të lexuesve të tij. Jo me fjalë boshe, por me artin e tij magjepsës. Për më shumë, në kohën më të zezë për admiruesit dhe vetë shkrimtarin e madh.

Arti i Kadaresë i frymëzonte shqiptarët me idenë e lirisë, i ushqente shpirtërisht, i mbante gjallë, siç thuhej atëherë. Çdo vepër e shkrimtarit gjenial ishte e vetmja gjë e bukur në duart e lexuesve të tij. E vetmja festë e vërtetë intelektuale e jetës së tyre. Kadare tronditet edhe vetë nga arti i tij i thellë, nga forca artistike goditëse. E ndien këtë thellësi, këtë përsosmëri planetare. Dhe turbullohet. Nis të ndreqë diçka, madje diç fshin e në vend të saj, diçka tjetër shkruan. Por dora i paralizohet... Shpirti i lëndohet... Pendohet... Egërsohet sërish dhe rishkruan fjalët e fshira, të nxira... Dhe e nis veprën e tij “të virgjër” në rrugën plot të papritura për te lexuesi.

Sa më shumë xhindosej diktatura ndaj shkrimtarit të madh, aq më shumë shqiptarët nxitonin të lexonin çdo vepër të re të tij. Aq më sublim bëhej adhurimi i tyre ndaj Kadaresë. Çdo botim i tij ishte verbues për diktaturën. Një shuplakë artistike, e egër, e pa mëshirë, e ashpër mbi protretin e ngurtë të saj. Madje, ka ndodhur që edhe një vepër e pabotuar ende, vepër- foshnje, e cila, ndoshta u “vodh” natën, në shtypshkronjë, sikundër vjedhja e zjarrit në mitin e famshëm grek, u shpërnda si një stuhi nëpër tërë vendin, nga Veriu në Jug. Zbritje në botën e Hadit, nëpër varre të hershme, kocka të vrarësh, duar të lyera me gjak deri në bërryl, hije e fantazma danteske burokratësh të lartë... Askush nuk e di si ndodhi që poema u mësua shpejt përmendësh nga mijëra lexues të shkrimtarit. Dikush dy vargje, një tjetër dy strofa dhe të tjerë gjithë poemën. Prej një kopjeje të vetme, të dënuar me mosbotim në mesnatë, ndërsa kishte nisur shtypshkrimi i saj... Dhe u recitua nëpër shfaqje për muaj e vite. Edhe pse diktatura kishte kërkuar që kjo vepër të konsiderohej sikur nuk kishte ekzistuar kurrë!!!

Në një situatë shtrënguese, nën presionin dhe vështrimin e rreptë të zyrtarëve të diktaturës, për të pranuar se kishte shkruar një vepër të gabuar, Kadare, ka shfryrë (Vërtet? Për atë Zot, po!): Po, e pranoj! Kam shkruar një vepër kundër partisë!... Një Zot e di çfarë lumturie supreme ka përjetuar brenda vetes shkrimtari gjenial në ato çaste... Vetëm shpirti i tij e ka ndier me saktësi ç'mister përmbante kjo shfryrje mitike, prometeane! Vetëm Kadare e di nëse, kur tha këto fjalë, sytë e tij shikonin ende njollat e gjakut në duart e atyre që kishte përballë... Kishte qenë njolloj si jhonnjhnnt' u kishte thënë: Po, unë jam përbindëshi juaj!

Së shpejti nga *Onufri*

MIEKO KAWAKAMI

“Gjithë dashnorët e natës”



Autorja bestseller e “Gjinj dhe vezë” dhe “Qielli”, Mieko Kawakami, i fton lexuesit të kthehen në botën e saj të trillimit që mund ta njohësh menjëherë me këtë roman të ri të jashtëzakonshëm dhe na tregon sërish se pse është një prej romancerieve të sotshme më të talentuara, më të thella e më të pakategorizueshme.

Fujuko Irie është korrektore e jashtme në mes të të tri- dhjetave të saj. Punon dhe jeton vetëm në një qytet ku nuk është e lehtë të krijosh marrëdhënie të reja, ka pak kontakt me njerëz të tjerë përveç redaktoreve të saj, Hixhirit, një grua në të njëjtën moshë, por me një natyrë tjetër. Kur një ditë Fujuko ndalon në një rrugë në Tokio dhe vëren reflektimin e vetes në xhamin e një vitrine, ajo sheh një grua të zbehtë, të ngathët, pa shpirt, të cilës i ka munguar forca për të ndryshuar jetën e saj dhe vendos të bëjë diçka për këtë.

Megjithatë, teksa ndodh ky ndryshim i vonuar, dalin në sipërfaqe episode të dhembshme nga e kaluara e Fujukos dhe sjellja e saj rrëshqet gjithnjë e më shumë përtej zbehjes. *Gjithë dashnorët e natës* është i mprehtë dhe i thellë, argëtues dhe tërheqës; do t'i bëjë lexuesit të qeshin dhe do t'i bëjë të qajnë, por gjithashtu do t'u kujtojë, ashtu siç të kujtojnë vetëm librat e mirë, se ndonjëherë dhembja ia vlen.

“Romani i Kawakami-t është i sinqertë, pa kompromis në vlerësimin e dëmit që gratë i shkaktojnë njëra-tjetrës, pa humbur nga sytë strukturat e përgjithshme që i detyrojnë ato ta bëjnë këtë gjë, në radhë të parë. I përmbledhur dhe i zhdërvjellët, është një vepër jashtëzakonisht inteligjente”.

— Jo Hamya, *The New York Times Book Review*

“Autorja na mahnit me eksplorimin e saj të emocioneve... Një portret gjallëruar dhe fuqizues. Është fitues”.

— *Publishers Weekly*

“Kawakami ka krijuar një ekzaminim të pasur dhe të rëndësishëm të mënyrave të ndryshme që gratë zgjedhin të jetojnë jetën e tyre dhe fitimet e humbjet që vijnë me zgjedhjet që kanë bërë. Kawakami shkruan me ndjeshmëritë e buta dhe të mprehta të një poeti... Një vepër mjeshtërore e paharrueshme”.

— *Kirkus Reviews*

“I sinqertë dhe i mprehtë, romani i fundit i Kawakami-t është një portal tjetër brilant në jetën e grave të reja”.

— *Booklist*

“Kawakami – autorja e titujve *Gjinj dhe vezë* dhe *Qielli* – ka krijuar një tjetër roman atmosferik, jashtëzakonisht të bukur”.

— *TIME Magazine*

Drita kishte fillue me zbardh e dilli me shndrit... Kështu nis romani i parë shqip, kjo është fjalia e parë e tij, e shkruar në shekullin XIX, kur Shqipëria ishte ende nën Perandorinë Otomane dhe gjuha shqipe kishte qenë e ndaluar në atë perandori dhe shkronjat e saj ishin mallkuar...

Po për ç'dritë bëhej fjalë ashtu, për lirinë e pritur me shekuj, ç'po zbardhte, gjuha e letërsisë shqipe, që do të ngrihej e do të bëhej e gjallë, romani shqiptar që do të arrinte majat dhe njohjen botërore?

* * *

Mbas 132 vjetësh harrim, sapo (ri)doli vepra "Marcia" e shkrimtarit Dom Ndoc Nikaj, e shenjuar si romani i parë shqiptar, por i shmangur si i tillë në Historitë e reja të Letërsisë, që hartonte regjimi dhe arësytet kanë qenë vetë romani, përmbajtja e tij kristiano-europiane dhe autori, që megjithëse i quajtur si ati i romanit shqiptar, pati një jetë të trazuar e dramatike, vdiq në burgun e fitimtarëve të pas Luftës II Botërore dhe kështu duheshin harruar si ai dhe vepra dhe Europa...

Pra, shkaku i vërtetë ka qenë pushteti diktatorial i komunistëve shqiptarë, Realizmi Socialist që ata vendosën me forcë si e vetmja metodë letrare, që do të duhej të ushtrohej në Shqipërinë e çliruar, por jo të shqiptarëve...

Sjellja e këtij romani shënjes, pra, është një sfidë dhe një vetëqortim emancipues, një ngjarje jo vetëm letrare e kulturore, një akt shoqëror me rëndësi dhe shpresë ecurie.

"PLASJE HAREJE NË SHPIRT"

Qysh herët, për shkrimtarin tjetër themeltar, Ernest Koliqi, (edhe ai me vepër të ndaluar dhe i dënuar me vdekje nga regjimi i dikurshëm), leximi i Dom Ndoc Nikajt do ishte "një plasje hareje në shpirt".

Me sa poezi është thënë, me ç'duf e ç'pikëllim...

SI NJË MESHË NË KATEDRALE APO NË LETRAT SHQIPE

Prej kësaj "hareje", nxitoj të them se romani "Marcia", më i hershmi dhe më i riu ndërkaq, u përurua këto ditë në qytetin e Dom Ndoc Nikajt, në Bibliotekën "Zoja e Shkodrës" në Katedrale, në ditën e 160 vjetorit të lindjes së tij, duke i ngjarë kështu një meshe të munguar gjatë në letrat shqipe.

Dhe më duhet të ndërmend tani se Katedralja, ku Dom Ndoc Nikaj ka qenë aq shpesh, në fillimet si seminarist, i gjallë dhe i vdekur, si shpirt më pas, nisi të ndërtohej, kur romancier i parë s'kishte lindur ende dhe mbaroi kur ai do të ishte 6 vjeç dhe, kur do t'i avitej nëpër mendje romani "Marcia", në Katedrale u vendosën 3 kambanat, që erdhën nga Venecia në vitin 1890.

Dy vjet më pas, kumboi romani i parë në gjuhën shqipe. Dhe krijuesi i tij do të ishte vetëm 28 vjeç. Vepra u shtyp në Shkodër. Shqiptarët e përpinë librin.

Romani i parë – si një katedrale tjetër e re...

* * *

"Marcia" e Dom Ndoc Nikajt shtyn kufijtë

Ardhja e romanit të parë shqip duke tejkaluar kompleksin e Edipit

nga Visar Zhiti



MREKULLIA...

Rivjen romani i parë shqiptar, për herë të parë mbas botimit të tij të hershëm dhe të harruar para dy shekujsh, - shkruajta unë për kopertinën e botimit.

"Marcia" i Dom Ndoc Nikajt është një narrativë plot mistikë, ku gërshetohen historikja me fantastikën, kujtesa baladeske, sa jona, po aq dhe ballkanike, (fjala është për konstruktin shpirtëror të shkrimtarit tonë,) me ato hebraike, kapërcimet nga bota reale në atë hyjnore, me personazhe biblike, varrosjet për së gjalli si dukuri e qendresës së jetës, por dhe e qytetit të tij. (Shkodrës si frymë dhe Romës, ku zhvillohen ngjarjet e romanit...).

Po ky shkrimtar një vit pas Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë (1913) do të botonte romanin tjetër "Shkodra e rrethuese" në formë ditari, që në Historinë e Letërsisë Shqipe do të njihet si romani i parë shqiptar.

Pse kjo zhvendosje? Apo do të duhej

që romani i parë i letrave tona të ishte patjetër me subjekt patriotik, kur vetë gjuha është patriotizmi më i madh. Apo nga që romancier i ynë i parë vdiq në burg në moshë të thyer, i dënuar nga diktatura e fitimtarëve të pas Luftës II Botërore.

Kompleksi i Edipit të letrave të mëpastajme shqipe, atëvrasja e rëndë e romanit të parë shqiptar dhe autorit të tij, kërkonte një qortim. Dhe ora erdhi.

Dhe shënimi im mbyllet, e përsëris:

Është shkrimtari i ri Andreas Dushi, i cili u shfaq në letrat shqipe me roman që 18 vjeç, që kryen këtë akt, ai sjell romanin më të vjetër shqiptar duke e shtyrë kështu fillesën e tij një shekull më tej, në të XIX dhe nëpërmjet Botimeve "Onufri" u arrit mrekullia.

Dua ta vazhdoj se kjo është forcë e mëtejshme e kujtesës kolektive, e kërkimit të rrënjëve, ato lëvizin, - siç e thotë dhe Ernest Koliqi që në titull të një drame të tij, është vizion, në fund të fundit gëzim, po aq sa i përbashkët i njerëzve të letrave, po aq dhe familjar, dua të them se duhet te jetë i çdo familjeje që flet shqip. Siç duket dhe si joshje duke formëzuar kështu më mirë idenë dhe simbolikën, libri i porsadalë ka për redaktore jo rastësisht një pedagogje, Luljeta Dushi, nënën e përgatitësit të botimit.

NË SHTJELLËN E ROMANIT

E përsëris prapë, nisja do të ishte profetike: *Drita kishte fillue me zbardh e dilli me shndrit...* Ngajnë me vargjet e eposit fjalët e para të romanit të parë, që unë i lexoj si ogure.


Janë 13 krerë në roman... si 12 apostujt me Krishin në mes si frymë, jo si personazh... Dhe e tillë është dhe fryma e romanit. E parë kjo nga sot, duket si një porosi europianizuese ndaj vendit që lëngonte fundin e një perandorie, që e shkëputi Shqipërinë nga Europa, familja e saj e natyrshme, për 500 vjet. Edhe Naim Frashëri, që do të bëhej poeti kombëtar, kështu shkruante: *...o dritë e uruar, / që lind nga perëndon...*

Kur është botuar romani, Naimi ishte gjallë dhe sigurisht do të ketë marrë vesh atje në Stamboll, ku jetonte dhe punonte në drejtorinë perandorake të mbikëqyrjes së kulturës, se edhe ai librat e vet i botonte jashtë, në Bukuresht.

Ngjarjet e romanit të parë në shqip zgjodhën të jenë në Romë, besoj jo rastësisht dhe si kohë zgjodhën, me qëllim patjetër, atë të paskryeqëzimit të Krishtit, kur mbartësit dhe përhapësit e një besimi të ri dhe ideve të reja, që do të ndryshonin botën përndiqeshin, persekutoheshin rëndë, dënoheshin me vdekje mizore.

DOM NDOC NIKAJ

Përgatiti për botim Andreas Dushi



Romani i parë në gjuhën shqipe

Marcia

Onufri

Protagonistja e romanit, Marcia, një vajzë pagane, që shërbente në tempull, është e detyruar të ikë, se përndiqej i vëllai i saj, përndjekja në fis do të shtohet më pas hatashëm në diktaturat e Lindjes, dhe kështu Marcia nis një jetë prej të përndjekure, të fshehtë, të nëndheshme, me vuajtje, që mua më kujton nëntokën e galerave të burgjeve tona, të Spaçit e të Qafë-Barit.

Marcia dënohet me varrosje për së gjalli në një shpellë, në terrin e katakombeve, ku e shpëtojnë miqtë, gjithmonë fshehurazi. Edhe atëherë kishte shumë që të braktisnin, por do të shtoheshin vonshëm, duke patur dhe një doktrinë mbrapsht, "politika në plan të parë".

Dhe kështu Marcia e gjen veten mes të krishterëve klandestinë, që e kthejnë dhe atë në të krishtere, me besimin te një Krijues i vetëm, me birin e Zotit, Krishtin, dhënë njerëzve me Biblën e Re, atë të dashurisë. Marcian e pagëzon fshehurazi papa i fshehur Klementi.

Mbi të gjitha kjo është një thirrje humane "për dashni t'madhe për njerz" (fq. 50). "Beso, duj dhe shpresó" (fq. 53). Dhe më pas:

"Nji gjak i dliir e i kullúm do t'a lajn kët tok t'përljeme me gjith far t'zezash për para se t'temelohet kjo bina e ré" (fq. 55)

Kreu i mëpastajmë është "Dy popujt". Autori na thotë se ka dy Roma, ajo perandorakja, zyrtarja, sunduesja dhe një tjetër "t'asaj Rome... jo me shpat sikurse deri at her por me gjýq e me dashtuni" (fq. 58) Me gjyq: kupto drejtësinë e munguar. Dhe: "Dashtnija shkante tuj i'u shtue n'zemër e féja tuj ngul rráj për dit e ma fort" (fq. 58.)

Por do të vinin kohëra të djallit, që do të sillnin urretjen në qendër dhe luftën e klasave, pra mes njerëzve, Luftë civile në kohë paqeje, e kam quajtur.

Marcia me shoqe do të jenë murgeshat e para, motrat e mëshirës, "Nënë Terezat" e bamirësië.

Në fund të romanit ato shkojnë t'u shërbejnë të burgosurve dhe Marcia në burg gjen befasi të vëllanë, Severin, i dënuar si misionar i Krishtit. Teksa e torturonin, e motra i gjendet, i mjekon plagët dhe kur e pyesin se cila ishte: "Jam motra e martirit", - thotë dhe ajo përfundon keq, e hedhin mes luanëve në Koloseun e famshëm, atje ku sot vijnë turistë nga e gjithë bota, e vizitojnë dhe bëjnë foto të lumtur.

"*Marcia o kshenimi n'filles t'vet*" mund të quhet dhe romani i martirëve. Në parathënien e tij Andreas Dushi shpjegon: "E gjithë vepra në vetvete përcjell frymën e gëzimit të martirëve dhe dëshirën e të krishterëve për ta pasur atë hir: vdekjen për fenë e tyre. Ky është mesazhi që Nikaj synon të tejçojë edhe në Shqipëri, çka si një lloj profecie, ndodh të jetëzohet me martirët shqiptarë gjysëm shekulli më vonë."

Mes tyre, martir, do të jetë dhe Dom Ndoc Nikaj. Në atë lloj burgu, ku Marcia gjeti të vëllanë, Shqipëria diktatoriale dhe e pafe, do të mbyllte Shkrimtarin e saj të romanit të parë për ta humbur përgjithmonë.

Kreu i fundit i romanit është "Luftimi i mbamë", pra ka dhe një luftë të fundit me harresën, të harrimit të padrejtësive, të së keqes.

Kjo na takon neve, të gjallëve të sotshëm, për të nxjerrë Dom Ndoc Nikajn nga dhëmbët dhe kthetrat diktatoriale të harresës së qëllimë dhe hungërimave të



Dom Ndoc Nikaj, foto nga Pietro Marubi

Realizmi socialist, që po e shqyenin. Ai ishte i mbuluar me gjakun e romaneve të tij.

* * *

Do desha të them se romani "Marcia" lexohet me ëndje dhe të trondit, me skena mbresëlënëse, ku përzihet masivja me vetanaken dhe bota e brendshme me qytetin, aq shumë Romë, në ndryshueshmërinë e tij thelbësore si ndryshime të botëkuptimit dhe të kuptimit të botës, po dhe me copëza Shkodre, kështu më duket, si me copëza të theyra pasqyre a gdhendje në dru, me një florë si humane, me personazhe spikatës, silueta dramash, që flasin shkurt dhe zgjedhshëm, e folmja shkodrane kumbon shpirtërisht, me shfletimet biblike, edhe pse ka shumë turqizma, që ndoshta në një botim të mëpastajmë mund të zevendësohen, gjithmonë me gjuhën e autorit dhe te qytetit të tij. Krerët si "Deka" apo "T'ngjallmet", "Hapsi" (Burgu), etj, më kanë lënë mbresa të pashlyeshme dhe në tërësi i shoh si faqe të shkëlqyera të letërsisë tonë të traditës.

Rëndësia e këtij romanit është e pa zhbëshme më, me një estetikë shembullore, e ardhur nga larg

KARTELA DOM NDOC NIKAJ

Në vazhdim të atyre që e kujtonin, të përpjekjeve për ta risjellë të plotë dhe me madhështi shkrimtarin tonë Dom Ndoc Nikaj, edhe unë u jam bashkuar, aq sa mundej, për ta trajtuar në shkrimet e mia, në sprovën "Panteoni i nëndheshëm", (2010) dhe më tej në "Kartela të Realizmit

të dënuar" (2020).

Po risjell nga kartela e tij në plotësim të shkrimit tim:

Dom Ndoc Nikaj (1864 -1951)

Shkrimtari plak, ai që kishte shkruar romanin e parë të letërsisë shqipe, kur gjuha shqipe ishte ende e ndaluar nga qeveria e pushtuesit turk, që do të mbyllte sytë në burg. E arrestuan në moshën 82-vjeçare, më 1946, me akuzën se donte të përmbyste me dhunë pushtetin e porsavendosur të komunistëve.

Ndoc Nikaj mësimet e para i mori te franceskanët në vendlindje, në Shkodër, pastaj në Kolegjin e Jezuitëve dhe u bë meshtar. Fare i ri nisi të shkruante letërsi, vepra fetare, shkencore, histori e politikë e kushtime lirie.

Iu përkushtua çlirimit kombëtar, bashkëpunoi me Konicën, shkroi libra shkollorë, madje dhe e arrestuan, por bëri 46 ditë burg dhe prapë vazhdoi misionin që i kishte caktuar Zoti.

[...]

Babai i romanit shqiptar, Ndoc Nikaj, ka dhe 7 romane të tjera të pabotuara, edhe drama etj. Ai është pararendësi i Mihal Gramenos, Foqion Postolit, Mit'hat Frashërit, Ernest Koliqit, "Balzaku ynë" e kanë quajtur... dhe guxuan dhe e arrestuan atin, në pleqërinë e tij të bardhë. Të zezë, thuaj. Plaku-perëndi, më duket! Vunë prangat mbi ato duar që duhej t'i puthnin. Sikur donin të dënonin ashtu së paku dhe ata 500 vjet punë të klerit katolik shqiptar. Ai, martir në qeli. E kishte menduar varrin, por jo burgun nga bijtë e tij. I pa, i duroi dhe 5 vjet. Teksa shekulli kaloi mesin e vet, Ai kaloi në botën e të vdekurve.

Dhe krijimtaria që la, është e begatë, por ende e pabotuar, mund të jenë dhe nga 30 tituj të tjerë që presin. Po ku janë rrugët dhe sheshet me statujtë e tij? Qelia ku e mbyllën, të bëhet muzé. Pse kanë druajtje t'i afrohen ikonës së tij supreme? Ngaqë një atdhe ka dënuar atin e romanit të vet?...

Ndoc Nikaj është i pavarr, por edhe vepra e tij.

KOMPLEKSI I EDIPIT NË LETRAT SHQIPE

- në vend të mbylljes -

Shpesh janë goditur dhe shembur pararendësit në letrat shqipe, themelartët, është vrasë tradita identitare, etj.

"Meshari" i Gjon Buzukut apo "Kanuni" i Lek Dukagjinit apo dhe poemat pranë tyre janë parë si antikitet, vlera muzeale, edhe si vjetërsira dhe jo si "rrënjë që lëvizin", burime jete, që arrijnë të sotmen duke e shenjuar për të ardhmen tonë.

Nëse poetit kombëtar, Naim Frashëri, i shmangej një pjesë e krijimtarisë, ajo mistike dhe fetare, madje dhe erotike, si me "kufizime ideore", ndërsa poetit tjetër Kombëtar, At' Gjergj Fishta, i ndalohej vepra e tërë, madje dhe eshtrat e tij hidheshin në lumin Drin, si në përndjekjet që u bëheshin të krishterëve, të treguara në romanin "Marcia", Shqipëria diktatoriale gjithmonë ka dënuar prijëtarët apo themeluesit, Ernest Koliqi i ikur ishte dënuar me vdekje, shkrimtari Mitrush Kuteli, nderkohë dhe autori i parë të një libri me kritika, u burgos, shkrimtarë nga Kleri, sidomos atij katolik, u pushkatuan dhe u burgosën, gazetarë, poete, Profesor Arshi Pipa, drejtori i parë Radio-Tiranës, shkrimtari dhe përkthyesi Gjergj Bubani, ndërrohej opera e parë shqiptare me një tjetër, romani i parë me një titull tjetër, etj..

Në burg vdiq tragjediani i parë shqiptar, Et'hem Haxhaidemi ashtu si dhe Dom Ndoc Nikaj.

Kompleksi i Edipit i letrave shqipe, jo në letrat shqipe, atëvrasja është një dukuri e rëndë dhe prej kësaj frike, është kaluar dhe në të kundër, në birvrasje. Janë vrasë bijtë si poetët Trifon Xhagjika, Vilson Blloshme e Genc Leka, është varur Havzi Nelaj, varja e fundit në të gjithë Europën Lindore.

Ndërkaq është ndërë dhe dukuria e ringjalljes në letrat shqipe, jo të menjëhershme, erdhi një "letërsi tjetër" nga ajo e ndaluara apo nga mërgimi i detyruar si Konica apo Martin Camaj dhe pari një prurje të dëshpërimisht të begatë nga burgjet dhe internimet.

Meritojnë studime të veçanta dhe të posaçme.

Riardhja e parë pas 132 vjetësh botim të "Marcia"-s sjell një ndryshim me rëndësi, besim në tejkalimin e Kompleksit të Edipit të letërsisë tonë, ndërkaq, siç e thamë, jo vetëm e shtyn romanin e parë në Historinë e Letërsisë Shqipe një shekull më tej, - dhe kjo u arrit me romancierin më të ri, simbolikë dhe shpresë e re, - por tregon që në zanafillën e tij romani shqiptar është me rrënjë në kulturën perëndimore, me atë frymë kristiane, të shenjtë e humane - kolonë kryesore në formimin e ndërgjegjes së Europës së Bashkuar, pra letrat shqipe kështu do të ishin letërsi Europiane, me dramën e tyre, po aq dhe universale.

Për fat ka ndonjëherë çaste të mëdha në letërsi, nga ato që bëjnë të zhytshëm në leximin e një veprë e të kesh dëshirë t'i kthehesh prapë ose që kërkojnë heshtjen duke nxitur një parafytyrim të gjallë skenik. E tillë është vepra dramatike e Qosjes. Ajo krijon një hapësirë komunikuese të veçantë me ide dhe personazhe, të cilët përpiqen të dalin jashtë një realiteti absurd, në liri.

Libri *Mite të zhveshura* i Qosjes, një titull domethënës, në të cilin përfshihen dramet *Sfinga gjallë*, *Beselam pse më flijojnë* si dhe monodrama *Vdekja e një mbretëreshë*, u botua më 1978. Tituj të tjerë "ikonoklastë" janë të pranishëm në veprën e tij krijuese, si: *Panteoni i rralluar* (1973), *Vdekja më vjen prej syve të tillë* (1974), *Anatomia e kulturës* (1976), *Fjalor demokratik* (1997) etj. Opusi letrar *Qosja* me 29 vëllime, botuar nga Instituti Albanologjik i Prishtinës më 2010, në vëllimin VIII përmbledh të gjithë veprën dramatike të deriatëherëshme shkruar prej tij, të cilës i shtohet edhe monodrama *Bardha*, botuar më 1995, një perlë e vërtetë e krijimit skenik që ironizon marrëdhëniet e njeriut në një shoqëri të mposhtur nga kapitalizmi liberal. Kështu vepra e tij dramatike shpalos disa periudha historike: Antikiteti, Mesjeta, Koha e re dhe Bashkëkohësia. Që t'i përfaqësosh epokat e jetës historike në veprat e tua dramatike, duhet një gjenialitet si i Qosjes. Veç kësaj ai është ndër autorët "që kanë pasur një ndikim të madh në modernitetin letrar të dramës shqipe", siç shkruan së fundi Ag Apolloni, duke përmendur edhe disa kritikë të mëhershëm që kanë folur për veprën e këtij dramaturgu.

Shkrimi i dramatik, i cili i kushtohet kryesisht lëvizjes për liri morale të shqiptarëve, në të vërtetë ka qenë hapje e një udhe të re në krijimtarinë e tij, por edhe një program i ri estetik ligjërimit. Si në skenat me frymë realiste, ashtu edhe në ato me karakter imagjinar, autori përpiqet të zbulojë të vërtetën e unit duke e transformuar kohën në simbol. Ai i kundërvihet çdo miti të rremë apo ideje pa kuptim duke nxitur një qëndrim qytetar ndaj atyre dukurive shoqërore që e tjetërsojnë njeriun.

Autori duket se ëndërron ta zgjojë popullin e vet nga plogështia historike duke i vënë në pikëpyetje vizionet e tij për jetën. Kështu lexuesi apo shikuesi i dramës së tij heton një mision jetësor. Çelësi që mban në dorë autori, është pohimi i një morali të ri që pengohet nëpër rrjetat e prapambetjes shekullore të trashëgaur. Ky është një kuptim humanist, përgjigje përfudimtare ndaj tablove pesimiste dhe tragjike, por edhe shqetësim krijues, një kusht *sine qua non* në të gjithë veprën e Qosjes. Personazhet e tij dramatike ngrihen përballë një shumice që nuk e pranon të renë dhe demaskojnë qëndrimet sipërfaqësore, hipokrizinë, absurdin. Këto vepra simbolizojnë edhe lëvizjen e fuqishme për emancipim që përfshiu një brez të tërë krijuesish në Kosovë, në vitet '70. Disa nga ato vepra i "besdisnin" fanatikët e moralit, por duhet thënë se ende në ditët tona nuk çmohet sa duhet pasuria e tyre.

Sfinga e gjallë

Parateksti i dramës: nata, jehona e daulleve, ritmi i tyre dhe krismat e armëve që ndërpresin vrazhdësisht çdo lloj feste a gëzimi, përgatisin mjedisin për një intrigë të fuqishme. Gjakkmarra është mbijetesa e prapambetjes, prandaj për të krijuar një lloj ekuilibri, autori e vesh Habinin, protagonistin kryesor me një lloj humanizmi romantizant: "Çfarë vargu i gjatë: i pushkëve dhe i kufomave" (Vepra VIII: 129). Habili kritikon moralin që ngrihet mbi themelet të lëkundshme. Ai e do paqen dhe jetën e lumtur, por retë e errëta të prapambetjes shekullore i pengojnë mendjet e bashkëkohësve të tij të shohin të vërtetën. Mendimi i vjetruar i ka robëruar shpirtat njerëzorë dhe vështirësitë bëhen gati të pakapërcyeshme: "Deri kur kështu? Vdekja këtu s'pushon as ditë, as natë." (*Mite të zhveshura*, Vepra XIII: 170).

RIVËSHTRIM: VEPRAT DRAMATIKE E QOSJES DHE TË VËRTETAT UNIVERSALE TË JETËS

nga Feride Papeleka

Titulli fillestar i dramës ka qenë *Sfinks i gjallë*. Ky sfiks nuk është zhdukur ende, thotë autori, sepse miti mbahet ende gjallë, ai i ka paraprirë filozofisë shoqërore që lidhet me jetën dhe vdekjen, me botën morale të njeriut. Në dramë, gjakkmarra personifikohet me një kokë prej druri që e shpojnë pareshtur plumbat. Njerëzit e qëllonjë, ashtu si qëllonjë edhe një kokë të vërtetë. Fakti që autori e ka shndërruar kokën në një skulpturë druri dhe qitësit "në pushkatarë të palodhur", mbart shumë kuptime.

Simbolika e dramës është e hapur: gjakkmarra sjell vetëm vdekje. Ndërgjegjja primitive që beson te miti, e çmbilizon arsyen njerëzore duke e dënuar atë në një kthim të përjetshëm¹. Shumë breza shqiptarësh janë përkundur duke pasur për ninullë të vetme krisma armësh. Në dramë parashtrohet e vërteta me sigurinë e moralit të ri, të cilit i përket e ardhmja. Ndaj, personazhet e tij, ata që janë frymëzues të së resë, i kundërvihen me guxim psikologjisë së nënshtrimit shekullor. Ky ishte një këndvështrim i ri kundër mendësisë mitike. Në një intervistë Qosja thotë: "Mënyra e shkrimit tonë për gjakkmarren jo rrallë ishte mënyra e shkrimit të ashtuquajtur folklorik".

Dy nga personazhet kryesore të dramës, Kabili dhe Habili, të kujtojnë vëllezërit biblikë, Kaini dhe Abeli. Ata janë në luftë të papajtueshme mendimesh. Kabili, i pushtuar nga pasione të errëta, më në fund e vret Habinin. Gjithsesi Habili i ka shpallur të vërtetën e jetës që janë të vërteta universale. Vdekja e tij simbolizon ngadhënjimin e mendimit të ri, që arrihet me sakrificë.

Shkaku i vërtetë i vrasjes është se fryma humaniste e Habilit përbën rrezik për ata që duan mungesën e ligjit dhe kështu ruajtjen e privilegjeve. Përfutuesit e çoroditjes morale, ata që veprojnë në rrëmujë, kryejnë vrasje, të cilat i ligjësojnë me gjakkmarren. Perceptimin shoqëror të Kanunit mesjetar si rregullator i shoqërisë pa institucione, forca të caktuara e kanë zhvendosur në kohët institucionale duke shfrytëzuar mendësitë e vjetruara që "lulëzojnë" në shoqëritë e mbyllura. Mes paralizës ideologjike dhe shoqërore, zbulohet edhe një faqe tjetër e zymtë e jetës në një truall ku shekujt mesjetarë kanë lënë gjurmë të forta. Sidoqoftë koha sjell ndryshime. Miti nuk është më i paprekshëm. Në pararojën e shoqërisë ndodh një ndryshim i papritur, kryhet një revolucion i madh.

Kur e botoi *Mite të zhveshura* autori ishte i ri, por edhe më i ri kur i shkroi dramën e librit duke ushqyer një ide të madhe për popullin e vet të përgjakur në dy luftëra: nga "pushtuesi", por edhe nga vetvetja. Qosja me dritën e penës së tij e ka vënë në gjyqin e historisë mitin e gjakkmarres dhe tërë kaosin moral që sjell ai. Ka të ngjarë që autori të shprehë këtu edhe mesazhin e një revolte që fle në vetëdijë: atëherë ai ishte shkrimtar i një populli të ndaluar. Prandaj shpesh duket sikur autori vetë është personazhi kryesor, ai që ngrihet kundër radikalizmit dhe autoritarizmit.

Drama *Sfinga e gjallë* me pamjet tragjike të gjakkmarres, është njëkohësisht revolta kundër absurdit, kundër totalitarizmit që ushqen absurdin. Autori e "zhvesh" mitin

1 *L'Éternel retour* (fr.), concept niçean i përsëritjes së ngjarjeve të historisë e që interpretohet si përvojë me pasojë të rënda, por edhe si hipotezë metafizike e natyrës së njëmendësisë.

duke vënë në dukje idetë që do ta shpien shoqërinë përpara. Me ringjalljen e emrave biblikë thellohet edhe më tej konflikti që çmitizon mitin e gjakkmarres në hapësirat kombëtare. Habili pëson një proces vetëdijesimi dhe thotë i vendosur: "Dua të dal prej kopësë së ujëve dhe të hyj në turmën e njerëzve" (Vepra VIII: 131).

Autori është kujdesur që vlerën kuptimore të dramës ta sendërtojë artistikisht duke qëndruar larg skemave dhe klisheve. Sigurisht, lexuesi apo shikuesi mund të mendojë edhe për terrorizmin e sotëm të ngritur në sistem.

Në studimet kritike mund të përpunohen lloj-lloj interpretimesh, të cilat "autori mbase nuk i ka menduar", - thotë Borges-i. Retorika josppekulative sendërtohet në idetë universale si: emancipimi shoqëror është një rrugë e mundimshme; prapambetjen e largon vetëm zhvillimi; paqja është përgjegjësi e të gjithëve; lumturia vetjake nuk mund të ndërtohet mbi fatkeqësinë e tjetrit etj. Kjo dramë fiton një frymë moderniste, sepse në fund ajo shfaqet si kërkesë e fortë për të drejtat e njeriut.

Beselam pse më flijojnë

Beselam pse më flijojnë, është dramë e dyshimit ekzistencial. Intuita krijuese e Qosjes sjell në mënyrë simbolike jetën dhe vdekjen pranë e pranë. Akti barbar i muosjes lë hapur shumë interpretime. Në një shoqëri që i bindet diktatit të errët të mitit, luhet me jetën njerëzore.

Drama shkrin në një strukturë të vetme dy plane ideore: dëshirën për të jetuar si dhe makthin përpara vdekjes. Vdekja në dramë nuk është e thjeshtë, ajo është një vdekje monumentale, e paralajmëruar nga hyjnitë, sepse një urë, e cila bie sapo mbaron së ndërtuari, mund të qëndrojë vetëm me flijim. Motivi i rrënimit të ndërtimeve simbolike vjen që prej mugëtirës së historisë. Ideja e bukur dhe e kuptimshme për t'u lidhur me tjetrin e për të përqafuar horizonte të reja jete, ka përfunduar thjesht në utopi. Adem Zejnullahu, duke analizuar përbërësit mitikë të kësaj drame, shkruan: "Rexhep Qosja, strukturën tekstore të dramës, e ngre mbi shtresimin mitik-folklorik të baladës *Ura e Shejtit*"². Në këtë rast drama vetë është hipertekst, sepse miti i flijimit është i njohur në baladat e shumë popujve, sidomos të atyre të Ballkanit, ndërsa *Ura e Shejtit* është hipertekst. Miti i murimit³ në kështjellën e Rozafës mund të merret si hipertekst tjetër.

Metafora e mjegullës në dramë ka jo vetëm kuptimin e një kohe të paemërtuar, por mund të interpretohet edhe si mungesë e dritës në mendim. Nga ana tjetër, dyshimet tregojnë se mendësia mitike është tronditur ndjeshëm. "[...] të mëdhenjtë (sunduesit) rrënojnë e ndërtojnë, fajësojnë e viktimizojnë të tjerët sa herë të duan, sidomos të vegjlit [...]"⁴ Fillimi i formësimit të individualitetit

2 Adem ZEJNULLAHU, Përbërësit mitikë në dramën *Beselam pse më flijojnë*, në *Krijimtaria shkencore dhe letrare e Rexhep Qosjes*, f. 304.

3 Legjendës së murimit në kështjellën e Rozafës i referohet edhe Marguerite Yourcenar (Margëritë Jursenar) me novelën *Le Lait de la mort* (*Qumështi i vdekjes*) në librin *Nouvelles orientales* (*Novela orientale*), 1938, përkthyer në shqip nga Mira Meksi.

4 Adem ZEJNULLAHU, *Përbërësit mitikë në dramën "Beselam pse më flijojnë"*, në *Krijimtaria shkencore dhe letrare e Rexhep Qosjes* (vep. e cit.), f. 313.



ose luhatja e ekzistencës për të gjetur formën e vërtetë, **përvijohet me pyetje që shprehin dyshime të mëdha**. Pyetjet, në rrethanat e vuajtjes fizike dhe morale, janë njëkohësisht edhe dëshirë për t'u përfshirë në zgjidhje. Humbja e besimit te miti, çon në kërkimin e së vërtetës: "Pse, atëherë, punën e ditës së sotme nuk e zë mëngjesi i ditës së nesërme? Jemi në të mallkuar, apo janë themelet e vëna gabim?" (Vepra XIII: 179).

Uni njerëzor formësohet së bashku me kohën që sjell ndryshime. Koha është lumi i Heraklitit që rrjedh pa pushim. Beselami, si hero i emancipimit, e kupton se jo rrallë njeriu gjendet në pamundësi për të vepruar. Vuajtjen e tij psikologjike e tregojnë fjalët e Hanës, nuses së tij të re, kur i thotë: "Në sytë e tu shoh dhimbje dhe pikëllim. Prej gojës tënde lëng shtarë rrjedh! Prej duarve të tua pëllumbat kanë ikur! Ç'ka ngjet kështu, më thuaj!" (Vepra VIII: 293).

Në përsiatjen e Beselamit kuptohen ndryshimet e para, që janë sythet e ndryshimit në ndërgjegjet e njerëzve. Molosi dhe Monuni, dy personazhe, ndër të tjerë, ndodhen krah tij. Në pyetjen tjetër: "A mund të jetë e djeshmja / pasqyrë e të sotmes?", shprehet dëshira e Beselamit për të qenë më i qartë me veten. Sidoqoftë, idetë e reja nuk përqafohen aq lehtë. Përballë tyre qëndron fryma e sigurisë që ka ushqyer mbështetja te miti. Elementet e veçanta të kësaj sigurie i gjejmë edhe në mendësinë e disa personazheve të tjera. Beselami në një moment thotë: "Vështirë e kuptoj gjuhën e djeshme, profet! Pse nuk më flet me gjuhën e sotme, që të çlirohem prej dyshimeve?" (Aty: 279).

Shoqëria është e mbingarkuar dhe e lodhur nga paragjykimet. Në të vërtetë në dramën *Beselam pse më flijojnë*, kemi një risemantizim të mitit të murimit. Objekti tashmë është një urë si simbol i hapjes, i lidhjeve të domosdoshme njerëzore me tjetrin dhe jo një kështjellë. Por ura që po ngrën tre vëllezër, ndërtohet ditën e rrënohet natën. Që të qëndrojë ura, sipas mitit, duhet të flijohet një njeri. Janë pikërisht urdhërdhënësit që e rrënojnë! Pushtetet totalitare e duan veçimin nga bota dhe moszhvillimin, sepse kështu zgjatim jetën e tyre. Por flijimi i Hanës shpreh edhe një të vërtetë tjetër të madhe që lidhet me frymën patriarkale të shoqërisë: në themelet e urës do të muroset një grua. Si e tillë drama ka konotacione me lëvizjen feministe që është rishfaqur sot në botë. Hana është viktimë e moralit patriarkal dhe kështu drama mbërrin lartësi të paimagjinueshme.

Fjalët e Hanës para murimit shprehin konfliktin e madh shoqëror që krijon miti: "Ç'doni të bëni me mua? [...] Kujt do t'ia lë djalin? [...] Beselam pse më flijojnë? Beselam pse më flijojnë? Beselam pse më flijojnë?" (Aty: 297). Përsëritja e pyetjes retorike është një moment kyç në dramë. Hana është e kundërta e Norës së Ibsenit që për t'i shkuar deri në fund të vërtetës së saj, braktis fëmijët. Hana nuk do që ta ndajnë nga fëmija i vet, prandaj edhe kërkon arsyen e flijimit. Ajo nuk shkon e heshtur drejt vdekjes barbare dhe hyn kështu në një "madhësi klasike". Nga ana tjetër Beselami pranon të muroset Hana, sepse beson te miti. Pasioni shpeshherë e mund arsyen: "Do të vdesësh që të jetojnë ata! Që të jetojë kush e meriton e kush s'e

meriton agun e ditës së nesërme, vesën e kthjellët në lule, diellin që do të zgjojë bimët, gëzimin që do të sjellë ura [...]” (Aty: 295). Dhe ky besim e pengon atë të shquajë plotësisht realitetin, sepse miti është i lidhur me mendësinë e bashkësisë njerëzore në të cilën është rritur dhe jeton ai. Edhe pse fjalët e tij i përshkon një fill i hollë ironie, vetëdija mitike është bërë strukturë e vetë qenies.

Por, pak e nga pak Beselami zbulon *unin* e vet. Ai fillon t'i shkëpusë me dhimbje lidhjet e brendshme me mitin duke rishikuar të kaluarën në betejën: natyrë / kulturë. Demagogjia nuk luan më rol, se në vetëdijen e tij po përpunohet një gjykim i ri. Në një çast të madh ai e quan Hanën “shenjtorja ime e kotë”. Në fjalët e tij ndihet tejkalimi i vetvetes. Që sot e tutje miti nuk është kuptimi i ekzistencës së tij. Miti nuk do të jetë më një nga ato siguritë ontologjike që e mbron qenien në botë. Struktura shekullore e tij, thuajse e palëvizshme, lëkundet fort dhe pastaj rrëzohet. Në këtë mënyrë miti çmisticifikohet.

Drama është një art i magjishëm. Jeta lëviz para syve të shikuesit me bukuri dhe mizori. Ka një moment në dramë kur ndihet shumë prania njerëzore dhe qytetarët flasin me një zë që të kujton korin në dramën antike: “Ai do që të bëhemi një pa kurrënjë shkallë mes Njerit e të Gjithëve. Ai do që Njeri mos të duket, por të duken të Gjithë. E kur humbet Njeri humbet edhe ajo: të Gjithë” (Vepra VIII: 316).

Zhvillimi shoqëror sjell perëndimin e arsytimit mitik dhe çel horizontin e mendimit logjik që ka në themel një ide të fuqishme universale: mendimi i përparuar e ka gjithnjë me vete motivimin për të dalë fitues. Ky përparim nuk kryhet në një ditë. Fusha të ndryshme të jetës dhe të dijes kanë ndihmuar në krijimin e një bote të kuptueshme, në të cilën njeriu duhet të jetë në qendër të saj. Beselami transformohet çdo ditë e më tepër në mishërues i idealeve të larta, në të cilat veprojnë edhe arsyeja edhe emocioni. Për atë, jetë e re, do të thotë perceptim i ri i realitetit. Ai lufton për një shoqëri humane dhe largohet duke thënë: “Do të kthehem kur të vijë dita ime” (Aty: 329).

Në këtë dramë lufta kundër frymës totalitare është një aspekt i rëndësishëm. Autorin e intereson jeta psikologjike dhe shpirtërore e personazheve që shndërrohen në bartës të ideve të reja dhe dëshiron që kjo dramë të “përjetohet si dramë kundër totalitarizmit”.

Vdekja e një mbretëreshë, monodramë

Sipas studiuesve të veprës së Qosjes, kjo monodramë është e para e llojit të vet në letërsinë shqipe që i kushtohet personalitetit. Autori ka zgjedhur një tjetër mit, edhe më të vështirë për t'u pasqyruar, mitin e pushtetit. Si simbol merret Teuta, mbretëresha ilire. Janë çastet e fundme të jetës së saj në një vend të pushtuar. Kujtesa kolektive ruan qëndresën para armikut dhe jo gabimet e saj⁵, por autori ndalet te monologu i brendshëm duke e zbritur mbretëreshën nga lartësitë mitike të fronit, te jeta e thjeshtë njerëzore. Mbretëresha më në fund e ka hequr dukjen si mbretëreshë dhe tregon disa të vërteta, që janë e kundërta e portretit që kanë ndërtuar të tjerët për të: “A është më e rëndësishme se do të vdesë bazilesha apo është më e rëndësishme se do të vdesë gruaja?” (Vepra XIII: 334). Përsiatja zbulon pjesën e padukshme të unit të saj, të fshehtat e jetës si mbretëreshë; jetë plot mungesa si grua, si e dashur, si nënë.

E vetëdijshme për marrëdhëniet me të tjerët, mbretëresha vihet përballë vetes duke qenë njëherësh gjykuesja dhe e gjykuara. Përsiatja ka ardhur në letërsi nga filozofia dhe idetë filozofike janë pjesë e realitetit dramatik: “Fondi arkaik i realitetit njerëzor

është i pazvogëlueshëm, sepse prania poetike e shpirtit në univers nuk është iluzion, por e vërtetë”⁶. Ideja e vetëgjyimit e shpartallon frymën moniste të mitit. Autori përpiket t'i japë përgjigje edhe pyetjes se “çfarë është qenia”, e cila përshkon tërë filozofinë ekzistencialiste. “Vdekja, nganjëherë, bëhet më e rëndësishme se jeta” (Aty: 337). Mbretëresha vërtet nuk mund t'ia ndryshonte fatin Ilirisë, por e kupton, më në fund, se e ka jetuar jetën gabim.

Duke çmizitur mbretëreshën, autori njëkohësisht çmiziton edhe ata që rrethojnë pushtetin: “Tradhtarët, kumandarët! Edhe pushtuesit do t'i flasin siç më kanë folur mua deri sot, me të njëjtin zë, duke iu përkulur deri te këmbët.” (Aty: 345). Nëpërmjet fjalëve të mbretëreshës kuptojmë se ajo nuk e ka shmangur dot konfliktin me armë dhe pushtimi është bërë fakt i kryer. Edhe pse vonë, monologu i saj sa vjen edhe dhe bëhet më filozofik. Në monodramë pasqyrohet një mënyrë e re konceptimi për figura që i ka ngurtësuar idhujtaria; miti i tyre nuk u qëndron rrethanave, ai zhvlerësohet në mënyrë bindëse: “Kam mbetur vetëm. Mes luleve më kanë çelur gjarpërinjtë. Kam parë dashurinë edhe atje ku është urrejtja, si gjithnjë, besnikërinë edhe atje ku ka qenë tradhtia, si gjithnjë. Kam zgjatur dorën që të më nxirret krahu, si gjithnjë; më është dhuruar buzëqeshja e është shikuar fronit, si gjithnjë. Unë e vdekur, derisa të tjerët do të jetojnë [...]” (Aty: 356). Në fund të jetës mbretëresha e kupton se e vërteta e saj nuk është ajo që besohet nga të tjerët. Dhe tërë bota gjendet e pushtuar nga e vërteta e saj e hidhur.

Bardha, monodramë

Monodrama tjetër *Bardha* e plotëson, si të thuash, harkun kohor problematik të dramave të Qosjes dhe flet për ditët tona. Subjekti është i thjeshtë: një mësuese e mbetur pa punë për arsye politike, shet kukulla në tregun e lirë. Ajo përsiat për jetën e vet e për gjendjen e qytetit. Monologu i saj përshkohet nga një sinqeritet ironik, që i jep frymë bashkëkohore dramës. Kapitalizmi ultraliberal e poshtëron njeriun e thjeshtë, atë që ndërton dhe mban jetën. Teksti ka edhe një simbolikë të hapur: kukullat që shet ajo kanë emra të ndryshëm, por njëri është kukull ajo ia ka vënë emrin Arbërie, e që përbën pak a shumë edhe një dramatikë të tekstit: “Ulja çmimin, ulja çmimin Arbëries - më bërtiti dje një kalimtar i panjohur! - Kujt i

⁶ Georges GUSDORF, *Mythe et métaphysique (Miti dhe metafizika)*, Paris, Flammarion, 1984, f. 25.

duhet Arbëria?” (Vepra XIII: 365).

Në monodramë ndihet trysnia në rritje e kapitalizmit liberal, i cili e nxjerr mënjandë dhe shpeshherë e shtyp individin. Propaganda fabrikon përditë informacione që nuk i përgjigjen gjendjes. Nëpërmjet përsiatjes qytetare, njihemi me mesazhe, në të cilat imagjinata përputhet me të vërteta të jetuara: “Bekimi dhe Agroni janë bërë me fëmijë, kanë kryer edhe studimet. Kanë blerë edhe vetura. Merren me tregti. Shkojnë në Turqi, në Bullgari, në Greqi, në Tiranë e në Shkodër. Shkojnë në pushimin vjetor në det. E Kujtimi im në burg! Për herë të dytë në burg!” (Aty: 379).

Pushtetet e ashtuquajtura demokratike kanë mangësi të mëdha, ata nuk i përfillin njerëzit që zotërojnë të vërteta dhe jo rrallë i detyrojnë të heqin dorë nga idealet e tyre. Ky lloj kapitalizmi mund të çojë deri në zhdukjen e qytetëritimit e të demokracisë. Një filozof bashkëkohor francez thotë se ai synon që ta shndërrojë edhe njeriun në mall tregu. Përsiatja e ish-mësueses është njëkohësisht përsiatje për jetën shoqërore në përgjithësi. Në gjykimet e saj zbulohen sëmundjet morale që e brejnë shoqërinë. Ndryshimet e shpejta janë shoqëruar edhe me harresë kolektive që dëmton pak nga pak identitetin. E vërteta shpeshherë gjendet e humbur nga qëndrimet soditëse apo nga dorëzimi përpara psikologjisë së më të fortit.

Monodrama përveç faktit që sot është edhe lloji më i zgjedhur në teatrot e Francës, Spanjës dhe Italisë, është edhe një prej shembujve shumë domethënës të artit, i cili realitetin e jashtëm historik e sheh të lidhur ngushtë me meditimin e brendshëm duke e konsideruar njohjen e botës ndërjegjësim dhe përgjegjësi qytetare.

Përfundime

Kritika, sado e thellë dhe e gjithanshme që mund të jetë, vetëm mund t'i afrohet një krijimi, ajo shpesh mbetet jashtë asaj mrekullie që është lindja e një veprë letrare. I zhytur në një kënd me gjysmëdritë që ta përfshijë gjithë objektin, Qosja e zhvillon intrigën deri në katastrofë fizike dhe morale. Një lloj purifikimi gjuhësor e gjallëron tekstin.

Mjetet e dramës antike si: mjegulla, zhurmat onomatopeike apo emrat e personazheve e të vendeve, ndihmojnë në zbrëthimin e kuptimeve të fshehta të tekstit. Në tekste shfrytëzohen si duhet edhe elementet e dramës moderne që lulëzon në Europë me dialogun e shkurtër,

me personifikimet, me luftën për lirinë e shprehjes, për të drejtat e njeriut etj.

Përkthimi dhe vënia në skenë e dramave të Qosjes në disa republika të ish-jugosllavisë dhe në vendet ballkanike në vitet '70 dhe '80, i ngjan një udhëtimi meteorik të punës së tij krijuese edhe për arsye se mendimet dhe disa ide që shfaqen në tekstet e tij dramaturgjike, shkojnë drejt ekzistencialës njerëzore. Në dramat e Qosjes mbizotëron paqetësia si në të gjithë dramën moderne.

Pyetjes se “Çfarë epërsie ka gjuha dramatike në veprën e shkrimtarit?”, Qosja i është përgjigjur se “drama është gjini letrare shumë më ‘matematikore’ sesa proza”. Dialogu përdoret mjeshtërisht dhe në funksion të ideve kryesore. Në veprën *Poetika*⁷, dialogu jepet si një mënyrë e veçantë për t'i bërë personazhet të flasin. Eskili ishte i pari që paraqiti në tragjedi dy personazhe për një dialog të fuqishëm. Sofokliu e zhvilloi atë më tej me tri personazhe; ai ishte, gjithashtu, i pari që solli pikturën në skenë ose e thënë me gjuhën e sotme, skenografinë.

Risemantizimi mishëron një kryeide të gjithkohshme se liria është themeli i të drejtave, përgjegjësisë dhe moralit shoqëror.


Në drama i kushtohet rëndësi formës së paraqitjes së kuptimeve. Simbolika, si kudo në tekstet letrare të Qosjes, është zotëruese: “Nëpër gjoksin e shpuar e shoh zemrën time të nxirë” (*Sfinga e gjallë, në Mite të zhveshura*, Vepra XIII : 158); “Dikur, kur ne s'kemi qenë, kur s'kanë qenë as ata që na kanë bërë, por kanë qenë ata që i kanë bërë bërësit tanë, iu ka ngjarë si po na ngjet fatkeqësia plotësisht e njëjtë [...]” (*Beselam pse më flijojnë*, aty: 281); “[...] dashurinë e njeriut aq shpesh e nxit adhurimi i njerëzve të tjerë” (*Vdekja e një mbretëreshë*, aty: 348) “Ka shumë kukulla në të gjitha anët e tregut. Është koha e tregut të lirë”- thonë - [...] Kaloji koha e inteligjencias dhe erdhi koha e tregtisë” (*Bardha*, aty: 363).

Tekstet janë një kapërcim i kufizimeve skematike të dramës sonë, qoftë të asaj historike apo neoromantike, qoftë të asaj me temën e ngushtë të ditës. Me dramat e Qosjes afirmohet *uni* shoqëror, larg angazhimit ideologjik dhe didaktizmit që viheshin re, sidomos, në dramën e realizmit socialist në Shqipëri. Ionesko në shënime të qal ka botuar për dramën, shkruan se “didaktizmi e vret artin”⁸.

Me mundësinë që krijon skena e teatrit, e cila ndikon në mënyrë të atypëratyshme te shikuesi, autori shtjellon disa çështje etike dhe historike, të cilat kanë si kryetemë përdorimin e miteve në kohën e mungesës së tyre. “Për dallim nga pjesa më e madhe e dramës sonë me temën aktuale, e cila afirmon qëndrimin dionisian ndaj jetës, e cila e paraqet jetën si rrugë të shtruar me lule, për dallim nga drama, qëllimi kryesor i së cilës është krijimi i formave të të menduarit politik, *Mitet e zhveshura* afirmojnë qëndrimin kritik ndaj jetës, ndaj formave të institucionalizuara të vetëdijes e të moralit”⁹.

Skena ka shumë rëndësi për rindërtimin e kuptimit të tekstit dramatik, sepse aty shihet një lloj teorie që vihet në praktikë mes pengesave të panumërta të jetës. Teksti dramatik, i shkruar posaçërisht për skenë, është edhe mishërim i përpjekjeve për lirinë e shprehjes. Autori ka besim te forca e ideve për emancipim shoqëror, ndaj gjatë shkrimit të tyre ai është përpjekur të përfytyrojë skenën, për ta shpurë publikun drejt një mendimi jetësor, pa eufori.

Teatri i ditëve tona duhet t'i ketë në repertorin e vet dramat e Qosjes, të cilat përbëjnë risi në dramaturgjinë shqipe me mesazhin bashkëkohor e me ndërthurjen e strukturës së teatrit antik me teatrin modern.



⁷ *Poetika* e Aristoteli është diskutuar nga shumë filologë dhe kritikë për të ditur nëse pjesa e humbur *Komedia* është shkruar apo jo, edhe pse autori i referohet disa herë. Kjo hipotezë i ka shërbyer shkrimtarit të shquar Umberto Eco si intrigë për romanin *Emri i trëndafilut*.

⁸ Eugène IONESCO, *Notes et contre-notes (Shënime dhe kundërshënime)*, Paris, Gallimard, 1991, f. 21.

⁹ Bajram KRASNIQI, *Semiotika e miteve, Në vend të përfundimit, në Mite të zhveshura*, Vepra XIII: 30.

⁵ Qëndresën e mbretëreshës Teutë e përmend edhe Mjeda në poemën *Lissus* (IX, f. 165) dhe në një poemë tjetër që ka lënë në dorëshkrim *Iliria e Epiri* (f. 151), *Juvenilia dhe vepra të tjera*, N. Sh. Botimeve “Naim Frashëri”, Tiranë, 1964.

E nderuara Familje Quku!
E nderuara rektore e Universitetit të
Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
Zonja dhe Zotërinj!

IN MEMORIAMI I DEKADËS SË IKJES NË AMSHIM

Jemi mbledhur sot ta kujtojmë një dekadë të ikjes në amshim të babait, mikut, studiuesit, intelektualit, edukatorit dhe personalitetit të shquar të botës shqiptare, Mentor Qukun. Jemi bashkuar sot të kujtojmë ato veçori intelektuale e qytetare, me të cilat ai si rrallë të tjerë ka ditur ta stolis biografinë e tij, kohën e tij, institucionet ku ka punuar, Shkodrën e tij dhe hapësirën etnike, për të cilën është angazhuar shumë me jetën dhe veprën e tij, i nderuari studiuesi ynë Mentor Quku.

Po takohemi sot të kujtojmë mësuesin, intelektualin, studiuesin e përkushtuar në dhjetëvjetorin e vdekjes së tij edhe pse e di, që më parë se, duke kujtuar Mentor Qukun, ne kujtojmë formimin e tij prej edukatori, përkushtimin e tij prej studiuesi, rolin e tij prej organizatori të Seminarit "Shkodra në shekuj", me të cilën krijoi kolanën më të madhe shkencore të një qyteti të etnisë shqiptare dhe në mënyrë të veçantë studiuesin e pazakonshëm të një shkërimtari shqiptar, Ndre Mjedës.

Le të thuhet këtu, se këto janë edhe referencat për të cilat jemi njohur dhe për të cilat jemi angazhuar gjatë një periudhe prej rreth dy dekadash dhe për të cilat ende nuk jemi ndarë, sepse jemi njohur duke u angazhuar për bashkimin e studiuesive rreth kolanës "Shkodra në shekuj", për të cilën unë fillimisht isha vetëm një i ftuar, bashkë me gruan time, pastaj organizator i studiuesve nga Kosova, që do të merrnin pjesë në Seminar dhe së fundi edhe ideator i disa prej temave me interes për Enciklopedinë e Shkodrës.

Sot po e theksoj faktin se ne ende nuk jemi ndarë, pavarësisht se ai është larguar prej një dekade, sepse reflektimi i njohjes sonë është sforcuar gjatë kohës sa kemi vazhduar të punojmë rreth kolanës për Ndre Mjedën, në të cilën unë fillimisht isha vetëm recensent i vëllimeve të para në shtypin ditor e shkencor, pastaj autor i parathënive të vëllimeve në vazhdim, për të vazhduar si hulumtues i teksteve të botuara në shtypin e Prishtinës për Mjedën, plotësues i bibliografisë së Mjedës dhe si fundi ideator i projekteve sintetike për Kolonën e Mjedës, njëri prej të cilëve, për *Poezinë*, shpresoj të betohet gjatë këtij viti, ndërsa shpresoj se kështu do të veprohet edhe me kritikën e përzgjedhur letrare, në kontekstin historik, krijues dhe publicistik.

I. 'TAKOHEMI NË KUFË – KUFIRI MOS QOFTË!'

Me Mentor Qukun jam njohur fillimisht diku në prill të vitit 2000, kur ai erdhi në Institutin Albanologjik të Prishtinës të bënte ftesën për ata që do të merrnin pjesë në Seminarin "Shkodra në shekuj". Megjithatë, drejtuesit e Institutit i kishin premtuar pjesëmarrjen e disa studiuesve, në tetor të atij viti, pra në muaj para mbajtjes së Seminarit ai kishte vetëm dy tituj kumtesash, e asnjë më shumë. Në mesin e tetorit të vitit 2000, më vjen një letër nga Profesor Jup Kastrati, i cili më kërkonte të ndihmoja organizimin e studiuesve nga Kosova. Ma kishte dërguar numrin e telefonit të Mentor Qukut, por kushtet e një asistenti të atëhershëm nuk ishin të bisedonte me telefonin e postës së madhe, me një drejtor që telefonin e kishte në tavolinën e pushtetarit, prandaj shpejt komunikimin e kalova përmes internetit. Për dy muaj dërgova 46 kumtesa me 56 autorë e bashkautorë. Studiuesit i organizova me një autobus deri në kufirin Kosovë-

In memoriam i dekadës së ikjes në amshim

MENTOR QUKU: SË NJOHA UNË

nga Begzad Baliu

Shqipëri, atëherë i kontrolluar nga Kombet e Bashkuara, ndërsa aty na priste autobusi i seminarit. Mbaj mend se si në mesazhin e fundit në internet (sikurisht duke mos pasur kohë për shkak të ngarkesave të mëdha që kishte) më kishte shkruar: *Takohemi në kufi ora 9*; ndërsa unë duke dashur të kurseja shpenzimet e një asistenti në kafe-internet, i shkruaja: "Takohemi në kufi, kufiri mos qoftë!"

Për herë të dytë e kam njohur kur ai erdhi në Institutin Albanologjik për të përfunduar vëllimet e para të botuara për Ndre Mjedën, që në të vërtetë ishin vëllimet ku ishin trajtuar temat për lirinë dhe albanologjinë. Nuk isha në pozitën, që të flas në një institucion kaq të lartë, e megjithatë e kisha pozitën që të shkruaj për revistat shkencore, sidomos për veprën mbi kontributin e Ndre Mjedës për albanologjinë, ndërkohë që unë shkruajta jo vetëm për revistat shkencore të kohës po edhe një sintezë shkencore për pikëpamjet linguistike të Ndre Mjedës, duke u mbështetur edhe në veprën e Mentor Qukut.

Nga viti 2006 e deri në vitin 2014 kam shkruar shumë recensione, artikuj dhe parathëniet për veprat e Mentor Qukut kushtuar Mjedës, ndërsa në vitin 2012 kam parajllimuar vëllimin "Rilindja e Mjedës (Kërkime në kolanën e veprave të Mentor Qukut për Ndre Mjedën)", të cilin nuk e kam botuar deri tani, në pritje të përmbylljes së kolanës Mjeda. Këtu po i sjell disa veçori të kësaj vepreje të papërmbyllur.

II. THEMELUESI I MJELOGJISË

Duke shkruar recensionin e vëllimit të parë (*Mjeda I, Rinia: 1866-1888*, Tiranë, 2004), të botuar në Kolanën MJEDA të studiuesit Mentor Quku, dhe duke parë projektin e tërësishëm të kësaj Kolane, e cila më tej jo vetëm është zgjeruar, por ka marrë përmasa të tjera kërkimi e vlerësimi, kisha vënë re me kënaqësi se si brenda dijes së albanologjisë po themelohej një disiplinë e re: *mjedologjia*, në përmasën që dijet e tjera simotra europiane kishin themeluar vite më parë, si: homerologji, shekspirologji etj. Prandaj recensionin tim të parë e kisha quajtur "Nga Ndre Mjeda te mjedologjia".

Kisha vënë re jo pa dëshpërim se dijen që nuk kishim mundur ta themelonim për bardët e Rilindjes Kombëtare, Jeronim de Radën e Naim Frashërin, për Shkrimtarin nacional Gjergj Fishtë, apo shkrimtarin më të madh të gjysmës së dytë të shekullit XX Ismail Kadarenë, ja po e themelonim për një studiues, për njërin prej poetëve të gjysmës së parë të shekullit XX: *Ndre Mjedën*. Kështu, për rilindësin e madh Jeronim de Radën, ishin shkruar vëllime të tëra në gjuhën shqipe dhe në gjuhën italiane, e megjithatë një dije a një katedër akademike për studimin e veprës së tij nuk arrihej të ngrihej. Ndonëse për atin e shqiptarizimës, Naim Frashërin, ishin shkruar disa dhjetëra vepra e qindra artikuj shkencorë e publicistikë dhe në emër të tij ishte ngritur ideali i institucioneve shkollorë në hapësirën shqiptare, e megjithatë nuk arrihem dot të themelojmë një katedër akademike a një institut nacional në emër të të cilit do të studiohej vepra e tij dhe njëra

prej vlerave më të rëndësishme të identitetit nacional: *gjuha shqipe*. Po kështu mund të thuhet edhe për Gjergj Fishtë, në emrin e jetës dhe veprës së të cilit janë të lidhura shumë bëma në atdheut tonë, e megjithatë nuk kemi arritur ende të ndërtojmë një institucion, i cili do të merrej ekskluzivisht me jetën dhe veprën e tij, si dhe temën e madhe të idealeve të tij: *për fe e atme!*

Pse mund të flitet këtu për dijen mbi Ndre Mjedën dhe veprën e tij, që po e quajmë disiplinë shkencore: *mjedologji*, dhe pse për institucionin e saj. Sepse për të themeluar një disiplinë shkencore është e nevojshme të ndërtohet edhe metoda e studimit të saj, e për të institucionalizuar një disiplinë shkencore duhet krijuar institucioni i veçantë i studimit të saj. Këto parime themeluesi të kësaj dijeje i ka përgatitur dhe sistemuar një kohë të gjatë, madje edhe atëherë kur nuk i besonte së nesërme së tij. Mirëpo shpresa e mbante të bënte qoftë edhe punën e një murgu sepse përpara kishte Yllin e tij polar: Ndre Mjedën dhe misionin e tij. Pra, projekti i studiuesit Mentor Quku në biografinë e Ndre Mjedës i kalon caqet e një kërkimi për jetën dhe veprën e tij dhe kjo është arsyeja pse mund të flitet për një institucionalizim të kësaj dijeje.

Në qendër të ridimensionimit të kërkimeve të tij për Ndre Mjedën, studiuesi Mentor Quku nga aspekti metodologjik ka vënë metodën gjithëpërfshirëse të shtrirë në hapësirën e lëvizjes së tij dhe kronologjinë e moshës së tij, edhe pse nga njëra vepër në tjetrën, sigurisht për shkaqe kohe dhe mundësie financiare, jo gjithmonë ka mundur të ju përmbahet këtyre parimeve: jeta - misioni - shoqëria - (identiteti); fëmijëria - rinia - pleqëria - (identiteti); vepra: alfabeti - poezia - gjuha - letërsia - (identiteti).

Në të vërtetë, në studimet historike, përkatësisht albanologjike, e brenda saj historiko-gjuhësore dhe historiko-letrare, asnjëherë nuk kanë munguar veprat me shtrirje përgjithëse për autorë a vepra letrare, por asnjëherë deri më tash për autorë, vepra dhe perceptime të tyre në përmasën shteruese, si kjo për Ndre Mjedën.



Deri më tash jo njëherë janë shkruar vepra për veçantitë e disa prej krijuesve, por asnjëherë për të gjitha të veçantat e një krijuesi, si kjo për Ndre Mjedën.

I gjithë kërkimi i tij për të ndërtouar veprën jetësore dhe mendore të Ndre Mjedës është strukturuar në tri linja a parime dhe në disa referenca themelore: a) kronologjinë e jetës (formimi jetësor); b) përmasën e shtrirjes së aktiviteteve shkencore dhe letrare; dhe c) krijimin e referencës bartëse të kësaj periudhe dhe këtij aktiviteti (albanologu, alfabeti, identiteti, gjuhëtari, Liria, albumi, bashkëkohësit), të cilat me një emër do të mund të quheshin referenca identitare të tij.

Po kështu mund të thuhet edhe për parimet që ka ndjekur autori në institucionalizimin e veprës së tij. Kërkimet e tij nisin me themelimin e dosjeve për gjithë pasurinë materiale e shpirtërore të tij, me prezantimin sintetik të dijes, përkatësisht mendimit shkencor të tij, themelimin e bibliotekës së tij dhe më në fund themelimit të institucionit të tij. Nëse dosje të tilla kemi pasur edhe më parë, ato i kishim në përmasa të shkrimit të një vepre shkencore, po jo edhe në përmasa të kërkimeve shteruese, me synim formimin e një dosjeje unike për personalitete dhe kontribute të tyre në kulturën dhe shkencën nacionale. Dosja e Ndre Mjedës, e përgatitur nga studiuesi Mentor Quku i tejkalon caqet e një kërkimi personal: ajo përfshinë dokumentaritetin e jetës së Ndre Mjedës nga fotografitë dhe dorëshkrimet deri te dëshmitë autentike të bashkëkohësve për bëmat e tij; ajo ndërtohet nga tekstet personale me vlerësime të bashkëkohësve të tij deri te dokumentet institucionale të komunikimit me te; ajo e nxjerr Ndre Mjedën edhe nga përmasa e poetit edhe nga veladoni i priftit kryengritës ashtu sikur jemi mësuar ta njohim për më se një shekull; ajo e nxjerr Ndre Mjedën nga prifti i përkushtuar për hapësirën krishtare dhe e vë në plan të parë intelektualin e përkushtuar për hapësirën etnike shqiptare; ajo i vendos përmasat e humanitetit shpirtëror të meshtarit, përtej rrëfimit biblik dhe e vë në plan të parë përmasën semantike të gjuhëtarit përtej ndjenjës letrare brenda poezisë së tij.

Sado nuk është thënë më parë në mënyrë të prerë në studimet historiko-letrare, Ndre Mjedës edhe më parë i është njohur vlera e mjeshtrit të vargut. Në të vërtetë, në studimet historiko-letrare Ndre Mjedës i njëj vlera letrare e gjuhësore e mjeshtërisë së vargut letrar, por jo në përmasën e shqiptarësisë së gjuhës së Naim Frashërit dhe jo në përmasën epike të gjuhës së Gjergj Fishtës. Studiuesit Mentor Quku i takon merita në këtë drejtim, për shkak se para vlerësimit të mjeshtrit të vargut vuri dijen e tij teorike përkatësisht konceptet e tij për alfabetin, si dhe dijen e tij për etimologjinë dhe semantikën e fjalës të saj. Duke i njohur këto dy parime teorike dhe historike Mjeda e bëri gjuhën e tij bazë të fuqishme të ndërtimit përkatësisht strukturimit të vargut të tij. Deri më tash parimet e dijes së ndërtimit të vargut letrar të tij ndërtohet mbi dijen për vargun klasik greko-romak dhe njohjet e tij për teorinë letrare të kohës. Kështu Mentor Quku këtë koncept e barti nga njohja për letërsinë, si dije e përgjithshme, në njohjen për gjuhën



Një nga fotografët më të hershëm që ka vepruar në Berat e, më saktë në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit XX, është edhe Naun Vruho (1913-1988). Ai rrithte nga familja e njohur atdhetare Vruho nga fshati Vërtop, nga e cila më i dëgjuari ishte publicisti dhe atdhetari Jani Vruho (Vërtop, 1863 - Egjipt, 1931). Deri tani pak të dhëna njihen për jetën e kushëririt të tij, fotografit Naun Vruho. Ende nuk dihet ku e mësoi fotografimin dhe ku e praktikoi për herë të parë, veçse mësohet se ai ishte nga nxënësit e parë të shkollës profesionale italiane të Beratit. Me njohuritë e përfutuar nga shkolla, ai ka punuar për disa kohë si teknik i makinave qepëse jo vetëm në Berat, por edhe në Vlorë dhe Fier.

Në ditët e sotme kanë mbërritur disa peizazhe fotografike të Beratit dhe rrethinave, përpos fotove për komunitetin e qytetit dhe fshatrave të tij. Një pjesë e peizazheve të Vruhos janë shtypur në Itali si kartolina me shënimin pas "Foto Naun Vruho-Berat. Kartoleria Kozma F. Cici. Alterocca-Terni XIX". Nga numri në fund të shënimit me shifra romake XIX, mendojmë se fotot e Naun Vruhos janë shtypur si kartolina në vitin 1941 (Nga fundi i viteve '30, Në Itali, në shtyp dhe dokumenta në fund të vitit kalendarik ose në vend të tij, shtohet edhe numri i viteve në pushtet të diktatorit Mussolini me shifra romake).

Aparati fotografik me të cilin filloi shkrepjet Naun Vruho ishte një "Ferrania" me filma celuloidi 6x9. Nuk kemi të dhëna (deri tani) që të tregojnë nëse Vruho ka pasur ose jo studio vetjake në qytet, por vështirë të besohet se ai i lante filmat dhe stamponte fotografitë e tij në studio të tjera. Në veprimtarinë e tij si fotograf ai do të nëpërkalonte brenda objektivit të aparatit të tij edhe simbolet e veçantë vendore të qytetit, të cilat i kanë dhënë gjithmonë Beratit një status të epërm. Këto simbole janë natyrore, si Mali i Tomorit dhe i Shpiragut, lumi Osum, kodra ku është ndërtuar Kalaja dhe kodra mbi Goricë, si dhe ato të dorës së njeriut. Në këto të dytat hyjnë Kalaja me kishat e shumta të saj, lagjet Mangalem e Goricë dhe Ura e saj, Kulla e Sahatit në lagjen Murat Çelepi, xhamitë dhe tyrbet e qytetit etj. Pra, më ndryshe, ai ka përngrirë në celuloid, mandej në letër, peizazhe natyrore dhe urbane.

Një nga fotot më të goditura të grupi të dytë, mendoj se është ajo ku duket Ura e Goricës, kisha "Shën Mëria e Ujërave", lumi Osum dhe rruga që lidhte dy pjesët kryesore të qytetit. Këtë emër kisha, me shumë gjasa, e ka marrë nga afërsia e saj me ujërat e lumit Osum, me të cilin e ndante vetëm rruga automobilistike e asaj kohe, rreth 3-4 metra e gjerë. E veçantë ishte dhe çatia e kishës, e cila kishte tre tambure dhe katër

FOTOGRAFI NAUN VRUHO DHE KISHA E "SHËN MËRISË SË UJËRAVE"

nga Qerim Vrioni



frontone në pjesën e përparme të saj. Ajo ishte ndërtuar poshtë pikës më të lartë të Kalasë. Fatkeqësisht, kjo kishë, me histori për qytetin, u prish (u dogj) në vitin 1940 në kohën e L2B, nga ushtria italiane për të zgjeruar rrugën përmes të cilës automjetet e saj të shkonin në bazën ushtarake të Uznovës gjatë Luftës Italo-greke.

"Shën Maria e Ujërave" ishte kishë e lagjes Mangalem dhe një nga katër më të mëdhatë e qytetit të Beratit. Sipas disa të dhënave, kjo kishë është ndërtuar nga fundi i shekullit XVII, por u dogj në vitin 1800, ndërsa në vitin 1808, ajo u ngrit sërish siç ishte para prishjes në vitin 1940. Kishën e ka pikturuar me shumë elegancë në tri skica anglezi Eduard Lear (1812-1888) në vitin 1848, mandej e ka fotografuar hungarezi Hugo Adolf Bernacik (1929) dhe italianët e Institutit "Luce". Gjithashtu, kishën e kanë fotografuar edhe mjeshtrat vendas të aparatit si Ymer Bali (të përfshirë në albumin

"10 vjet Mbretni", 1928), Irfan Ago (Berat, 1935), dhe bashkëqytetarët e të fundit, Ilia Xhimitiku dhe Naun Vruho në vitet '30-'40. Fotografët, përgjithësisht synonin që shkrepjet e tyre fotografike të ishin të tilla që mund të ktheheshin në kartolina të pëlqyeshme postare për publikun e gjerë. Ajo që i ka tërhequr të gjithë këta, ka qënë forma e veçantë arkitektonike e kishës, pa përfshirë pozicionin e saj buzë lumit, por edhe historinë e saj mbi 150 vjeçare.


Kthehemi tek fotoja e Vruhos. Pothuaj diagonalisht me katërkëndshin e imazhit paraqitet Ura e Goricës, e cila formon në foto një kënd të ngushtë me rrugën buzë lumit Osum, pranë së cilës ndodhet kisha e "Shën Mërisë së Ujërave". Siç kuptohet nga hijet, fotoja është realizuar pak pas mesditës, kur dielli i fortë i ka dhënë këmbëve të urës ndriçim të veçantë dhe hijeshi imazhit, përpos anës elegante grafike të harqeve mbajtës të saj. Vruho e ka fotografuar këtë

kishë nga pika të ndryshme. Të veçanta janë dy foto të saj: njëra nga qendra e qytetit, tjetra edhe më panoramike, nga kodra mbi lagjen Goricë, për të cilën u ndalëm më sipër.


Duke vërejtur fotot e Vruhos që kemi në përdorim, kuptojmë se ai ka shkëlur me pëllëmbë rrethinat e afërta të Beratit për të gjetur pikat më të përshtatshme për fotografim. Madje, për disa objekte si p.sh. ura e Goricës, ai ka zgjedhur pika të afërta dhe të largëta, por gjithmonë nga të katër anët e horizontit. Kjo praktikë shihet edhe për simbole të tjera si Kalaja, lagjia Goricë, ajo Mangalem etj.

Midis këtyre në fotot e tij shihen edhe shumë objekte të cilat sot nuk janë në këmbë, pra janë prishur e shkatërruar, pavarësisht vlerave që ngërthenin në ato kohë dhe që me siguri do ishin edhe më të mëdha në ditët që jetojmë. Kjo kishë, hyn në grupin e atyre objekteve, kulturore, shoqërore, qytetare e fetare me vlera për historinë e kombit, të zhdukura (prishura) në vendin tonë gjatë shumë viteve dhe që emërtohet shpesh në publicistikë si "Shqipëria e humbur". Për hir të së vërtetës, një pjesë e këtyre objekteve janë prishur nga të huajt, por një pjesë tjetër nga vetë shqiptarët, fakt që ngjall edhe më shumë keqardhje sot. Sidoqoftë dëshirojmë që "Shqipëria e humbur" të mos zmadhohet më tej.


Në grupin e fotove të Vruhos që kemi përpara, ndeshim edhe shkrepje që pasqyrojnë ngjarje apo veprimtari të ndryshme shoqërore dhe sportive të zhvilluara ato kohë në qytetin e Beratit. Sigurisht, numri i fotove që kemi para syve është shumë larg atyre që ka realizuar në të vërtetë Naun Vruho, sepse një pjesë ka humbur, ndërsa disa të tjera ndodhen në duar njerëzish që nuk u dijnë vlerën e tyre dokumentare, historike, pse jo edhe artistike. Gjithsesi, edhe me kaq pak foto që janë nën vështrimin e dashamirëve të fotografisë, mendoj se, Naun Vruho, ia vlen të përmendet në historinë e fotografisë shqiptare, qoftë edhe si një nga mjeshtrat e paktë të qytetit të Beratit.



Kisha, detaj



Kisha, pikturë nga Edward Lear, 1848



Me shigjete kisha e Shën Mërisë së Ujërave



Naun Vruho



Me shigjete kisha e Shën Mërisë së Ujërave

Romani "Vetëvraska mbi trëndafil", i Thanas Dinos, të pëshqjellon mendimin e një drejtimi të ri letrar, i cili zanafillën tek ky autor, e ka që në vitet '70, kur autori e identifikon veten në një "fik deti". Një realiteti midis një soc-surrealizmi (kështu e kam quajtur botën letrare të diktuar nga nomenklaturat e Partisë shtet) dhe një realizmi ekzistencial, paksa surreal, që po lindte, nga ai "fik deti", në "drejtimin e ri letrar", në artin shkrimor.

Në këtë përballje estetike, romani i Dinos, trajton problemet sociale e moralitike të dhjetë viteve të fundit të viteve '80, si një arkëtip i një moderniteti bio-shqiptar.

Baza themelore e romanit është realiteti shqiptar, i trashëguar në hapësira kohore të ndryshme, ashtu sikundër Aristoteli, kur analizon Homerin, definoi se "shkrimtari mund të trillojë gjatë procesit krijues, por çastet sinjifikative, situatat, ngjarjet, që autori i trillon, duhet të kenë për bazë realitetin e përjetuar".

Në këtë konceptualitet, autori, me mozaikën narrative, në një amalgamë romaneske, ka aranzhuar bukur artin tradicional, me artin modern. Nga intimiteti, Dino vjel ekstratin shoqërorë, në të përditëshmen shoqërore, vjel mitiken, legjendën, duke i jetësuar ato, çel gonxhet e melankolisë e të kujtesave, në soc-surrealizëm, ku liria në konceptin e gjërë social, është një ëndërr në vagulli. Gjithëçka e testuar metaforikisht, vjen si një grinatë e një kohe, të shplarë, ku njerëzit janë kthyer në robotikë, të një çelësi stërmadh, i humbur në mjegullat e kohës, larg një Gow-esti, në një horizont të errësuar, ku të vërtetat jetësore, perceptohen, përmes një realiteti ekzistencial, një substancialeje të dëshiruar, e cila konceptohet në kahjet e një neorealizmi.

Tiparet e një neorealizmi të tillë modern, në romanin "Vetëvraska mbi trëndafil", shpërshfaqet si në dykohë: e shkruara e viteve '80 dhe e sotmja me kontaminimin e të shkruarës. Të dy kohët vijnë të fokusuar në hapësira tekstuale si të pakohë, si pjella të njëra-tjetrës, ku e djeshmja vjen me një fyturë tjetër, por me të njëjtën përmbajtje, në subjektivizmin e saj, si e sotme. Kjo prani e të djeshmes në alegorinë dhe nëntekstin e saj, si e sotme, shndërrohet në një tipar esencial në shoqëri, si një kontaminim shoqëror dhe moral.

Ky është themeli dhe kapriatate eseistike, mbi të cilat, shkrimtari Thanas Dino, ndërton drejtimin e ri letrar, sa të përvetshëm, aq edhe modern, jasht një lineariteti, me një mozaikë rrëfimorë, ku çdo kapitull ka tonin e vet të ngjyrës, por në tërësinë e tyre, ato përbëjnë, një alternativ tonesh, të ndërfitura, që marrin e japin nga njëri-tjetri, duke plotësuar karaktere, fizionomira prototipesh.

Në narrativën e romanit, autori, duke patur fatin të jetë një vrojtues i imtësirave artistike, nga jeta si publicist, ka ditur të nxjerrë në pah, madhështinë e të thjeshtës në artin shkrimor. Ndaj dhe natyra në faqet e këtij romani, vjen me imputet e saja, në funksion të plotë artistik, përmes simboleve, anaforave, paralelizmave figurativë. Autori vjel nga natyra, në madhështinë e kësaj të thjeshtë, imputet e domosdoshëm artistikë, duke i vënë ato në funksion të qëllimit dhe idesë, ku: "Si një bark gruaja kish dhënë histori dhe njerëz, kjo baltë e tij"

Në konceptimin estetik, Thanas Dino, siç duket, në ndërtimin e kapriatave narrative të romanit, ka pasur në vëmendje, Mihail Bahtin, i cili thekson: "romani modern është bërë kryeprotagonist i dramës së zhvillimit letrar të kohës së re, se ai shpreh, para së gjithash, tendencat e lindjes në botën e re, se ai është zhanri i vetëm, që lind në botën e re, kështu që qenësish është identik me të". ("Çeshtje të romanit", botim "Rilindja", Prishtinë 1980, fq.10).

Në këtë konceptim, romani modern, "Vetëvraska mbi trëndafil", nuk paraqitet në trajtë të plotë lineare, por në trajtë të dizintegruar. Kjo ndodh, jo vetëm në paraqitjen e ngjarjeve dhe situatave, por dhe në paraqitjen e shumisë së karaktereve, prototipeve të personazheve. Gjithëçka vjen si një mozaikë në azhurnim, me situatat

Vëzhgime kritike mbi romanin "Vetëvraska mbi trëndafil" i Thanas Dinos, botim "Neraida"

TIPARET E NEOREALIZMIT MODERN TË NJË ROMANI

nga Vladimir Muça

e kushtet jetësore të kohës. Me regresin e marrëdhënieve ekonomiko-shoqërore, kulturore, ndodh dhe regresi moral dhe shoqëror, ku idealizma dhe të vërtetat jetësore humbin në aktualitetet e kontaminuara.

Një roman i tillë mozaik, në konceptimin estetik, me një strukturë narrative, paksa rrebele, i shpenguar në hapësira të gjëra shoqërore, në pak hapësirë librare, i mundëson autorit, që në një trajtë të tillë, të shfaqë, jo vetëm realitete nga më të ndryshmet, por në përbashkësi, të na japë një tablo komplekse të shoqërisë. Këtu qëndron përparësia e narrativës moderne të romanit të Thanas Dinos, në fuqinë e nëntekstit, si zëdhënës i shprehive ideore të autorit. Kjo vjen dhe si një përparësi e evoluar në "drejtimin e ri letrar", por dhe njëkohësisht si një vështirësi e fuqisë kreative të narrativës.

Autori përmes skanerit të ficionit, të shkurtësisë, ka hedhur në platenë romaneske, ngjarje e fenomene, përmes një ekzistencializmi, sa real, aq dhe surreal për kohën që përjetoi, si mjeshtëri i një estetike të re, paksa hespanike në shkurtësinë letrare.

Autori e ka pasur te qartë estetikisht një sentencë të Mihail Butorit se: "...Stili nuk është vetëm mënyrë në të cilën zgjedh fjalët brenda një fjalie, por dhe mënyra me të cilën fjalitë ndjekin njëra-tjetrën, kapitujt dhe episodet". ("Çeshtje të romanit", Mihail Butor, "Rilindja" Prishtinë 1980, fq.267).

Si roman modern, një nga kapriatate cungalmbajtëse në narracion, është veçoria estetike e dialogut, i cili vjen i rrjedhshëm në polifoninë e fjalëve, përmes një dramaciteti dialogues, e monologjeve, si një veçori e psiko-analizës filozofike të ngjarjeve e fenomeneve ku: "Të gëzohem nga mbajtja në duar e fatit të tjetrit, të bëhem i atillë që të më pëlqejë vuajtja që mund t'i shkaktoj atij". Një demonstrim i tillë i dypersonalitetit, reflekton dyfytësinë e nomenklaturave partiake e pushtetare, në raportet shtetar-pushtetar.

Mënyra e paraqitjes së këtij dramaciteti, si filozofi e jetës, e dialogut, në romanin modern, nuk është një shpikje e kohës së re. Kjo dukuri e ka zanafillën, që në veprat filozofike të Platonit: Pushteti, Gostia dhe shumë të tjera. Në trajtë dialogu, flitet për çeshtje e marrëdhënie të ndryshme jetësore. Në këto hulli, dialogu duhet të jetë sa më afër një realiteti ekzistencial, e të mos hedhë në

skakierat letrare, devulgavitet. Thanas Dino, me përvojat e tij jetësore, i është shmangur me sukses dukurisë devulgative, duke e brumëzuar dialogun, me ekstrakte nga fjalë të urta të urtësisë popullore, duke e bërë të këndshëm dialogun, me këto "mballoma artistike", siç i quan Umberto Eko, në librin "Fjalë për letërsinë". Këtu e ka zanafillën edhe shmangia nga trajtat e thata diskursive, filozofimi narrativ gjatë prozadorisë.

Kapitulli i faqes 76, është ndërtuar aq bukur, dialogu midis Natashës dhe Ylliut, sa dramatik, aq edhe elokuent, në shprehinë e të vërtetave. Ai vjen si më sinjifikativ, përfaqësuesi më tipik i një stili të trioruar, në triorin e një publicistike të lakmuar. Autori në këtë dialog lakonik, luan bukur me kontraversin onomanistik, ku Tao Tao, vjen si një prototip i një paradigme, të së ardhmes shoqërore, një Tao Tao që i zuri vendin të vetvritit (Mehmet Shehu).

Kapitulli "Kaldaja ndizet në qershor", është përfaqësuesi më tipik i një grotesku dhe humori të thukët, mburjtur me ekstrakte të folkut popullor, vjen si shembull i një narrative të re në përmbajtje dhe aq e mbështetur në themelet e traditës. Apo monologu psiko-analitik, në filozofinë e një jete të tillë, të kontaminuar ku: "Qytet i paparafytyrueshëm dot, edhe me vdekjen, kërkon të imitojë udhëheqjen e vet, mendoi një çast, por përnjëherë, e shtyn tej atë mendim, si ta nxirrte jashtë trurit" (Shkrimtari Ylli Nano). Mjafton ky pasazh, ku psiko-analiza e kontaminimit shoqëror, kur "qyteti gdhiet i dehur", ku u arrit një stad shoqëror i spiunllëkut, ku letrat anonime, vijnë si gjenerues të rangeve më të ulta shoqërore. Autori në nëntekst, i bën anamnezën shoqërisë, duke na dhënë recetën e psiko-terapisë.

Autori përmes një humori të hollë, të një grotesku alla Ashek shqiptar, e bën të këndshëm rrëfimin, përmes të vërtetave të Cimbok Kallajxhiut, të Mbrezhanit dhe Kallajxhiut të Malëshovës, me bodec, piper e raki mareje.

Kjo e vërtetë e intriguar dhe përmes ficionit autorial, më solli ndërmend ushtarin e mirë Zhvejk, me një natyralizëm shqiptar, në dialogun e Nuri Neverit dhe Sefer Seferit, ku sekretari i Partisë i rekomandon: "Vurua vajat letrave, të ngjethen e të frymëzohen edhe ata, nga ai, si qan populli", ku: "Brenda ditës, dhimbja e ka bërë zemrën e popullit me kallo,

- kish thënë Sefer Seferi".

Trashëgimia e të vërtetave historiko-shoqërore, e alternuar bukur me ficionin autorial, nga brezi në brez, ku atë e bijë kanë një rrugëtim, vjen edhe si një përballje e të kundërtave, jo vetëm në lëmin shoqërorë, por edhe në atë shpirtërorë. Në këto kontekste, duke folur mbi "Romani dhe e vërteta", Mihail Glllovijski, sintetizon se: "... e vërteta është element i strukturës së veprës letrare, dhe njëherësh faktor themelor, në relacionin me lexuesin, vetëdijen, bindjet, besimin e tij". Mihail Glllovijski "Çeshtje të romanit" "Rilindja" Prishtinë 1980, fq.223.

Kjo sentencë estete, më bind, se autori e ka ndjekur, kapitull pas kapitulli, në të vërtetat historiko-shoqërore, autorin, ku mes përballjeve, reflektohet në ardhmërinë e pasardhësve, prosperiteti dhe zhvillimi kombëtar.

Në dialektikën e zhvillimit të shoqërisë njerëzore, vetëm një përballje e tillë gjeneron zhvillim, aq më shumë, kur stigmatizohet, në përballjen me vetveten, definoi autori në epilogun e romanit ku: "Viron Jarazi mundahej ta fshihte xhelozinë dhe karrierën e tij, por brenda, ajo e kafshonte si kone e vogël".

Nëpër kapitujt e romanit, gëlojnë një mori personazhesh të cilët plotësojnë njëri-tjetrin, duke na dhënë prototipin e njeriut të dogmatizuar, nga opiumi i sitemit totalitar. Shpifja, perversiteti, imoraliteti, janë indet patogjene, që po e gangrenizojnë këtë shoqëri njerëzore, gjer në atë shkallë, saqë Viron Jarazi, Sekretari i Organizatës së Partisë i gjimnazit, si një zhvejk shqiptar, u thotë mësuesve: "Unë jam Enver Hoxha i shkollës, organizata më ka zgjedhur mua, udhëheqës të sajina dhe tuajin".

Në këto kontekste, autori, arrin të eksplorojë, aspektet themelore dhe esenciale, të shoqërisë shqiptare në totalitarizëm, në një këndvështrim sa vertikal, aq edhe horizontal, ku ligji i unit, idolët, janë gjeneratorët e një regresi të tillë shoqëror. Në misionin e tij, shkrimtari, arrin të bëhet ndërgjegja e misionit që ka letërsia dhe artet, në zhvillimin e ndërgjegjes shoqërore. Në këtë mision, Thanas Dino, me prozën e tij, u ngjit më lart, dhe shpërvjel pasionet dhe kundërshtitë në planin shoqëror.

Me kulturën dhe bagazhin e një publicisti, e fituar dhe nga të qenurit gazetar, mes personazhesh të krijuara me nënkuptimorën emrore, autori ka hedhur në skakierën romaneske, shumë personazhe realë. Përmes një paraleleje të tillë, në fushën e artit shkrimor, Thanasi bën retrospektivën, me personazhet historikë, e zhvesh romanin nga lëvozhga e një grime ekzistencializmi surreal, duke shtuar dozat e një realizmi ekzistencial, ku dialogjet, monologjet, pasazhet poetike të jetësimit të personazheve, sjellin aromat e kumteve njerëzore.

Gjithëçka aranzhohet bukur, përmes shoqërisë, përmes një alegorie e grotesku të thukët, ku elementë të fjalëurtave popullore, ndrisin si xinxife ku: "Sa më shumë nata kalonte, aq më shumë përkundej dhe vuiste pylli". apo, "Mos janë qerpikët e pishave që kërkojnë sy?".


Një ngarkesë e tillë me pasazhe poetike, fjalor të përzgjedhur, dialog dramatik e ekstra jetësorë, "mballomat" e mrekuallueshme në vendin dhe sasinë e duhur, nga fondi i urtësisë popullore, e sjellin këtë roman tek lexuesi, shlodhës, me fichione që haperojnë nga kapitulli në kapitull.

Kjo polifoni e fjalëve, i jep rrëfimit vlera të veçanta, sintetizon gjithëçka, nga sentenca e Franc Kafkës se: "Lumturinë do ta gëzoja vetëm në rast se do të mundja të lartësoja botën te pastërtia, te e vërteta, te liria e pandryshueshme". (Franc Kafka 1917)

Ndaj ky roman, vjen si një gjetje perfekte e kujtesave njerëzore, e emocioneve, e përjetimeve, anktheve jetësore, të cilat vijnë me statusin e një pasaporte individuale, mbartur si një kredo, e një anatemimi të kohës dhe bashkëkohësve.

Me këtë roman, autori arrin të bashkojë në një amalgamë, kodet e artit shkrimor dhe kodet e jetës.

Qershor 2024



UDHËKRYQ

Sa herë ndodhem në udhëkryq,
Marr llullën - relikte të tim eti.
Dhe pi duhan mendimesh.

Nëpër rrathët e tymit
Më shfaqet fytyra e tij
Mbushur me brazda ugari.

Nga zgavrat e thella të syve
I buron
Dritë e kulluar eshtrash.

Pas tij, vjen nëna
Me kanistër meraku në dorë,
Duke mbledhur nëpër gjerdhet e sherreve
Këngë nepërkash.

TË LEXOSH NJË PEMË

Të lexosh një pemë
Bëhesh i bukur!...

Hija është thjesht një domethënie,
Kënga e zogjve është një domethënie,
Kurora është gjithashtu një domethënie,
Veçse trangu
Është një kult.

Të adhurosh kultin e drurit do të thotë:
Të mësosh alfabetin e lotëve,
Të lindjes dhe vdekjes,
Të djepit dhe arkëmortit,
Që rriten së bashku në barkun e tij -

Vëllezër siamezë
Pa u dukur.

Të lexosh një pemë
Bëhesh i bukur!

XHAKETA E GRISUR

Xhaketën time e kanë grisur shpesh
Ca gjëmba mërie,
Që i hidhnin tinëz,
Mbrapa shpinës sime.

Nëna thoshte se ishte pikje syri
E ma qepte
Me fill vetëtime.

TREDAFIL

Sa herë më shpon një gjemb trendafil,
Petalet marrin ngjyrën e kuqe të gjakut
E unë bëhem dashuri.

Sa herë klith një trëndafil,
Unë bëhem dhimbje...
Diku ka vdekur një njeri.

QIELLI I OBORRIT


Ma rrëmbeu dikur një harabel
Qiellin e fëmijërisë,
Qiellin tim të vogël, të vogël
Sa oborri i shtëpisë.

Ma rrëmbeu bashkë me tatuazhet,
Që i bëja me prush xixëllonje.
Me hënën që gozhdoja netëve mbi qerpikë
Me tymrat e zjarrit që i mblidhja nëpër
gishta
E ngrija gracka për yjet.

Ma rrëmbeu në sqep e iku,
Pa ditur se ku.

I pyeta gjithë zogjtë në fluturim
Por askush s'e kishte parë qiellin tim.

Veç vonë, e vonë
Ca shpendë shtegtarë
Kishin parë diku



Në guvat e një reje të vjetër shirash
Nji varr harabeli.

Mbështjellë
Me një qiell të vogël oborri.

KUR QANTE ZOGU PËR ZOGUN

Kur qante zogu për zogun
Në kurorën e gjelbëruar të shelgut,
Babai thoshte se kishte uri.

Nëna kujtonte merakun për të vegjëlit
Ndërsa vëllai heshtte
E i shihte me bisht të syrit.

Shelgu uturonte
Nga zjarri i blertë
Që i digjte trangun.

Ishte koha kur qante
Zogu për zogun...

ZJARR GJINKALLASH

Më thoshin se dikur gjinkalla kishte qenë
Xhind i dashuruar me zanën e pyllit.
Ikte netëve, përvjedhur nga fisi
E i këndonte
Këngë zemrash.

Por fati i origjinës e dënoi me vdekje
Të digjej
Në zjarrin e këngës së vet.

Unë qeshia me rrëfime të tilla
E i quaja besime përrallash.

Derisa një ditë

Më rrëmbeu edhe mua një zanë pylli
E ma dogji shaminë e beqarit
Në zjarr gjinkallash.

UDHA E PANJOHUR

Më ftoje të shkonim në faqen e një dimri
Ku hëna luante me ujqërit e bardhë
Të bënim muzikë me gjetet e pyllit
Të ktheheshim të dy në drurë oshënarë.

Më thoshe se dimri rrethohej nga ujërat,
Që ngjanin aq shumë me lumin Jordan.
Por mua më trembte ajo udhë e panjohur
Dhe ty të shikoja, si të shkruar në Kuran.

TRINITET

Kur zëri im ngecet në gërmat e emrit tënd,
Grindem me tingujt,
E bëhem firë.

Ngre sytë nga qielli
E lutem
Të shoh vdekjen time.

Qielli mbushet me dritë
Nëpër dritë shfaqet vdekja.
Vdekja që i njuh burrat e vërtetë nga
thirrja e tyre
Kur zëri u ngecet në gërmat e një emri.

Pastaj thërras sërish emrin tënd
E zëri më bëhet muzikë.

Atë çast
Asgjë nuk ekziston rreth nesh,
Veç unë, ti,
Dhe vdekja
E kthyer në dritë.

PËR NJË FIJE DYSHIMI

Ti e ngjeve qerpikun me helm mërish
Dhe e ngule si shtizë
Thellë në gjoksin tim!

Plaga u bë
Pus Meke.

Pastaj erdhën pelegrinët
E hodhën gurë.

Pas tyre erdhe ti
Hoqe unazën nga gisht
Dhe e hodhe brenda tij.

Nga thellsia e pusit
Buroi mbytur një rënkim.

Unaza doli sërish
E bërë flutur
E u ul
Mbi supin tim!

KAFSHOJE MOLLËN E MËKATIT

Kafshoje mollën e mëkatit, mos ki frikë,
Zotat i vrau një çunak dikur,
Me goxhdët e kryqëzimit.

Eva nuk ngrihet më nga pluhuri
Adami po fle gjumin e përjetshëm të
miteve,
Nërsa unë jam këtu, pranë teje
I gatshëm të ndeshem me 1000 zotër të
rinj.

Kafshoje mollën e mëkatit, mos ki frikë.
Të isha pemë e frutit të ndaluar
Do mblidhja nën hije
Gjithë Evat mëkatare
Endur nëpër mote.

Se mëkati i Evës është
Krijuesi i vërtetë i kësaj bote!

MOTRAT E MIA TË BUKURA

Kur dilnin motrat e mia,
Veshur me fustane zjarresh,
Në udhë dëgjohej
Kënga e të marrëve.

Nga ballkonet e shtëpive
Mbanin iso
Menteshat e dyerve.

PEMA E DASMËS SIME

Ditën e dasmës
Unë mbolla në gjok një pemë,
Që rrënjëzoi në shtatin tim
Skaj më skaj.

Sythat që çelnin
Gjelbëronin
Në sytë e saj.

FURTUNA E QERSHIVE TË EGRA

Kur ti të hapësh shtegun e grindjeve,
Do shpërthejë furtuna e qershive të egra
Mijëra flutura të bardha
Do shqyejnë si bisha frymëmarrjen tënde.
I mundur do përpëlitesh
Në zjarrin e hakmarrjes
Që fiket pak nga pak brenda teje.

Kur ti të pushtohesh nga krahët e saj
Nga krahët që kundërmojnë
Aromën e luleve të qershisë së egër
Ajo sërish e ka fituar betejën
Duke mbyllur shtegun e grindjeve
Me drynin e artë që fsheh nën ije.

Se gruaja është
Furtunë e qendisur
Me flutura të bardha qershije.

Ai njeri i vetëm ngjante si një statujë në parkun qendror të qytetit. Rrallë e lëvizte kokën, si t'i peshonte mbi supet trefishin e asaj që ishte. Thinjat i kishin mbuluar veshët, por nuk ishte aq i moshuar sa dukej. Njerëzit që kalonin atypari ndaleshin një çast dhe nuk ia ndanin sytë, a thua se në portretin e tij kishte diçka enigmatike. Por jo, sytë e tij nuk thoshin asgjë. E çfarë mund t'i shohësh një njeriu, nëse nuk i sheh sytë! Vetullat? Hundën? Mjekrën? Të ishte ndonjë mis, mbase do t'i shiheshin linjat. Të ishte ndonjë mundës, do t'i shiheshin muskujt. Kurse ai që si një qenie e ngurtësuar mes gjelbërimit. Mbante një libër të bëshëm në duar, që e rrotullonte ashtu kot, si duket zakoni i tespieve paradokohe. Nuk është se nuk i kishin bërë përshtypje ato shikimet ngultas të njerëzve, sa erdhi një çast e nuk i durua më, por nisi t'iu hakërrehej:

“Ore, mos jeni çmendur gjë, që shihni ashtu?”

“Çmendur, ne?”

“Ju, e kush tjetër?”

Ata e këqyrnin dhe më me ngulm, pikëzuar në dy anët e fytyrës. Nuk kishte dyshim që e shihnin nga veshët. Po çfarë mund të kishin veshët për t'u parë! Nëse kishte një si atavizëm në kokën e njeriut, ata ishin veshët, me ato llatat si kërpudha. Nëse për sytë kishte veçse batuda gazmore, si veshgjatë për gomarin, i curron veshët si lepuri, ndërsa mua më pëlqente fort fjala veshtak. Nejse, nuk ishte punë gjuhe kjo. Burri i botës ishte fantaksur.

Kaloi një doktor dhe njëri nga ata soditësit, iu drejtua:

“Këqyre, doktor, këtij njeriu i janë rritur veshët! A mund t'i bëni derman?”

Doktori pa me vërejtje, por nuk dalloj ndonjë gjë. Tjetri këmbënguli:

“Ta them unë, veshët e tij janë rritur dy gisht vetëm javën e fundit, deri në darkë bëhen tre gisht!...”

Kjo tërhoqi një turmë kureshtarësh, që gjer atë çast kishin qenë indiferentë. Njeriut i dukeshin veshët dhe pa u rritur aspak, jo më po të rriteshin, jo me milimetra, por me gisht!?...

Burri veshërritur nuk po kuptonte asgjë. Ç'ishin ata njerëz? Ç'donin aty, rreth tij? Ai tashmë i kishte tejkaluar ata! Ai këndej vahut, ata matanë duke pritur kohën. Kështu mendonte. Doktori u largua duke thënë se ai njeri nuk ishte ndonjë i sëmurë, rritja e veshëve, nëse ndodhte, nuk ishte diçka patologjike. Nuk e përmbante asnjë literaturë. Nuk ishte as në Gines... Më kureshtarët vendosën të rrinin aty nëpër stolat dhe gëmushat e parkut deri në darkë, të shihnin nëse më të vërtetë veshët e atij burrit do të rriteshin dhe një gisht atë pasdite? Se vajmedet, ashtu nuk do të ndaleshin pa u bërë tri pëllëmbë, në pak kohë! Po a duroheshin tri pëllëmbë vesh në të majtë e tri në të djathtë? Nuk ta rrokte mendja, sado vesh-llapush të ishte njeriu!...

“Mos jeni gjë dijës? Nga e dini ju se veshët e tij do të rriten në progresion gjeometrik?...”

“Ah, jo, jam thjeshtë një so-ditës si ju, por ju ende nuk jeni përqendruar te veshët e tij. Po të përqendroheni sadopak, do të vëreni se dy llatat e veshëve, që ia kanë mbuluar pjesërisht flokët, era i lëviz si gjethe fiku.

Njerëzit në park zunë të shtoheshin, sikur do të ndodhte ndonjë mrekulli. Me



NDUE DEDAJ

Burri me veshë

siguri që lajmëronin njëri-tjetrin. Nisen të viheshin edhe kamera, në pritje të sensasionit. Një njeri me tre gisht veshë më shumë se të tjerët, në një kohë aq të shkurtër, ishte ta shkundje tik-tok-un nga Tirana në Tokio.

Po sikur ai burri të luante nga vendi e të ikte? Doli garant lulishtari i parkut, veshur me bluzë të blertë, se ai aty e ngryste çdo ditë.

Veç kur u pa këshilltari i Presidentit me një dekoratë të lartë, që erdhi e ia ngjiti në gjoks burrit, që, si duket nga emocioni, veshët iu bënë spec i kuq. Aq shpejt ngjau ai dekorim, sa kamerat ishin krejt të pavëmendshme, si të përgjumura dhe nuk filmuan asgjë. Por, gjithsesi, u bënë nja dy-tre shkrepje amatore, kështu që çasti solemn u fiksua në celuloid.

Njeriu gjysmë statujë befas u gjallërua. Duket se mezi e kishte pritur atë çast.

“More, kemi kaq orë këtu, duke pritur... dhe nuk pyetëm se kush është ky njeri?” – pyeti një djalosh esmer.

“Aha! Me gjasë, Politikan i rënë nga vakti, kështu bëjnë me disa kokoroça si ky, i dekorojnë që të mos iu përzihen nëpër këmbë”, foli si kompetent njëri nga të pranishmit.

“Mundet që është Deputet, duket që e kanë përjashtuar nga grupi parlamentar, duke e lënë si peshkun pa ujë!” u hodh një tjetër.

“Jo, ky është Shkrimtar që i ka rënë dielli në kokë dhe pikë!”

“Historian, ndoshta? Nuk ia shihni se ç'çantë ka? E zë krejt Mesjetën aty!...”

“Për zotin, asht Filozof! Apo si u thonë këtyre që flasin tash e parë në televizion?...”

“Bëj be që ky është Oligark, o i atyre “Gjirafave” të nalta të Tironës, o i plehra-përpunuesve, o i HEC-eve grabitqarë në male...”

“Ore, që ky është një Gjësënd nuk ka diskutim, po se çfarë është fiks nuk e dimë!” - tha dikush andej nga cepi.

Kaloi sërish doktori me bluzën e bardhë, njërën mëngë veshur, tjetrën zhveshur.

“A ju thashë se ky tipi nuk është për doktor? Kurse ju ngulnit këmbë, a thua

se po i binte të fiktë nga veshët”.

Aty në të errur u dha kryetari i Bashkisë me “çelësin e qytetit” në dorë sa një drapër, që ia vari në qafë zotërisë gjithë përlulesi dhe pasi e përqafoi ngrykaz u largua. Së afërmi ishin votimet e babushi i parkut kishte farefis të gjërë atje në katundishtën e tij nga e kishte origjinën...

Merrej me mend që kishin të bënë me një njeri të rëndësishëm, por se cili na ishte ky xhentelmen, askush nuk i jepte dum?

“Nuk ju falet, a thua se ky është ndonjë jashtëtokësor?” - u dëgjua zëri i mprehtë i një gruaja, që siç u mor vesh më pas, ishte kryetarja e shoqatës së VIP-ave për atë rajon.

“Si ta gjejmë, nuk e ka të shkruar në ballë emrin!” - iu përgjigjen asaj.

Dhe gruaja u nis ta pyeste vetë drejtpërdrejt. Ishte njeri dhe jo mumje, do të fliste se s'bën. Nuk u besoi syve kur pa se libri që ai mbante në dorë kishte në kopertinë fotografinë e atij vetë dhe mbi të shkruhej “Don Katrapuzi” - libri i bëmave të jetës - vëllimi i dytë (çfarë ka thënë ai për veten dhe çfarë kanë thënë të tjerët për të). Prandaj atë libër nuk e lëshonte nga dora. Si të mbante shpirtin e tij mes gishash duke e përkëdhelur. Gruaja vuri re se në stolin e drunjte bri tij ishte një çantë meshini me grykën gjysmë hapur, ku sytë i zunë një tjetër libër të vëllimshëm, që kishte të njëjtat gjëra në kopertinë, fotografinë e tij, titullin me germa kapitale që ishte emri, me të vetmin ndryshim se aty shkruhej: vëllimi i parë (jeta dhe vepra). Deshi ta shfletonte, të merrte sadopak vesh se cili ishte ai, por burri i vuri dorën sipër dorës së saj, duke i thënë “Prit, ka punë puna!”

“A je ti një VIP?” nuk iu ndejt asaj.

“Paske shumë fjalë! Apo ju të shoqatave kështu jeni të gjithë? Ngaqë nuk keni gjë tjetër në torbë, keni vetëm fjalë!” - i tha ai.

Gruaja, si për të treguar se nuk kishte vetëm fjalë, por dhe sajdi, nxori nga çanta e saj rozë një fletë të trashë kartoni me lulka ku shkruhej “Mirënjohje VIP” dhe iu drejtua atij:

“Të pyeta për emrin, që ta shkruaja

këtu! Me siguri që jeni një VIP?” - tha ajo.

Ai nuk foli, por vetëm nënqeshi, hajde e merre vesh pse - në. Ndërkohë që turma nuk ua ndante sytë veshëve të tij, pasi po afronte koha t'ia masnin, nëse i ishin rritur dhe një gisht...

Sakaq, në anë të rrugës, u ndalua një veturë pa ngjyrë, prej së cilës doli një krijesë gjithashtu pa ngjyrë, që mbante në dorë një qese telefoni. Nuk u kuptua ishte femër apo mashkull ai që zbriti, shkoi pranë burrit me veshët ngritur dhe i zgjati gjënë e rëndë që ishte brenda asaj mbështjellëse xixëlluese. VIP-i i tha gruas së shoqatës që ta hapte. Ishte vëllimi i tretë i bëmave të tij (album fotografik - pesëqind faqe).

Nga ngazëllimi që ndjeu, VIP-it iu morën mendtë. Askush nuk e shihnte më nga veshët, përpos njërit që i ishte afruar në frymë e që ishte so-ditësi.

“E sheh, doktor, që fole para kohë, kur the se ky nuk ka nevojë për doktor?”

“Të vërtetën thashë, nuk e ka asnjë literaturë, as Gines-i, shihni kur t'i kalojë!...”

Burri provoi ta fuste librin e sapoardhur në çantë, bashkë me atë tjetrin që deri atë çast s'e kishte hequr nga dora, por kur pa se çanta nuk i zinte tre librat, i kërkoi lulishtarit një thes, që ai e mbante për të mledhur gjethet e vjeshtës dhe i rrsi aty librat.

Me biografinë e tij stivosur në thes u nis për në shtëpi, ku e prisnin djemtë e vajzat, nipat dhe mbesat, që nuk ia kishin idenë se çfarë shkruhej në ato tri libra të “shenjtë”. Këta të fundit, adoleshentë të shkujdesur me ajfona në duar, gjyshin e tyre e kishin si të moskushit, yll bote, ç'e donin ata një gjysh “tjetër”, mbërthyer ashtu nëpër fletë të trasha, si të kishte veshur një kostum që i rrinte keq!...

“Ore, si na iku ashtu, ne s'e morëm vesh se kush që, vetëm një emër në tri kopertina pamë, asgjë më shumë!”

“Ishte ai, pra, politikani, që e dekoruan për me e nxjerrë në pension politik!...”

“O, jo, deputeti i përjashtuar! Ju kujtohet ai klouni me frak?”

“S'e luan topi, është shkrimtar i vetëshpallur dhe pikë, shkruan gjithë ditën bejte...”

“Nëse është fjala për historian, dakord, me të dyja duart!”

“Që është filozof, nuk ka medyshje, nuk e patë sa i menduar ishte gjatë gjithë kohës!”

“Thoni ç'të doni, ama nuk përjashtohet mundësia të jetë oligark!...”

“E sigurtë është një gjë, që ai ishte VIP”, deshi t'i vinte kapak gruaja e shoqatës, me një frikë të brendshme se po binte në dashuri pas aq shumë kohësh!...

Doktori nuk foli, por u nis të merrte turnin e tretë, pa filluar ende shiu që po i setullonte retë andej-këndej, që nëse e zinte zotërinë pa shkuar në shtëpi, do t'ia bënte librat bersi në thes. I erdhi të qeshte: “Deri ku mund të shkonte ashtu ai njeri, në qiellin e tij të shtatë, apo në vetminë e pashmangshme?”

Kurse so-ditësi i ishte vënë nga mbrapa, jo për ta ndihmuar me thesin, por për ta parë nga afër, nëse i ishin rritur veshët një gisht? Bastin tashmë nuk e kishte vetëm me veten, por me të gjithë ata njerëz, që nuk do të lëviznin nga parku, për gjithë natën, pa ardhur përgjigja e tij.

Por nuk vonoi e rrebeshi sa nuk e përmbyti parkun, si një ëndërr të keqe.

KUDO

Kudo që të ndodhem, në çdo vend lart mbi tokë,
fsheh nga njerëzit bindjen se nuk jam prej këtej.
Është si të isha dërguar që të fiksoja sa më shumë ngjyra,
shije, tinguj, erëra, të provoj çdo gjë që është pjesë
përbërëse e njeriut, të zhvendos gjithçka që ndjeva
në një listë magjike dhe ta sjell atje nga ku u nisa.

TAKIM

Në agim udhëtova përmes arave të ngrira në një vagon.
Një pendë e kuqe u shkund brenda errësirës.

Dhe papritur një lepur kërcëu në udhë.
Njeri prej nesh me dorën e vet e tregoi.

Kaloi kohë që ahëre. Sot asnjëri prej tyre nuk jeton,
As lepuri, as njeriu që bëri shenjën.

E dashur, ku janë tani ata, ku kanë shkuar
Shkëlqimi i dorës, lëvizja e vetëtimtë,
kërcitja e zhavorrit.
Nuk pyes për keqardhje, por nga kureshtja.

FRIKË

“Baba, ku je? Pylli është i egër,
Këtu ka krijesa, shkurret lëvizin.
Orkidet shpërthejnë me zjarr helmues,
Në çdo hap përgjojnë gracka të fshehura.

“Ku je, Baba? Nata nuk ka të mbaruar.
Errësira do të sundojë përgjithnjë.
Udhëtarët janë të pastrehë, nga uria do të vdesin,
E hidhur buka jonë dhe e fortë si gur.

“Fryma e nxehtë e bishës së tmerrshme
Afrohet, gjithë afrohet, vjell erën e keqe të saj.
Ku ke shkuar, Baba? Pse nuk të vjen keq
Për bijtë e tu të humbur në këtë pyll të zi?”

TI QË KE BËRË PADREJTËSI

Ti që dëmtove të thjeshtin njeri
Duke shpërthyer në të qeshur frenetike për këtë padrejtësi
Dhe mbajte rreth vetes një turmë budallenjsh,
Për të ngatërruar të mirën me të keqen, për të përbaltur
ujërat,

Edhe pse të gjithë përuleshin para teje,
Duke thënë se mençuria dhe virtyti ndriçojnë rrugën tuaj,
Duke prerë medalje ari për nderin tuaj
Të lumtur se jetuan edhe një ditë,

Mos u ndjeni të sigurt. Poeti kujton.
Dhe nëse vret një, një tjetër lind.
Fjalët janë të shkruara, veprat, datat.

Dhe mirë do të bëje një agim dimëror të shkosh
Me një litar dhe një degë që do të përkulet nën peshën
tënde.

PARATHËNIE

Së pari, fjalë të thjeshta në gjuhën amtare.
Duke dëgjuar ato, duhet të jesh në gjendje të shohësh
Mollët, një lumë, kthesën e një rruge
Si një shkëlqim vetëtime në verë (verore).

Dhe duhet të përmbajë më shumë se imazhe.
Është joshur nga kënga,
Një ëndërr, një melodi. E pambrojtur,
E anashkalon një turmë e fortë dhe e thatë.

Shpesh pyesni veten pse turpëroheni
Kur hap një libër me poezi.
Thua se poeti, për arsye të paqarta për ti,
Iu adresua anës më të keqe të natyrës sate,
Duke mënjanuar mendimin, duke e mashtruar atë.

E shartuar me shaka, satirë e ironi,
Poezia ende di si të të kënaqë.
Atëherë përsosmëria e saj admirohet shumë.
Por betejat e mëdha ku jeta është në rrezik
Jepen përmes prozës. Nuk ishte gjithmonë ashtu.

ÇESLAV MILOSH Vetëm kjo

Përktheu: Odhise Çerkezi

U lind më 1911 në Lituani, u rrit dhe u arsimua për
drejtësi në Poloni, studimet pasuniversitare i kreu në
Paris. Mori pjesë në rezistencën polake kundër nazizmit.
Pas lufte nga viti 1946 – 1951 punoi si atashe kulturor në
ambasadën polake në Paris, pas vitit 1951 i zhgënjyer
nga sistemi i vendit të tij kaloi në Perëndim, ku jetoi në
Europë e Amerikë.

Nobelist i vitit 1980 me motivacionin: “...me
mendjemprehtësi të pakompromis në pah gjendjen
e ekspozuar të njeriut në një botë konfliktesh të rënda”.

Ai pohon: “Poezia ime ka mbetur e shëndoshë dhe, në
një epokë të errët, ka shprehur një mall për Mbretërinë e
Pages dhe të Drejtësisë”.

Shkroi në gjuhën e vendit të tij, polonisht, por një
pjesë e madhe e krijimtarisë është shkruar anglisht.
Poezitë e mëposhtme janë përkthyer nga anglishtja nga
përmbledhjet poetike “The Collected Poems”, “Provinces
Poems” dhe “Carcenet”.

Konsiderohet si një ndër katër poetët më të mëdhenj
të gjysmës së dytë të shekullit XX. Vdiq në 14 gusht 2004.



Dhe keqardhja jonë ka mbetur e parrëfyer.
Proza dhe esetë shërbejnë, por nuk zgjatin.
Një strofë e qartë mund të ketë më shumë peshë
Se një vagon i tërë me proza të përpunuara.

RËNIA

Vdekja e një njeriu është si rënia e një kombi të madh
që kishte ushtri të fuqishme, udhëheqës dhe profetë,
dhe limane të pasura dhe anije në të gjitha detet,
por tani nuk mund të çlirojë asnjë qytet të rrethuar,
nuk i përket asnjë aleance,
sepse bosh janë qytetet e tij, popullsia e tij është e shpërn-
darë,
toka që dikur jepte frytë është plot me gjemba
misioni i tij i harruar, gjuha e tij humbi,
dialekti i një vendi lart mbi male të paarritshme.

NGASJE

Nën qiellin me yje kam ecur,
Në një kreshtë mbi qytetin nga neoni ndriçuar,
Me shokun tim, shpirtin e vetmisë
Që më rrethonte e pëshqjellonte,
Duke thënë se nuk isha i nevojshëm, sepse nëse jo unë,
atëherë dikush tjetër
Do të ecte këtu, duke u përpjekur të kuptojë epokën e tij.
E nëse do të kisha vdekur shumë kohë më parë, asgjë
nuk do të kishte ndryshuar.

Të njëjtat yje, qytetet, vendet
Do të shiheshin nga sy të tjerë.
Si tani do të vazhdonin bota dhe vuajtjet e saj.

Në emër të Zotit, largohu prej meje.
Mjaft më ke torturuar, i thashë.
Nuk jam unë ai që do të gjykoj thirrjen e secilit.
Dhe vlerën time, nëse ka, nuk do ta di gjithsesi.

SEKRETARË

Unë nuk jam gjë tjetër veçse një sekretar
i gjërave të padukshme
Që më diktohen mua dhe disa të tjerëve.
Sekretarë, të panjohur midis nesh, endemi në tokë
Pa shumë njohuri. Duke nisur një frazë në mes
Ose duke përfunduar me presje. Dhe si do të duket
kur të përfundojë,
nuk jemi ne që do ta gjykojmë, gjithsesi nuk do ta lexojmë.

VETËM KJO

Një luginë dhe më lart pyjet me ngjyrat e vjeshtës.
Një udhëtar mbërrin, harta e solli këtu.
Ose ndoshta kujtesa. Dikur, vite më parë, në diell,
Kur ra bora e parë dhe udhëtonte këtu
Ai u ndje i lumtur, i fortë, pa arsye,
Gëzimi i syve. Gjithçka ishte në ritëm
Nga shushurima e pemëve, fluturimi i një zogui,
Treni në urë, magjia e lëvizjes.
Kthehet pas vitesh, asgjë nuk kërkon.
Ai dëshiron vetëm një gjë, gjënë më të çmuar:
Për të parë, qartë e thjeshtë, pa emër,
Pa pritshmëri, shpresa apo frikëra,
Në skajin ku nuk ka unë ose jo-unë.

DUHET, NUK DUHET

Një burrë nuk duhet ta dojë hënën.
Sëpata nuk duhet të humbasë peshën në dorën e tij.
Kopshti i tij duhet të mbajë erë mollësh të kalbura
Dhe i mbushur të jetë me gjemba të egra.
Një burrë kur flet nuk duhet të përdorë fjalë që janë
të çmuara për të,
As të hapë farën për të zbuluar se çfarë fshihet brenda saj.
(Kështu të paktën u mësova unë në Lituani.)
Kur ecën në shkallët e mermerta,
Mundet, ai i pagdhenduri, t'i godasë me çizmen e tij
Si kujtim se do të zgjasin përgjithmonë.

LIGJËRIMI IM BESNIK AMTAR

Ligjërim besnik amtar,
Unë ti të kam shërbyer.
Çdo natë vendosja para teje në
të vogla me ngjyra
për të pasur mëshqetë, bulkthin dhe harabelin
siç më kanë mbetur në kujtesë.

Kjo zgjati shumë vite.
Ti ishe atdheu im, nuk kisha tjetër.
Dhe ende mendoja se ti do të sillje mesazhet
mes meje dhe disa njerëzve të mirë
edhe sikur të ishin pak, njëzet, dhjetë,
ose ende të palindur.

Tani e pranoj dyshimin tim.
Ka momente kur ndihem sikur kam shkatërruar
jetën time.
Sepse je një gjuhë e të përlururve
e të pamenduave, të cilët janë të urryer ndërmjet tyre
edhe më shumë se sa i urrejnë kombet e tjera,
një gjuhë informatorësh,
një gjuhë e të hutuarve,
të cilët vuajnë nga naiviteti i tyre.

Por pa ty kush jam unë?
Një studiues në një tokë të largët,
një sukses, pa frikë dhe poshtërim.
Po, kush jam unë pa ty?
Thjesht një filozof, si çdo tjetër.
E kuptoj, ky ishte mësimi im:
humbi lavdia e individualitetit,

Fati shtron një tapet të kuq
para mëkatarit në një dramë morale

ndërsa një fener magjik tregon pas perdes
idhujt e martirizimit njerëzor dhe hyjnor.

Ligjërimit besnik amtar,
ndoshta në fund jam unë ai që duhet
të përpiqem të të shpëtoj.
Kështu që do të vazhdoj të vendos para teje kupa
të vegla me ngjyra
sa më t'ndritshme dhe të qarta që të jetë e mundur,
sepse ajo që nevojitet në fatkeqësi është pak
rregull dhe bukuri.

KAQ PAK

Kam folur kaq pak.
Ditët ishin të shkurtra.

Ditë të shkurtra.
Net të shkurtra.
Vite të pakta.

Kam folur kaq pak.
Nuk mund të vazhdoja.

Zemra ime u lodh
Nga gëzimi,
Dëshpërimi,
Pasioni,
Shpresa.

Nofullat e Leviathanit
U mbyllën mbi mua.

I zhveshur, shtrihem në brigjet
E ishujve të shkretë.

Balena e bardhë e botës
Më tërhoqi poshtë në gropën e saj.

Dhe tani nuk e di
Çfarë nga të gjitha këto ishte e vërtetë.

NJË DETYRË

Me frikë dhe tmerr mendoj se do të plotësoja
detyrën time
Vetëm nëse do ta detyroja veten të bëj një rrëfim
publik
Duke zbuluar një mashtrim, timin dhe të epokës sime:
Na lejuan të bërtisnim në gjuhën e xhuxhëve
dhe të demonëve,
Por fjalët e pastra dhe të guximshme ishin të ndaluar
Me një dënim aq të rëndë sa kushdo që guxonte
t'i shqiptonte
E konsideronte veten si një njeri të humbur.

PAJTIMI


Me vonesë, koha e pajtimit përulës
Me veten, mbërriti për të.
"Po" – tha – "U krijova
Të jem poet dhe asgjë më shumë.
Nuk di të bëj diçka tjetër,
Më vjen shumë turp, por nuk mund ta ndryshoj
fatin im".

Poeti: Ai që vazhdimisht mendon për diçka tjetër.
Përditshmëria e tij i shtyn njerëzit që e rrethojnë
në dëshpërim.
Ndoshta ai nuk ka fare ndjenja njerëzore.

Por, në fund të fundit, pse të mos jetë edhe kështu?
Në varietetin njerëzor një mutacion, një varietet
Është gjithashtu i nevojshëm. Le të vizitojmë poetin
Në shtëpinë e tij të vogël në një periferi disi të venitur
Aty ku ushqen lepurt, bën vodka bimore,
Dhe shkruan në kasetë ato vargjet e tij hermetike.

ËNGJËJT

Gjithçka ju është marrë: rrobat e bardha,
krahët, madje edhe ekzistenca juaj.
Por unë ju besoj
lajmëtarë ëngjëllorë.



Atje, ku bota kthehet përmbys,
një pëlhurë e rëndë e qëndisur me bisha dhe yje,
ju vini rrotull dhe kontrolloni qepjet e forta.

Është i shkurtër qëndrimi juaj këtu:
rrallë here një orë në mëngjes, nëse qielli është i pastër,
në një melodi të përsëritur të një zogu,
ose në erën e mollëve në fund të ditës
kur drita i bën kopshtet magjike.

Thonë se dikush ju ka shpikur,
por mua kjo nuk tingëllon bindëse
sepse njerëzit kanë krijuar edhe veten e tyre.

Zëri - pa dyshim është një provë e fuqishme,
Sepse u përket vetëm krijesave që rrezatojnë,
pa peshë dhe me krahë (në fund të fundit, pse jo?),
i rrethuar nga vetëtimia.

E kam dëgjuar shumë herë atë zë në gjumë
dhe çuditërisht që kuptova pak a shumë ishte
një urdhër ose një thirrje në gjuhën e botës tjetër:
dita tërheq pas vetes
një tjetër ditë
bëj çfarë të mundesh.

LUTJE

Ti më pyet se si t'i lutesh dikujt që nuk ekziston.
Gjithçka që unë di është se lutja ndërton një
urë të kadifejtë

Dhe duke ecur lart mbi të, si në një trampolinë
Mbi peizazhet me ngjyrën e arit të pjekur
Transformuar nga një ndalesë magjike e diellit.
Ajo urë të çon në bregun e Reversal
Aty ku gjithçka është pikërisht e kundërta dhe
fjala është

Shfaq një kuptim që vështirë se e imagjinonim.
Shiko: Unë them *me*, atje, secili veç e veç,
Ndjen dhembshuri për të tjerët të rënë në kurthin
e mishit
Dhe e di se nëse nuk ka breg tjetër
Njësoj do të ecim në atë urë ajrore,
megjithatë.

RRËFIM

Zot, pëlqejë reçelin me luleshtrydhe
Dhe ëmbëlsia e errët e trupit të gruas.
Gjithashtu vodka e ftohur mirë, harenga në vaj ulliri.
Aromat, e kanellës, të karafilit.
Pra, ç'loj profeti jam unë? Pse duhet shpirti
Të vizitojë një njeri të tillë? Shumë të tjerë
Shumë të tjerë ishin thirrësit dhe të besuarit.
Kush do të më besojë mua? Meqë panë
Si zbrazja gotat dhe hidheshja në ushqim,
Si po vështroja me lakmi gjoksin e kamarieres.
E kasha gabim dhe e dija. Dëshiroja madhështinë,
Në gjendje ta njoh atë kudo që të ekzistonte,
E megjithatë jo plotësisht, vetëm pjesërisht isha i qartë,
E dija se çfarë kishte mbetur për njerëz të vegjël si unë:
Një festë shpresash të rreme, një tubim krenarësh,
Një garë raketikësh, letërsia.

1945

Ti! Poeti i fundit polak! - i dehur, më përqafoi,
Shoku im nga vitet e Avangardës, me një pallto
të gjatë ushtarake,
Kishte mbijetuar nga lufta në Rusi dhe atje,
kuptoi.

Ai nuk mund t'i kishte mësuar ato gjëra
nga Apolineri,
Ose në manifestet kubiste, apo në festivalet
e rrugëve të Parisit.
Ilaçi më i mirë për iluzionet është uria, durimi
dhe bindja.

Në kryeqytetet e tyre të bukura, ata ende pëlqenin të flisnin.
Megjithatë, shekulli i njëzetë përparonte. Nuk ishin ata
që do të vendosnin se çfarë kuptimi do të kishin fjalët.

Në stepë, teksa po lidhte këmbët e gjakosura
me një leckë
Ai e kapi krenarinë e kotë të atyre brezave të lartë.
Sa larg mundi të shihte, një tokë të sheshtë,
të papunuar.

Heshtja e zezë u ul mbi çdo fis dhe popull.
Pas kabanave në trmpujt e mëdhenj, pas
masakrave,
Pas mosmarrëveshjeve për vullnetin e lirë dhe argumenteve
për masat shtrënguese.

Shikoja i habitur, qesharak dhe rebel,
Vetëm me Virgjëreshën time Mari kundër
fuqisë së pakundërshtueshme,
Një pasardhës i lutjeve të zjarra, i skulpturave të praruara
dhe mrekullive.

Dhe e dija se do të flisja në gjuhën e
të mundurve
Që është e vjetër sa zakonet e vjetra,
festat familjare,
Zbukurimet e Krishtlindjeve dhe këngët e gëzuara
çdo vit.

NJË LIVADH

Ishte një livadh buzë lumit, i lulëzuar, përpara
korrjes së grurit,
Një ditë të papërlyer në diellin e qershorit.
E kërkova, e gjeta, e njoha.
Bar dhe lule rriteshin aty të njohura për mua
që në fëmijëri.
Me qepallat gjysmë të mbyllura thitha lumineshencën.
Dhe aromat më vërshuan, të gjitha sa dija
humbën.
Papritur ndjeva se po zhdukeshja dhe po qaja
me gëzim.
Papritur u ndjeva sikur po zhdukej dhe po qaja
nga gëzimi.

I.
[BRAY: DHOMA E BUKUR NË MARTELLO TERRACE]

Z. Vance (vjen me një shkop): ... Por e shihni, ai duhet të kërkojë falje, zonja Joyce.

Zonja Joyce: Po, sigurisht... E dëgjuat këtë, Jim?

Z. Vance: Përndryshe - nëse ai nuk e bën këtë - ky shkop do ta bëjë të derdh lot.

Zonja Joyce: Oh, por jam e sigurt që ai do të kërkojë falje.

Joyce (nën tavolinë, me vete):

Të shkrehesh në vaj,
të thuash më fal
të thuash më fal,
të shkrehesh në vaj.

Të thuash më fal,
të shkrehesh në vaj,
të shkrehesh në vaj,
të thuash më fal.

2.

NESËR S'KA MËSIM: është natë, e shtunë dhe dimër: jam ulur pranë oxhakut. Së shpejti ata do kthehen në shtëpi me pazaret e fundjavës - mish dhe perime, çaj, bukë dhe gjalpë, salsicë të fërguara në tigan... Jam ulur dhe lexoj një histori nga Alsace, shfletoj faqet e zverdhura, shoh burrat dhe gratë në kostumet e tyre të çuditshme. Më pëlqen të lexoj për zakonet e tyre; kështu më duket sikur prek jetën e një vendi tjetër dhe vij në kontakt me popullin gjerman. E dashur imagjinatë, e besuara e rinisë sime!... Në të unë kam parë veten time. Jetët tona janë akoma të bekuara në afinitetin e tyre të ngushtë. Unë jam me të natën kur ai lexon veprat e filozofëve ose ndonjë histori të kohëve të shkuara. Jam me të kur ai ecën vetëm ose me dikë që nuk e ka parë kurrë, vajzën e re që i vë dorën në qafë, e cila nuk ka qëllime të liga, që i ofron dashurinë e saj të thjeshtë e të bollshme, që dëgjon dhe i përgjigjet shpirtit të tij pa e kuptuar si.

3.

FËMIJËT QË KANË QËNDRUAR MË SË GJATI veshin rrobat e tyre të jashtme, sepse festa ka mbaruar. Ky është tramvaji i fundit. Kuajt e dobët ngjyrë kafe e dinë këtë dhe tundin këmbanat e tyre si një paralajmërim për mbrëmjen e ndritshme. Konduktori flet me shoferin; të dytë shpesh tundin kokat nën dritën jeshile të llambës. S'ka njeri aty afër. Na duket se po dëgjojmë, unë në shkallën e sipërme dhe ajo në atë të poshtme. Ajo vjen shpesh në shkallën time dhe pastaj zbrat për sërë midis frazave, por disa herë harron të zbrat dhe qëndron në anën time, dhe pastaj zbrat... Prit, prit ... Dhe tani nuk vërehet sqima dhe krekosja - mbi fustanin e saj të bukur, brezin dhe çorapet e gjata të zeza - se tani (mençuria e fëmijës) duket se ne e dimë se ky fund do të na tërheqë më shumë se çdo fund që e kemi kërkuar.

4.

[DUBLIN: NË MOUNTJOY SQUARE]
Joyce (konstaton): ... Bëjnë dyzet mijë paund.

Tetoja Lilli (qesh): O Zot!... Unë isha njësoj... Kur isha e vogël edhe unë isha e sigurt se do të marthohesha me një kont... apo diç të tillë...

Joyce (duke menduar): A është e mundur që ajo krahason veten me mua?

5. LARTË NË SHTËPINË E VJETËR me dritare të errëta: drita e zjarrit në dhomën e ngushtë: jashtë ka rënë muzgu. Një grua e moshuar nxiton të bëjë çaj; ajo tregon për gjithçka që ka ndryshuar, për zakonet e saj të çuditshme dhe atë që tha prifti dhe doktori... I dëgjoj fjalët e saj nga larg. Eci mes prushit të ndezur, përgjatë shtigjeve të aventurës... Zoti im! Ç'është ajo në derë?... Një kafkë - një

JAMES JOYCE

Epifani

Përktheu: Qerim Raqi

Epifani i quajti James Joyce një sërë tekstesh të shkurtëra në prozë që i shkroi kur ishte i ri, gjithsej 40, të cilat i ruante në fletoren e tij.

Ato përmbajnë imazhe lirike, skena të shkurtra dramatike dhe përshkrime ëndrrash. Përmbajtja e tyre është autobiografike, shpesh jsnë vrojtime të mprehta të autorit mbi jetën shoqërore në Dublin. Nën sipërfaqen e përditshmërisë, shfaqet një kontekst më i gjerë i jetës, në shkëmbime të shpejta. Epifanitë synonin të formonin një libër më vete; në vend të kësaj, Joyce përdori një numër prej tyre në veprat e tij të mëvonshme, kryesisht në veprën *Portreti një artistiti të ri*.

Këto janë imazhe të veçanta, detaje, situata të mëvetësishme ose gjeste të pavullnetshme që sugjerojnë në çast, një histori të tërë ose karakterin dhe botën e brendshme të një personi.

Shumica e studiuesve i kanë konsideruar epifanitë pikërisht si lëndë të parë, si fragmente që arrijnë vlerën e tyre të plotë, fuqinë e tyre zbuluese në një kontekst më të gjerë.

majmun; një qenie e tërhequr deri këtu te zjarri, tek zërat: një qenie e paarsyeshme.

- A është Mary Ellen?
- Jo Eliza, është Jim-i.
- Oh... Natën e mirë, Jim...
- Doje ndonjë gjë, Eliza?
- Mendova se ishte Mary Ellen...

Mendova se ti ishe Mary Ellen, Jim...

6.

NJË FUSHË E VOGËL me egjra dhe gjemba të thatë të mbushur me forma të paqarta, gjysmë-njerëz, gjysmë- cjepër. Bishtat e gjatë i tërheqin pas dhe ata lëvizin në mënyrë agresive aty- këtu. Kanë mjekra të vogla me majë, gri si goma. Një sekret mëkati personal i drejton hapat e tyre dhe i detyron si pamëshirshëm në ligësi të vazhdueshme. Njëri ka mbështjellë një këmishë fanelle të grisur rreth trupit, tjetri ankohet në mënyrë monotone kur mjekra i ngec në fijet e forta të barit. Ata lëvizin rreth meje, më rrethojnë, mëkati i vjetër mpreh shikimin e tyre drejt mizorisë, ata nxitonjë nëpër fushë në rrathë të ngadalte, duke shtrirë fytyrat e tyre të tmerrshme lart. Ndhimë!

7.

ËSHTË KOHA TË SHKOJMË TANI - mëngjesi po na pret. Unë vetëm do të bëj edhe një lutje.... jam e uritur; megjithatë do të doja të qëndroja këtu në këtë kishëz të heshtur, ku mesha është zhvilluar kaq qetë... Përsëndetjet, ti Mbretëresha e Qiellit, Nënë e Mëshirës, ti jeta jonë, lumturia jonë dhe shpresa jonë! Nesër dhe çdo ditë pastaj, shpresoj t'ju sjell një veprim të virtutshëm

si sakrificë, sepse e di se do të jeni e kënaqur me mua nëse e bëj. Dhe tani lamtumirë për këtë herë... Oh, shkëlqimi i bukur i diellit tani në bulevard dhe oh, dielli në zemrën time

8

RETË E HIRTA MBUSHIN QIELIN. Aty ku takohen tre rrugë, përballë një plazhi moçalor, një qen i madh qëndron shtrirë kruspull. Herë pas here ai ngrë turirin dhe lëshon një ulërimë të gjatë dhe të trishtuar. Njerëzit ndalojnë për ta shikuar dhe vazhdojnë; disa qëndrojnë aty, ndoshta të pranguar nga ajo ulërimë në të cilën ata mendojnë se dëgjojnë pikëllimin e tyre që dikur kishte një zë, por tani është memec, një lakej i ditëve të mundimshme. Fillon të bie shi.

9.

[REFLEKTIME: NJË E DIEL NË KORRIK: MESI I DITËS]

Tobin-i (duke ecur me çizme të mëdha që kërcasin në zhavorrin e rrugës, duke goditur me bastun): ... Oh, nuk ka asgjë si martesë kur vjen puna për të vendosur një burrë. Para se të filloja të punoja në The Examiner, pija dhe rrija me miqtë e mi...

Tani kam një shtëpi të madhe dhe...shkoj në shtëpi në mbrëmje dhe nëse dua të pi një pije... mirë, e bëj... Këshilla ime për çdo burrë të ri, nëse i ka mundësitë, është: martohu i ri.

10.
[DUBLIN: NË "THE STAG'S, DAME LANE"]

O'Mahony: A është ai prifti i vogël atje që shkruan poezi - At Russell? Joyce: Epo, sigurisht... Kam dëgjuar që ai ka shkruar vargje.

O'Mahoney (buzëqesh me dinakëri): Vargje, po... kjo është fjala e duhur për këtë...

11.

[DUBLINI: NË FAMILJEN SHEEHY, BELVEDERE PLACE]

Joyce: E kuptova që e kishe fjalën për të. Por e keni gabuar moshën e tij. Maggie Sheehy (përkulet përpara dhe thotë seriozisht): Sa vjeç është atëherë?

Joyce: Shtatëdhjetë e dy.

Maggie Sheehy: A është ai?

12.

[DUBLIN: NË FAMILJEN SHEEHY, BELVEDERE PLACE]

O'Reilly (me një ton serioz)... Tani është radha ime, mendoj... (shumë seriozisht)... Kush është poeti juaj i preferuar?

(Puzë)

Hanna Sheehy: ... Gjermane?

O'Reilly: ... Po.

(heshtje)

Hanna Sheehy: ... Mendoj se është... Goethe...

13.

[DUBLIN: NË FAMILJEN SHEEHY, BELVEDERE PLACE]

Fallon-i (ndërsa kalon): Më kërkuar të të përgëzoi veçanërisht për performancën. Joyce: Faleminderit shumë.

Blake (pas një pauze): Unë kurrë nuk do ta këshilloja askënd që të... Oh, kjo është një jetë e tmerrshme!... Joyce: Ka.

Blake (duke fryrë në tub): Sigurisht... duket e mira nga jashtë... për atë që nuk di asgjë... Por sikur ta dije... është vërter e tmerrshme. Një copë drite, jo... darkë, e mjerë... varfëri. Ti thjesht nuk e kupton...

14.

[DUBLIN: NË FAMILJEN SHEEHY, BELVEDERE PLACE]

Dick Sheehy: Çfarë do të ishte një gënjeshtëri? Zoti Kryetar, më duhet të pyes... Z. Sheehy: Urdhëroni!

Fallon-i: Ti e di që është gënjeshtëri! Z. Sheehy: Zotriu im, ju duhet të tërhiqni deklaratën tuaj.

Dick Sheehy: Siç thashë...

Fallon-i: Nuk do ta bëj.

Z. Sheehy: Unë do t'ia lë fjalën deputetit të nderuar për Denbigh... Për rregullim!...



15.
[NË PËRSIATJE: NJË MBRËMJE NË VJESHTE]

Lypësi i çalë (duke rrëmbyer bastunin): ...

Ju ishit ata që më thirrët më emër dje.

Dy fëmijët (duke e vështruar): Jo, zotëri.

Lypësi i çalë: Po ashtu ishte... (ngre dhe ul shkopin) tani... E shikoni këtë shkop?

Dy fëmijët: Po, zotëri.

Lypësi i çalë: Nëse bërtisni pas meje edhe një herë, do të të hap barkun me atë shkop. Do t' ju pres mëlçinë... (sqaron). Dëgjuat? Do t' ju hap barkun. Do t' ju pres mëlçinë dhe jetën.

16.
NJË MJEGULL E BARDHË BIE në shtëllunga të ngadalta. Rruga më çon poshtë në një pellg të errët. Diçka lëviz në ujë: është një bishë arktike me gëzof të verdhë të trashë. Unë e prek me shkop dhe ai ngrihet nga uji shoh që shpinën e ka të gjatë dhe se lëviz shumë plogësht. Unë nuk kam frikë, por e josh të afrohet me goditje të mira me bastun. Ai i ngre kthetrat rëndë dhe mërmëritë fjalë në një gjuhë që nuk e kuptoj.

17.
[DUBLIN: NË FAMILJEN SHEEHY, BELVEDERE PLACE]

Hanna Sheehy: Oh, me siguri do të ketë shumë njerëz atje.

Skeffington: Në të vërtetë, siç do të thoshte miku ynë Joxax, do të jetë një ditë turmash.

Maggie Sheehy (deklamon): Ndoshta turma është tashmë në portë!

18.
NË [DUBLIN: në NORTH CIRCULAR ROAD: KRISHTLINDJE]

Zonja O'Callaghan (murmurit): Unë thashë si quhej - "Murgësia e arratisur".

Dick Sheehy (me zë të lartë): Oh, nuk do të lexoja kurrë një libër i tillë... Do të duhet ta pyesim Joyce. A dëgjon, Joyce, e keni lexuar "Murgëshën e arratisur"?

Joyce: Vëj re se një fenomen i caktuar ndodh në këtë kohë.

Dick Sheehy: Çfarë fenomeni?

Joyce: Oh... ndizen yjet.

Dick Sheehy (zonjushës O'Callaghan): ... A e keni vënë re ndonjëherë se... yjet ndizen në hundën e Joyce në këtë kohë? ... (ajo buzëqesh) Sepse ky është një fenomen që e vërej.

19.
[DUBLIN: NË SHTËPINË GLENGARIFF PARADE: MBRËMJE]

Zonja Joyce (fytyrësququr, duke u dridhur, shfaqet në hyrje në dhomën e bukur): ... Jim!

Joyce (në piano): Po?

Zonja Joyce: A dini ndonjë gjë për trupin?...

Çfarë të bëj? ... Diç po rrjedh nga vrima në barkun e Georgies ...A ke dëgjuar se mund të ndodhë një gjë e tillë?

Joyce (i habitur): Nuk e di...

Zonja Joyce: A të dërgoj për doktorin, si thua?

Joyce: Nuk e di... Çfarë vrime?

Zonja Joyce (me padurim): ... Vrima që kemi të gjithë ... këtu ... (tregon me gisht) AJoyce (ngrihet në këmbë)

20.
TË GJITHË FLENË. Unë të ngrihem tani... Ai është shtrirë në shtratin tim ku kam qenë shtrirë mbrëmë: i kanë shtrirë një çarçaf dhe i kanë mbyllur qepallat me qindarka... I gjori vogëlush! Ne kemi qeshur shpesh bashkë - gjithçka e merrte të lehtë në këtë jetë... Më vjen shumë keq që vdiq. Nuk mund të lutem për të si të tjerët... I gjori vogëlush!

Gjithçka është e pasigurtë!



ALFRED ÇAPALIKU

Qiej mermeri

Cikël poetik

Gazeta "ExLibris" i uron ditëlindjen e 72 shkrimtarit dhe profesorit Alfred Çapaliku, autor i disa vëllimeve poetike dhe tekste këngësh, mes të cilave edhe "Xhamadani vija vija" si dhe profesor në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi". Cikli në vijim, shkruar kohët e fundit, botohet për herë të parë.

1. QIEJ MERMERI

Qiej mermeri
pa peshë,
Dallëndyshe kundër rrymës
pa mbërritje.

Pleq ripërtpës kujtimelesh
pa tym,
Aerobi pemësh bri rrugëve
pa erë.

E bardha bëhet e kaltër,
E zeza mbetet pa bojë,
Zaret janë hedhur,
Jeta është lojë.

Pikat e shiut, lotë virgjëreshe,
Prishen në shtratin e lumit,
Avullojnë të mistershme,
Si britma pa dënësë.

E bardha ngjyhet me të kuqe,
E zeza ndërron bojë,
Në kurthin e ditës,
Jeta është lojë.

2. FILLIKAT

Si derë e mbyllur me mur,
S'më vjen trokitja qyshkur.

Si muzg violet mbi dritare,
Më thyhet zemra gastare.

Si pemë skelete pa gjeth,
Më sillet era për rreth.

Si pyll i rrafshuar me zjarr,
S'më mbin fidani në zhar.

Si tokë ku s'del një kalli,
Pa lulëkuqe stoli.

Si qiell i mbetur pa blu,
Pa bisht komete bizhu.

Si hon i gremisur pa urë,
Pa një ylber si dikur.

Si derë, si muzg përmbi pyll,
Si tokë, qiell pa yll.

Si hon i shkretuar pa fat,
Ashtu krejt bosh fillikat.

3. MAJË GISHTASH

Majë gishtash djali me ritmin e të zgjaturit,
Ashtu vajza nën puthjen e të dashurit.

Majë gishtash burri kthyer vonë pas gotës,
Ashtu gruaja tek gjumi i foshnjës.

Majë gishtash mjeku mbi shtrat të pacientit,
Ashtu vartësi tek zyra e shefit.

Majë gishtash vjelësi i mollës nga toka,
Ashtu ne tek distanca nga Evropa.

4. PIKA EKUILIBËR

Lëkundet koha e humbur,
Tek rendja në pista stresi,
Me rrotat vrik të parasë,
Ku në retinën e syrit,
Përmbysset prizmi i botës.

Sa bie nata e thellë,
Fanitet rrezja e yllit
Dhe nis zbulimi i vetes,
Te pika ekuilibër,
Për t'u ribërë Njeri.

5. IMAZH

Kalimtar tokës,
Pasagjer qiellit,
Krehër mes flokësh
Rrezet e diellit.

Gjestet dhe fjalët
Për dashuri,
Gdhendin në ajër
Art harmoni.

Si kalimtar
A pasagjer,
Jam një imazh
Dridhës në erë.

6. MUZG NË SHËN NAUM

Një kishë nën qiell,
asgjë s'ka më shumë,
Një varkë liqenit
dhe shenjti Naum,
Një degë blerimi
e kaltër mbi lumë,
Një diell në ikje
përhënur gjithkund.

Ca tinguj këmbanash
po luten mbi ujëra,
Mes qindra qirinjsh
me flakë të pashuara,
A janë murgësia
nën kryq të përkulura,
A nimfa legjendash
të lashta, të zhdokura?

Një hap s'bëj më tej,
kudo ka magji,
Nga këmbët tek flokët
bulon dashuri,
Se shelgjet me rrënjë
në Drinin e Zi,
E ndezin flakë muzgun
si një mrekulli.

7. MUZIKË NË LËVIZJE

Çiftet përfaquar në shkallaret e shesheve,
Si akrepat e orës në çast të tingëllimit,
Nëse një ditë ndahen, nëse një natë
s'shihen?

Bëhen fotografë të verbër në qytet,
S'mbështeten asnjëherë mbi shkopin e urrejtjes,
Armiq të mirë mbesin.

Muzikë në lëvizje është puthja pa u fshehur.

8. SHKALLËT

Ngjitëse, zbritëse njëherësh,
Shkallë granili, mermeri,
Palosëse, rrotulluese,
Lëvizëse, fikse, druri,
Metali, mëndafshi, litari -
Aventureske mes erës.
Rrëshqitëse akull janë
Veç shkallët e karrierës.

Sigurisht që titullin për këtë diskutim e Shuazova nga George Orwell-i. Një arsye pse e huazova ishte se më pëlqen tingulli i fjalëve: Pse shkruaj. Këtu keni tre fjalë të shkurtra, krejt të qarta që ndajnë një tingull, dhe tingulli që ata kanë të përbashkët është ky: Unë, Unë, Unë.¹

Në shumë mënyra, të shkruarit është akti i të thënit "unë", i imponimit të vetvetes ndaj njerëzve të tjerë, i të thënit *dëgjomë, shiko siç shoh unë, ndrysho mendim*. Është një akt agresiv, madje edhe armiqësor. Mund ta maskosh agresivitetin e tij sa të duash me vello fjalish nënrenditëse, me cilësor dhe fjali të mënyrës lidhore, me elipse dhe aluzione, duke përdorur nënkuptime në vend të pohimeve, por nuk mund të shmangët fakti që hedhja e fjalëve në letër është taktika e një tirani të fshehtë, një pushtim, një imponim i ndjeshmërisë së shkrimtarit në hapësirën më private të lexuesit.

E huazova titullin jo vetëm sepse fjalët tingëllojnë si duhet, por sepse dukej se përmbledhnin, në një mënyrë jo të pakuptimtë, gjithçka që duhet t'u them. Ashtu si shumë shkrimtarë, unë kam vetëm këtë "temë", këtë "lëmë", aktin e të shkruarit. Nuk mund t'u sjell asnjë raport nga ndonjë front tjetër. Mund të kem interesa të tjera: jam "e interesuar", për shembull, për biologjinë detare, por nuk e lajkatoj veten aq sa të besoj se do të më dëgjonit të flas për të. Nuk jam dijetare. Nuk jam aspak intelektuale, që nuk do të thotë se kur dëgjoj fjalën "intelektual" zgjat dorën të kap armën, por vetëm për të thënë që nuk mendoj në mënyrë abstrakte. Gjatë viteve kur isha studente në Berkeley, u përpoqa, me një lloj energjie të pashpresë të adoleshencës së vonë, të blija një vizë të përkohshme për në botën e ideve, për të krijuar një mendje që mund të merrej me abstrakten.

Gjithçka që dija atëherë ishte ajo që nuk isha dhe m'u deshën disa vite për të zbuluar se çfarë isha. Me pak fjalë u përpoqa të mendoj. Dështova. Vëmendja ime u kthye në mënyrë të pashmangshme tek e veçanta, tek e prekshmeja, tek ajo që përgjithësisht merrej parasysh nga të gjithë ata që njihja atëherë dhe për këtë çështje e kam njohur që atëherë, me periferikën. Përpqesha të mendoja për dialektikën hegeliane dhe e gjeja veten duke u përqendruar në një dardhë të lulëzuar jashtë dritares dhe në mënyrën e veçantë se si petalet binin. Përpqesha të lexoja teori gjuhësore dhe pyesja veten nëse dritat ishin ndezur në Bevatron, atje lart në kodër. Kur them se pyesja veten nëse dritat ishin ndezur në Bevatron, ju mund të dyshoni menjëherë, nëse merreni me fushën e ideve se po e regjistron Bevatronin si një simbol politik, duke menduar shkurtimisht për kompleksin ushtarako-industrial dhe të tij, për rolin në komunitetin universitar, por do të gaboni. Pyesja vetëm nëse dritat ishin ndezur në Bevatron dhe si dukeshin ato. Një fakt fizik.

Pata probleme me diplomimin në Berkeley, jo për shkak të paaftësisë për t'u marrë me idetë - isha diplomuar në anglisht dhe mund të gjeja imazhet e shtëpisë dhe kopshtit në "Portreti i një zonje" të Henry James-it, si të tjerët, "imazhet" duke qenë sipas përkufizimit lloji specifik që më tërhoqi vëmendjen - por thjesht sepse kisha nënvlerësuar ndjekjen e një kursi për Miltonin. Për arsye që tani tingëllojnë si barok, më duhej një diplomë deri në fund të asaj vere, dhe departamenti i anglishtes më në fund ra dakord, nëse do të veja çdo të premte dhe të flisja për kozmologjinë e "Parajsa e humbur", për të më vërtetuar se jam e aftë në analizën e veprës së Miltonit. E bëra.

Për disa të premte rresht mora autobusin e Greyhound-it, të premtëve të tjera kapja trenin e linjës së Paqësorit Jugor në pjesën e fundit të segmentit të

JOAN DIDION

Pse shkruaj

Përktheu nga anglishtja Granit Zela



tij transkontinental për në San Françisko. Nuk mund t'ju them nëse Miltoni e vendosi diellin apo tokën në qendër të universit të tij të "Parajsa e humbur", çështja qendrore e të paktën një shekulli dhe një temë për të cilën atë verë shkrova dhjetë mijë fjalë, por ende më kujtohet, ngurtësia e saktë e gjalpit në vagonin -restorant të qytetit të San Francisko dhe mënyra se si xhamat e ljer të autobusit reflektorin rafineritë e naftës rreth ngushticës Carquinez, në një dritë të hirtë dhe të turbullt. Me pak fjalë, vëmendja ime ishte gjithmonë në periferi, në atë që mund të shihja, shijoja dhe prekja, te gjalpi dhe autobusi. Gjatë atyre viteve udhëtoja me atë që e dija se ishte një pasaportë shumë e pasigurt, letra të falsifikuar: e dija që nuk isha banore legjitime në asnjë botë idesh. E dija që s'mund të mendoja. Gjithçka që dija atëherë ishte ajo që nuk mund të bëja. Gjithçka që dija atëherë ishte ajo që nuk isha dhe m'u deshën disa vite për të zbuluar se çfarë isha. Isha shkrimtare.

Me këtë nuk nënkuptoj një shkrimtar "të mirë" apo një shkrimtar "të keq", por thjesht një shkrimtar, një person i cilit orët më të zjarrta kur është më i kredhur në mendime i harxhon duke renditur fjalët në letër. Nëse arritjet e mia profesionale do të ishin në rregull, nuk do të isha bërë kurrë shkrimtare. Nëse do të kisha qenë e bekuar me qasje të kufizuar në mendjen time, nuk do të kishte pasur arsye për të shkruar. Unë shkruaj vetëm e vetëm për të zbuluar se çfarë po mendoj, çfarë po këqyr, çfarë arrij të shoh dhe çfarë domethënie ka. Të zbuloj atë që dua dhe atë që cilës i frikësohem. Pse rafineritë e naftës rreth ngushticës Carquinez më dukeshin të këqija në verën e vitit 1956? Pse dritat e natës në Bevatron digjen në mendjen time për njëzet vjet me radhë? Çfarë po ndodh në këto fotografi në mendjen time?

Kur flas për fotografi në mendjen

fjalët dhe renditja e fjalëve të tregon, ose më tregon mua, çfarë po ndodh në fotografi. Vini re: të tregon. Nuk jeni ti që i tregon.

Më lejoni t'ju tregoj se çfarë dua të them me fotografi në mendje. Fillova një roman "Luaj me kartat e tua", ashtu siç kam filluar secilin prej romaneve të mi, pa asnjë nocion për "personazhin" ose "subjektin" apo edhe "ndodhinë". Kisha vetëm dy fotografi në mendje, për një qëllim teknik, i cili ishte të shkruaja një roman aq eliptik dhe të shpejtë sa të përfundonte para se ta vije re, një roman aq i shpejtë sa zor se do të ekzistonte në faqe. Për sa u përket fotografive: e para ishte ajo e një hapësire të bardhë. Hapësirë boshe. Ishte padyshim, fotografia që diktoi qëllimin narrativ të librit - një libër në të cilin çdo gjë që ndodhte do të ndodhte jashtë faqes, një libër "i bardhë" tek i cili lexuesit do t'i duhej të sillte ëndrrat e këqija - dhe megjithatë kjo fotografi nuk më tregonte asnjë "histori", nuk sugjeronte asnjë situatë. Fotografia e dytë e bënte. Kjo fotografi ishte e diçkaje ku kisha qenë dëshmitar. Një grua e re me flokë të gjata dhe një fustan të shkurtër të bardhë ecën nëpër kazino në Riviera në Las Vegas në orën një të mëngjesit. Ajo kalon e vetme kazonin dhe ngre receptorin e një telefoni shtëpie. E shikoj sepse e kam lexuar në gazeta dhe ia di emrin: është aktore e dorës së dytë që e shoh herë pas here nëpër Los Anxhelos, në vende si teatri dhe një herë në zyrën e një gjinekologu në klinikën Beverly Hills, por nuk jam takuar kurrë me të. Nuk di asgjë për të. Kush po e përfshin në filma? Pse është ajo këtu për të aktruar? Si ndodhi saktësisht? Ishte pikërisht ky çast në Las Vegas që bëri që rrëfimtari i romanit tim "Luaj me kartat e tua" të fillonte të më tregonte për veten, por kjo shfaqet në roman vetëm në mënyrë të tërthortë, në një kapitull që fillon kështu: "Maria bëri një listë të gjërave që nuk do t'i bënte kurrë. Kurrë nuk do të ecte vetëm nëpër lagjet *Sends* ose *Sizër* pas mesnate. Kurrë nuk do të merrte pjesë në një festë, të bënte veprime sadomazokiste pa dëshirën e saj, nuk do të merrte hua peliçe nga Abe Lipsey, fjala - fjalë. Kurrë nuk do të mbante një Yorkshire në Beverly Hills". Ky është fillimi dhe gjithashtu fundi i kapitullit, i cili mund të sugjerojë se çfarë dua të them me "hapësirë e bardhë".

Më kujtohet se kisha një sërë fotografish në mendjen time kur fillova romanin që sapo mbarova, "Libri i lutjes së përbashkët". Në fakt, një nga këto fotografi ishte e atij Bevatron-it që përmenda, megjithëse do ta kisha të vështirë t'ju tregoja një histori në të cilën bëhet fjalë për energjinë bërthamore. Një tjetër ishte një fotografi gazete e një avionit 707 të rrëmbyer që digjej në shkretëtirë në Lindjen e Mesme. Një tjetër ishte pamja e natës nga një dhomë në të cilën një herë kalovaa një javë me ethe, një dhomë hoteli në bregdetin kolumbian.

Bashkë me bashkëshortin ishim në bregdetin kolumbian duke përfaqësuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës në një festival filmi (më kujtohet se e përmenda shumë emrin Jack Valenti, sikur përsëritja e tij mund të më bënte mirë), dhe ishte një vend i keq për të të kapur ethet, jo vetëm sepse sëmundja ime fyente nikoqirët tanë, por sepse në këtë hotel çdo natë nuk punonte gjeneratori. Ikën drita. Ashensori ndaloi. Im shoq vajti në festën e mbrëmjes, justifikonte mospraninë time, ndërsa unë rrija vetëm në këtë dhomë hoteli, në errësirë. Mbjaj mend që rrija në dritare duke u përpjekur të lidhesha me telefon me Bogotán (telefoni dukej se funksiononte në të njëjtin parim si gjeneratori), shikoja erën e natës që frynte dhe pyesja veten se çfarë po bëja njëmbëdhjetë gradë jashtë ekuatorit me një temperaturë etesh. Pamja nga ajo dritare padyshim shfaqet në *Libër i lutjes së përbashkët*, ashtu si edhe avionit 707 që digjet, dhe megjithatë asnjë nga këto fotografi nuk më tregoi historinë që më duhej.

1 Në anglisht "Why I Write", shënim i përkthyesit.

Fotografia që shkëlqeu dhe bëri që këto imazhe të tjera të bashkoheshin, ishte ajo e aeroportit të Panamasë në orën 6 të mëngjesit. Kam qenë në atë aeroport vetëm një herë, ishte një aeroplan për në Bogota që ndaloi për një orë për t'u furnizuar me karburant, por mënyra se si dukej atë mëngjes mbeti e mbivendosur mbi gjithçka që pashë deri në ditën kur mbarova *Libër i lutjes së përbashkët*. E kam përjetuar atë aeroport për disa vite. Ende mund ta ndjej ajrin e nxehtë kur zbres nga avioni, mund të shoh nxehtësinë që po ngrihet tashmë nga asfalti në orën 6:00 të mëngjesit. Mund ta ndjej fundin e lagur dhe të rrudhosur në këmbët e mia. E ndjej se si ngjitet asfalti në sandale. Më kujtohet bishti i madh i një avioni amerikan që pluskonte pa lëvizur në fund të asfaltit. Më kujtohet zhurma e një automati në dhomën e pritjes. Mund t'ju them se mbaj mend një grua të veçantë në aeroport, një grua amerikane, një nortë amerikane e hollë rreth të dyzetave që mbante një smerald të madh katror në vend të unazës së martesës, por nuk kishte një grua të tillë atje.

E vura këtë grua në aeroport më vonë. E sajova, ashtu si më vonë krijova një shtet për të vendosur aeroportin dhe një familje për të drejtuar vendin. Kjo grua në aeroport as nuk po kap një avion dhe as nuk po takon njeri. Ajo po porositi çaj në kafenenë e aeroportit. Në fakt ajo nuk po "porositi" thjesht çaj, por ngul këmbë që uji të vlohët, përballë saj, për njëzet minuta. Pse është kjo grua në këtë aeroport? Pse nuk shkon askund, dhe ku ka qenë më parë? Ku e gjeti atë smerald të madh? Çfarë çrregullimi ose mosshoqërimi e bën të besojë se vullneti i saj për të parë ujin e vluar mund të fitojë? Kishte katër muaj që shkante nga një aeroport në tjetrin, mund ta shihje me sytë e ngulitur te vizat në pasaportën e vet. Të gjithë ata aeroporte ku ishte vulosur pasaporta e Sharlotë Dagllasit do të dukeshin njësoj. Ndonjëherë te tabela në kullë lexohej "BIENVENIDOS" dhe nganjëherë lexohej "BIENVENUE", disa vende ishin të lagështa dhe të nxehta dhe të tjera ishin të thata dhe të nxehta, por në secilin prej këtyre aeroporteve muret prej betoni ndryshken dhe njolla dhe kënetat prej uji jashtë pistës ishte e mbushur me trupat e avionëve dhe uji kishte nevojë të vlohët.

"E dija pse Sharlota shkoi në aeroport edhe nëse Viktori nuk e dinte. E dija punën e aeroporteve". Këto rreshta shfaqen afërsisht në gjysmë të librit, por i shkrova gjatë javës së dytë që punova për librin, shumë kohë përpara se të kisha ndonjë ide se ku kishte qenë Sharlotë Dagllas ose pse shkoi në aeroport. Derisa shkrova këto rreshta, nuk kisha në mendje asnjë personazh të quajtur Viktor: nevoja për të përmendur një emër dhe emrin Viktor, më erdhi në mendje kur shkruaja fjalinë. "E dija pse Sharlota shkoi në aeroport" dukej e paplotë. "E dija pse Sharlota shkoi në aeroport edhe nëse Viktori nuk e dinte" kishte pak më shumë fuqi rrëfimtare. Më e rëndësishmja nga të gjitha, derisa shkrova këto rreshta nuk e dija kush isha "unë", kush po e tregonte historinë. Kisha synuar deri në atë çast që "unë" të mos ishte më shumë se zëri i autorit, një rrëfimtar i gjithëdijshëm i shekullit të nëntëmbëdhjetë. Por ja ku ishte: "E dija pse Sharlota shkoi në aeroport edhe nëse Viktori nuk e dinte. Unë e dija punën e aeroporteve".

Ky "unë" nuk ishte zëri i asnjë autori në shtëpinë time. Ky "unë" ishte dikush që jo vetëm e dinte pse Sharlota shkoi në aeroport, por njihje edhe dikë që quhej Viktor. Kush ishte Viktori? Kush ishte ky rrëfimtar këtë histori? Më lejoni t'ju them një gjë për arsyen pse shkrimtarët shkruajnë: po ta kisha ditur përgjigjen e ndonjërit prej këtyre pyetjeve, nuk do të më ishte dashur kurrë të shkruaja një roman.



ESMERALDA SHPATA

Kuartet tregimesh

1. PLOTËS QË MË LËNË

Djaloshi më takoi në rrugë. Kujtova se do të më pyeste për diçka dhe ndalova.

Më kapi dorën dhe e afroi te sytë e gështenjtë. Për një çast u befasona nga lëvizjet e mirëlogaritura dhe iu dorëzova veprimeve të tij. U ngrit në majë të gishtave dhe më preku flokët, i futi duart mes ondeve të mia dhe më drejtoi me mollëza të ulesha. Unë ia kuptova qëllimin dhe u ula në gjunjë para tij. Kokat tona me këtë rast u barazuan dhe, sapo i kërkova shkëlqimin në sy, më hodhi duart në qafë dhe iu lëshua një përqaftim të përmallshëm. Nuk pyeti për mua, po merrte ç'i deshi shpirti në ato çaste. Në fillim shtanga, por më pas i ndjeva impulset e para për t'u shkëputur nga ata krahe të njomë. Dhe ai e ndjeu.

U shkëput për pak dhe, pa m'i ndarë sytë, më tha që t'ia ktheja mbrapsh të gjitha frymëmarrjet që ia mora. Deri këtu nuk kishte asgjë për t'u çuditur.

- Do të jem fëmija yt, po të më lindësh, më tha. - Po qe se nuk do të jesh ndonjëherë gati për të më bërë ti, do të të bëj unë.

Mendova se isha sëmurë nga trutë e kokës. Ndërkohë që ai po fliste, ia mbatha nga sytë këmbët. Aq shumë e humba kontrollin e hapave të mi, sa që alarmova të gjithë lagjen me zhurmën dhe poteren që po shkaktoja duke shkelur kuturu. Më mirë të mos i kisha veshur atë ditë sandalet që më kishte blerë im atë. Iu këputën rripat dhe më pengonin e rrëzonin, sa që m'u bënë gjunjët copë.

Deri këtu prapë mirë duket.

Kur pashë më herët, deri kur kisha fuqinë dhe nevojën të shihja, djaloshi që m'u shfaq paska qenë im atë.

Doli nga shtëpia duke e thyer derën, hyri në një xhip të zi, ngriti dorën në këndin e sipërm të xhamit të errët. Në anën e majtë futi dorën dhe ma shkuli zemrën bashkë me fëmijërinë.

Në një gjendje jermi e ndoqa, iu bëra hije dhe pashë kur nënshkroi diku, nxori armën që mbante të futur nën rrip të pantallonave, gjuajti dhe ma vrau djaloshin që takova më sipër, atë që mund të ishte im bir.

Pak kujdes desha për veten. Mbaj mend se të gjitha ishin veprime të pakthyeshme. I humba të gjitha lidhjet me meshkujt që duhet të ishin të mitë.

2. PO VJEN

Nuk më pëlqen fare Deni, as kur përpiqet të më tërheqë vëmendjen, as kur nxjerr nga goja ca të qeshura të shtira.

Një ditë më ftoi ta bënim një copë rrugë bashkë. E ndoqa pas më shumë për t'i dhënë një mundësi, për ta parë ndryshe. Ç'bëri idioti, punoi kundër vetes; e shpërfytyroi më shumë atë.

Më tha të lidheshim. Me ca sy të rrëgjuar mbi fytyrën time, priste përgjigje. O Zot! E kujt po i bëhet vonë për ndërëgjegjen?!

Në një çast të tillë më lëvizën nifullat nga vendi. E nisa duke i drejtuar gishtin tregues, por një shkrepimë e fortë u ndie nga shuplaka që i lashë mbi fytyrë.

E çuditshme qe, mendova se do të reagonte dhunshëm dhe u tërhoqa pak. Ai u duk sikur e shijoi atë vulën pesëgjishtërinjshe mbi fytyrë.

Sinqerisht, këtu m'u err fare shikimi, më hipën kacabunjtë. Deni m'u duk si një qenie e ligë, që atë çast të nëmur po hante mëngjesin. I lëpui buzët cep më cep dhe e vuri dorën mbi gojë për të mbajtur gazin dhe për të mbuluar çatajtë, që prisnin të shqyenin me babëzi ç't'u dilte para.

Nuk e përfytyroja dot si mund të shpëtoja pa m'u mbushur sytë me lot. Fjalët më kuisën që në gjoks, kërcisnin nëpër brinjë si për të dalë nga trupi. U ndjeva si një shkurre që kërkonte fjalëkalimin për të vënë pak rregull mbi degët e çartisura që s'përmbaheshin së çeluri.

Dreqi e mori, u kujtova, në gjithë këtë mesele Deni jam unë. Jam drobitur nga mendime të mbrapshta, t'i them sa vuaj dhe t'ia heq fytyrës këtë shprehje të pavërtetë që i kam dhënë, deri në njëfarë pike natyrisht.

Kam një jetë që e dua dhe s'di si t'ia them. Sapo shkëmbehem me të, çdo formë bimësie përflak gjethet dhe ul kryet duke pritur. Ma dinë hallin, vetëm ajo s'e merr vesh. Nuk e di si më ka rënë në kokë për të, me të gjitha është e dalë mode, m'i bëri sytë shkëndija dhe një herë të vetme që i thashë rri me mua.

Po më zë një ngërç gjunjët, se di unë si t'ia kthej mllëfin gjoja të fshehur. Më duket se erdhi.

3. POTHUAJSE TY

Para meje je ti. Kam gjithë jetën që dua të të takoj. Dua të takoj patjetër. Fytyra jote tani ka marrë një fizionomi të qartë. Kjo u ndodh burrave, ata dallojnë pas kësaj moshe. Ka dhe një detaj tjetër, i cili të shpërfaq: vërshimi i dritës dhe ajrit të freskët.

Ty nuk të duhet çfarë mua më shkon, ndaj druhash të më zgjasësh dorën. Më thua se unë jam një blasfemi. Arsyen nuk ma thua. Dua të jem e bukur dhe e ndjeshme për ty, në mënyrë që të kesh një arsye të fortë për të më parë.

Unë dua t'ua kaloj të gjithave. Edhe për këtë kam arsyet e mia.

Unë kam ndërtuar një skemë në mendje, ajo është me tri lëvizje. Parë nga jashtë duket trekëndësh barabrinjës. Kur ndodhesh brenda (unë ndodhem brenda), këndet ngushtohen sa të marrin frymën. Unë prirem të kafshoj. I ngul dhëmbët këndit ku ndodhem dhe e brej aq sa të mundem të hap një shteg.

Në këtë mënyrë unë pa e kuptuar kam ngrënë brinjët e mia. Kjo është një mënyrë jodjallëzore që të hapem me botën.

Moti jashtë është i shkëlqyer, por jo skema që unë kam ngritur. Ajo tani është një figurë e grisur, pa kulme.

Nuk kam ç'të them për jetën që bëj. Gjithmonë që kam menduar ta njoh, më ka pushtuar frika dhe jam tulatur.

E pranoj që prita gjatë të të gjeja. Kjo është sprovë ime e të gjeturit. Më duhet ta pastroj shpirtin tim me gjuhë, ashtu si gjirafa veshin.

Kush është i pavëmendshëm mendon se po përsiat për një temë të humbur dashurie.

E vërteta është se nuk kam ç'të them për këtë. Nuk jam unë e detyruar ta kuptoj pozicionin ku ndodhem. Mua më duhet të zhytem te skema që kam mbetur peng.

Me frikë të madhe dhe jo pa admirim, nuk mundem të rri pa thënë ca të vërteta tronditëse që sapo i zbulova: sigurinë e të qenit e vëmendshme dhe zemërimin tim të vjetër.

4. LITOTË

(Bota sa një shkrepëse)

Ligjëratat ishin futur në kuti shkrepësesh të vogla. Njerëzit ishin fijet që rrinin stivë brenda. Të shtrirë dhe të trembur. Shkrepësja (kutia) ta merrte frymën. Në skajin më të largët të saj ishte ti me këmbët e tua. E gjithë bota u përkufizua rreptësisht. Ajo i zbatua kundërshtarit.

Si mund të dalloje të vërtetat?

Jeta nuk kishte asnjë lloj ngjasimi me të mëparshmen. Dikush kishte bërë marrëveshje me armikun, ose ai (armiku), ishte bërë i paprekshëm.

Ah! Një fije ka mbetur jashtë. Çdo lidhje e dukshme nuk shlyhet, për asnjë arsye.

Litota ime do ndihmë!

Si mund të mohohet ekzistenca?

Të gjitha fijet janë trembur, janë mbledhur, janë bërë një dorë. Një lloj frike, si dëshmi e pandërgjegjshme e pamundësisë.

Mjedisi i brendshëm i shkrepësës të jep njëfarë sigurie fizike. Aq sa ka në dorë mëvetësia e shëmbëlltyrës së shtëpisë me derën hapur ose pa derë fare. Në zemër të natyrës ndihen hapa. E tashmja është fshirë. Hunda dhe sytë kanë frikë duart.

Ne duhet të dimë! Nuk është një kumt.

Natyra me bishtin e lugës ka trazuar gjellën për të na treguar se asgjë nuk nis nga e para.

Ligjëratat tona na dëftojnë se shpërthejmë. Dhe tretemi brenda apo jashtë kutisë.

Karikaturë nga Arben Mexsi

